

Print ISSN 2222-5846
Online ISSN 2312-5349

Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike

REVISTA SHQIPTARE SOCIAL EKONOMIKE
ALBANIAN SOCIO ECONOMIC REVIEW
Revistë Social Ekonomike katërmujore

Viti XXVII, Nr. 3 (109)
(Shtator – Dhjetor 2022)

Tiranë, 2022

QSHKE
QENDRA SHQIPTARE PËR KËRKIME EKONOMIKE
REVISTA SHQIPTARE SOCIAL EKONOMIKE
ALBANIAN SOCIO ECONOMIC REVIEW
Revistë Social Ekonomike katërmujore
Viti i XXVIII, Nr. 3 (109)
(Shtator – Dhjetor 2022)

Komiteti shkencor

Dr. Zef PREÇI – Kryeredaktor - Shqipëri
Prof. Dr. Ana Paula FERREIRA FERNANDES LOPES - Portugali
Prof. Dr. Antonio DA SILVA ROBALO - Portugali
Prof. Dr. Dorota WITKOWSKA, Poloni
Prof. Dr. Elena HORSKA, Sllovaki
Prof. Dr. Fatmir MEMAJ - Shqipëri
Prof. Dr. Heinz-Dieter WENZEL - Gjermani
Prof. Dr. Iraj HASH - UK
Prof. Dr. Janez PRAŠNIKAR - Slloveni
Prof. Dr. Justina SHIROKA PULA - Kosovë
Prof. Dr. Luigi D'AMBRA - Itali
Prof. Dr. Nasir SELIMI – Maqedonia e Veriut
Prof. Dr. Statty STATTEV – Bullgari
Prof. Dr. Shyqyri LLACI - Shqipëri
Prof. Dr. Tomasz MROCZKOWSKI - ShBA
Prof. Dr. Yannis TSEKOURAS – Greqi
Prof. Dr. Zhaklina PETO – Shqipëri
Prof. Asoc. Dr. Dorina HOXHA - Shqipëri
Prof. Asoc. Dr. Etleva LEKSKAJ - Shqipëri
Prof. Asoc. Dr. Florian NUTA – Rumani
Prof. Asoc. Dr. Laura TAFARO - Itali
Dr. Elmira KUSHTA - Shqipëri
Dr. Zamira SINAJ - Shqipëri

Redaktor:

Prof. Dr. Fatmir MEMAJ

Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike – QSHKE nuk është përgjegjëse për mendimet e shprehura nga autorët në artikujt e tyre. Mendimet janë thjeshtë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë as opinionet e QSHKE-së dhe as qëndrimet dhe opinionet e institucioneve ku autorët punojnë.

Me kërkesë zyrtare të palëve të treta të interesuara, botuesi vë në dispozicion deklaratën e origjinalitetit të nënshkruar prej autorëve të shkrimeve të botuara.

Adresa e Redaksisë:

Rr. "Ismail Qemali", Nr. 1, Hyrja 1, Kati 3, Ap. 6

Kutia Postare 2934, Tiranë, SHQIPERI

Tel/Fax: 04 2274 603

Tirazhi: 1000 kopje

PËRMBAJTJA

Rigena SEMA	Përdorimi i aparatit algjebrik për vlerësimin e modeleve VAR: një aplikim i indekseve të çmimit të konsumit në rastin e Shqipërisë	f. 5
Xhuljeta MEÇAJ Brunilda LUFI	Një analizë mbi nivelin e varfërisë në Shqipëri	f. 17
Dashmir ASANI	Disa konsiderata lidhur me ekonominë informale	f. 27
Elmedina SHUAJIBI	Menaxhimi korporativ i kompanive në RMV dhe strukturimi i tyre në tregun ndërkombëtar (qasja në tregjet e kapitalit)	f. 49
Altin HAZIZAJ Merita PONI	Sfidat e pushtetit vendor për zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi në Shqipëri për garantimin e të drejtave të personave LGBTI	f. 59
	Komiteti shkencor	f. 73
	Recenzentë në këtë numër	f. 78
	Kriteret për botimin e artikujve	f. 79

PËRDORIMI I APARATIT ALGJEBRIK PËR VLERËSIMIN E MODELEVE VAR: NJË APLIKIM I INDEKSEVE TË ÇMIMIT TË KONSUMIT NË RASTIN E SHQIPËRISË

Rigena SEMA¹

Abstract

Food and non-alcoholic beverages, as well as educational services are two of the sub-indices that affect the consumer price index. The Consumer Price Index measures the change over time in the prices of goods and services that are purchased, used or remain unpaid by Albanian households. The index is found for each year, based on what the Albanian population has consumed for each product and service performed. In this paper, the linear algebra apparatus will be used to build a stable autoregressive vector model to analyze the sources that influence the consumer price index. The robustness of the model will be analyzed with the help of the eigenvalues of the coefficient matrix of the estimated models. With the help of matrix transformations, we will present VAR models as models with a time lag which will describe the dynamic relationship between the variables. The selection criteria will be used for choosing the time lag of the VAR model. The construction of the models will be based on monthly data for the indices in the period of 2007-2020 obtained from INSTAT. Data processing is carried out with R software

Keywords: consumer price index, food price index, education index, VAR, algebraic transformations, stationarity, stability

Hyrje

Indeksi i Çmimeve të Konsumatorit (CPI) dhe norma e inflacionit janë dy tregues të rëndësishëm në një ekonomi. Në botën e ekonomiksit inflacioni apo indeksi i çmimeve të konsumit, është një nga treguesit më të vështirë dhe të debatueshëm. Instituti i Statistikave e llogarit Indeksin e Çmimeve të Konsumit duke grumbulluar informacion mbi rreth 400 çmime në të gjithë territorin e vendit. Banka e Shqipërisë llogarit nga Indeksi i Çmimeve të Konsumit një nënindeks të quajtur Inflacion Bazë, me qëllim që të dallojë nga inflacioni atë pjesë të treguesit që flet për ecurinë e çmimeve duke përjashtuar disa faktorë çorientues. Indekset e çmimeve shërbejnë si një masë e vetme dhe e agreguar e të gjitha ndryshimeve individuale relative të çmimeve në një shportë mallrash². Rëndësia e tyre buron nga fakti, se çmimet e shumë produkteve ndryshojnë në madhësi jo të njëjta dhe kështu, nuk është shumë praktike që të gjitha këto ndryshime individuale të çmimeve të analizohen veçmas. Me qëllim përfitim të një matjeje të vetme, indekset e çmimeve ndërtohen duke përdorur mesataren e peshuar të normave të ndryshme të ndryshimit të çmimeve individuale. Indeksi i Çmimeve të Konsumit që ne kemi marrë në studim, mat ndryshimin e nivelit të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga njësitë ekonomike familjare për konsum vetjak. Indeksi llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të njësitë

¹ Departamenti i Matematikës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, Tiranë, Shqipëri e-mail: rigena.sema@fshn.edu.al

² <http://www.instat.gov.al/al/temat/%C3%A7mimet/indeksi-i-%C3%A7mimeve-t%C3%AB-konsumit/>

ekonomike familjare. Disa nga grupet kryesore që përfshihen në CPI janë: ushqime dhe pije joalkoolike, pije alkoolike dhe duhan, veshje dhe këpucë, ‘qira, ujë lëndë djegësë dhe energji, kujdes shëndetësor, transport, shërbim arsimor, etj. Dy nga zërat që ne studiojmë specififikisht në këtë punim janë: 1. Ushqime dhe pije joalkoolike dhe 2. Shërbime arsimore. Literatura ekzistuese dhe studime të autorëve të ndryshëm mbështesin idenë se çmimet e ushqimeve kanë ndikuar ndjeshëm në inflacion, ndërkohë që arsimi ka një ndikim jo shumë të lartë në krahasim me çmimet e ushqimeve, por ne e marrim në analizë pasi arsimi në vend po bëhet gjithmonë e më i kushtueshëm. Qëllimi i studimit tonë është të studiojmë lidhjet që ekzistojnë midis CPI dhe dy nënindekseve të marra në studim duke përdorur si fillim aparatit e algjebërës lineare dhe më pas softe kompjuterike për të finalizuar modelimin.

Modelet Var

Modelet Vektoriale Autoregresive (VAR)³ përdoren gjerësisht në analizën e serive kohore për të ekzaminuar marrëdhëniet dinamike që ekzistojnë midis variablave që ndërveprojnë me njëri-tjetrin. Përveç kësaj, ato janë gjithashtu mjete të rëndësishme parashikimi që përdoren nga shumica e institucioneve makroekonomike ose politikëbërëse. Zhvillimet më të fundit përfshijnë përdorimin e dekompozimeve strukturore, kufizimet e shenjave, përfshirjen e parametrave që ndryshojnë në kohë, thyerjet strukturore, paqëndrueshmërinë stokastike. Struktura e modeleve VAR mundëson shpjegimin e vlerave të variablave endogjenë nga vlerat e tyre të vëzhguara në të kaluarën⁴.

VAR cilësohet si sistemi i ekuacioneve autoregresive me lag të shpërndarë (ARDL), që përshkruajnë evolucionin dinamik të një grupi variablash nga historia e tyre. Nëse jepet një bashkësi me K variabla $Y_t = (y_{1t}, y_{2t}, \dots, y_{Kt})$ për $k = 1, 2, \dots, K$, modeli VAR(p) jepet nga:

$$Y_t = A_0 + A_1 Y_{t-1} + A_2 Y_{t-2} + \dots + A_p Y_{t-p} + CD_t + u_t \quad (1)$$

ku matricat e koeficientëve, A_i janë matrica të katrore të rendit K , për $i = 1, 2, \dots, p$ dhe u_t është vektori i mbetjeve të modelit, të cilat janë zhurmë e bardhë, me matricën e kovariancës

$$E(u_t, u_t') = \Sigma_u$$

me kohë-invariante, pozitivisht të përcaktuar dhe pritje të barabartë me zero, $E(u_t) = 0$. Matrica C është $K \times M$ matrica e koeficientëve të regresorëve potencialisht deterministë dhe D_t është një vektor (matricë me $M \times 1$ përmasa) i cili mban regresorët e duhur përcaktues, si p.sh. variablat konstant, trendin, variablat dummy dhe/ose sezonalitet. Në teorinë e serive kohore përdoret gjerësisht operatori i kthimit mbrapa sipas të cilit

³ Helmut. L; “Stable Vector Autoregressive Processes”. Springer-Verlag Berlin Heidelberg. (2005).

⁴ Wong, Choi & Fong. “A Framework for Stress Testing Bank's Credit Risk”. Working Papers 0615, Hong Kong Monetary Authority. (2006)., <https://ideas.repec.org/p/hkg/wpaper/0615.html>.

$$B^k Y_t = Y_{t-k}.$$

Nëse në modelin 1 nuk kemi të përfshirë variabla të tjerë ne mund të përdorim operatorin e kthimit mbrapa për të shkruar modelin si një polinom të gradës p si më poshtë:

$$\begin{aligned} Y_t - A_1 Y_{t-1} - \dots - A_p Y_{t-p} &= u_t \\ Y_t - A_1 B Y_t - \dots - A_p B^p Y_t &= u_t \\ (I - A_1 B - \dots - A_p B^p) Y_t &= u_t \text{ ose } \Phi(B) Y_t = u_t \end{aligned} \quad (2)$$

ku polinomi

$$\Phi(B) = (I - A_1 B - \dots - A_p B^p)$$

njihet si polinom karakteristik i modelit VAR.

Duke u bazuar në ekuacionin (1) në mënyrë rekurente mund të marrim:

$$\begin{aligned} Y_1 &= A_0 + A_1 Y_0 + u_1 \\ Y_2 &= A_0 + A_1 Y_1 + u_2 = A_0 + A_1(A_0 + A_1 Y_0 + u_1) + u_2 \\ Y_2 &= (I_k + A_1)A_0 + A_1^2 Y_0 + A_1 u_1 + u_2 \end{aligned}$$

dhe në hapin e fundit kemi:

$$Y_t = (I_k + A_1 + \dots + A_1^{t-1})A_0 + A_1^t Y_0 + \sum_{j=0}^{t-1} A_1^j u_{t-j} \quad (3)$$

Nëse të gjitha vlerat e veta të A_1 kanë modul më të vogël se një, zëvendësimi mund të vazhdohet duke përdorur $y_j, j < 0$, dhe ekuacioni (3) mund të shkruhet në formën:

$$Y_t = (I_k - A_1)^{-1} A_0 + \sum_{j=0}^{\infty} A_1^j u_{t-j} \quad \text{për } t = 0, \pm 1, \pm 2, \dots$$

ku pjesa konstante mund të shënohet me μ . Seria e matricës konvergjon sipas rezultateve të algebrës lineare. Barazimi i fundit njihet si zbërthimi i Wold për modelet VAR(1) (Helmut.L, 2005).

Për të analizuar stacionaritetin e modelit VAR(1) do të mbështetemi te zbërthimi i Wald për kushtin në lidhje me pritjen nga ku marrim:

$$E(Y_t) = E((I_k - A_1)^{-1} A_0 + \sum_{j=0}^{\infty} A_1^j u_{t-j}),$$

duke ditur se pritja matematike e mbetjeve është 0 dhe duke u bazuar në vetitë e saj kemi:

$$E(Y_t) = E((I_k - A_1)^{-1} A_0) = \mu$$

Ndërsa në lidhje me momentet e rendit të dytë Luetkepohl paraqet një derivim të funksionit të cross-variancës (Helmut.L, 2005).

$$\begin{aligned} \Gamma_y(h) &= E(y_t - \mu)(y_{t-h} - \mu)' = \lim_{n \rightarrow \infty} \sum_{i=0}^n \sum_{j=0}^n A_1^i E(u_{t-i} u'_{t-j-h}) (A_1^j)' \\ &= \lim_{n \rightarrow \infty} \sum_{i=0}^n A_1^{h+i} \Sigma_u (A_1^i)' = \sum_{i=0}^{\infty} A_1^{h+i} \Sigma_u (A_1^i)' \end{aligned}$$

ku duhet të përdorim kushtin e mungesës së korelacionit midis mbetjeve, $E(u_t, u'_s)$ për $t \neq s$ dhe $E(u_t, u'_t) = \Sigma_u$ dhe faktin që mbetjet janë zhurmë e bardhë, në mënyrë që njehsimet të realizohen.

Përkufizim 1.1 Një model VAR është stacionar nëse plotësohen kushtet:

1. $E(Y_t) = \mu$
2. $E(Y_t - \mu)((Y_{t-j} - \mu)') = \Gamma_j$, për çdo t dhe j . (4)

Le të marrim në studim modelin VAR(1) në të cilin intercepti mungon $A_0 = 0$:

$$Y_t = A_1 Y_{t-1} + u_t$$

Nëse matrica A_1 e ka përcaktorin e ndryshëm nga zero, atëherë ekziston matrica e anasjelltë

$$A_1^{-1} = \frac{1}{\det(A_1)} \text{adj}(A_1).$$

Meqënëse modeli VAR duke u bazuar në ekuacionin (2) shkruhet në trajtën

$$\Phi(B)Y_t = u_t,$$

ne mund të nxjerrim se:

$$Y_t = \Phi(B)^{-1}u_t \quad (5)$$

Nëse të dy anët e ekuacionit (5) i shumëzojmë me $\det(\Phi(B))$ do të marrim:

$$\det(\Phi(B)) \cdot Y_t = \text{adj}(\Phi(B)) \cdot u_t. \quad (6)$$

Meqënëse përcaktori është një numër, duke e aplikuar (6) për çdo seri y_t të VAR kemi se:

Çdo variabël Y_t është stacionarë nëse të gjitha rrënjët e polinomit:

$$\det(\Phi(B)) = \det(I - A_1 B - \dots - A_p B^p) = 0$$

janë jashtë rrethit njësi.

Përkufizim 1.2 Një VAR(1) quhet i qëndrueshëm nëse të gjitha vlerat vetjake të A_1 kanë modul më vogël se një (Helmut.L., 2005).

Nga një lemë matematikore, ky kusht është ekuivalent me:

$$\det(I_k - A_1 z) \neq 0 \quad \text{për } |z| \leq 1$$

Pra, matrica është e padegjeneruar nëse nuk ka rrënjë brenda ose në rrethin e njësisë. Stabiliteti nuk është ekuivalentë me stacionaritetin: një proces i qëndrueshëm i nisur në $t = 1$ nuk është stacionarë.

Transformimi i modeleve VAR në model VAR(1)

Modeli VAR(p) mund të shkruhet si model VAR(1) duke përdorur transformimet algjebrike.

Për të kryer transformimet algjebrike i referohemi një modeli VAR(p), k dimensional dhe modelin e shprehim si sistem ekuacionesh lineare të dhëna si në ekuacionin (3):

$$\left\{ \begin{array}{l} Y_{1t} = \sum_{i=1}^p \alpha_{1i} Y_{1,t-i} + \sum_{i=1}^p \alpha_{2i} Y_{2,t-i} + \dots + \sum_{i=1}^p \alpha_{ki} Y_{k,t-i} + u_{1,t} \\ Y_{2t} = \sum_{i=1}^n \beta_{1i} Y_{1,t-i} + \sum_{i=1}^n \beta_{2i} Y_{2,t-i} + \dots + \sum_{i=1}^p \beta_{ki} Y_{k,t-i} + u_{2,t} \\ \dots \\ Y_{kt} = \sum_{i=1}^n \gamma_{1i} Y_{1,t-i} + \sum_{i=1}^n \gamma_{2i} Y_{2,t-i} + \dots + \sum_{i=1}^p \gamma_{ki} Y_{k,t-i} + u_{k,t} \end{array} \right. , \quad (7)$$

ku $E(U_t) = E \begin{bmatrix} u_{1t} \\ u_{2t} \\ \dots \\ u_{kt} \end{bmatrix} = 0$ dhe $U_t \sim WN(0, \Sigma)$.

Nga ekuacionet (7), përcaktojmë matricat e mëposhtme:

$$A = \begin{bmatrix} A_1 & A_2 & \dots & A_{p-1} & A_p \\ I_K & 0 & \dots & 0 & 0 \\ \vdots & \vdots & \ddots & \vdots & \vdots \\ 0 & 0 & \dots & I_K & 0 \end{bmatrix}; Y_t = \begin{pmatrix} y_t \\ y_{t-1} \\ \dots \\ y_{t-p+1} \end{pmatrix}; A_0^* = \begin{pmatrix} A_0 \\ 0 \\ 0 \end{pmatrix}; U_t = \begin{pmatrix} u_t \\ 0 \\ 0 \end{pmatrix}$$

rrjedhimisht ekuacionet (7) mund të shkruhen në trajtën e ekuacionit matricor:

$$Y_t = A_0^* + AY_{t-1} + U_t. \quad (8)$$

Ekuacioni (8) është forma e përgjithshme e një modeli vektor autoregresiv me një vonesë, në të cilin elementët janë matrica, ku A është matricë katrore e rendit $K \cdot p$. Në analizën empirike një rol kyç luan specifikimi i VAR-it, ku studiuesi duhet të përcaktojë: Numrin e vonesave p , cilat janë variablat dhe Llojin e transformimeve. Numri i vonesave si dhe në rastin e njëanshëm, duhet pasur kujdes për të marrë parasysh të gjitha dinamikat sistematike në modelet me shumë variacione. Në modelet VAR, kjo zakonisht bëhet duke zgjedhur një numër të mjaftueshëm vonesash për të siguruar që mbetet në secilin prej ekuacioneve të jenë zhurmë e bardhë. Në këtë punim do të përdoren tre kritere të informacionit

AIC: Kriteri i informacionit Akaike (Akaike, (1974) zgjedh p -në duke minimizuar:

$$AIC(p) = T \ln |\hat{\Omega}| + 2(n^2 p)$$

BIC: Kriteri i informacionit Bayesian (Gujarati, D.N. and Porter, D.C, 2009) zgjedh p -në duke minimizuar:

$$BIC(p) = T \ln |\hat{\Omega}| + (n^2 p) \ln T$$

HQ: Kriteri i informacionit Hannan- Quinn zgjedh p -në duke minimizuar:

$$Hq(p) = T \ln |\hat{\Omega}| + 2(n^2 p) \ln \ln T$$

Lloji i variablave: Në specifikimin e variable një rol kyç luan përzgjedhja e variablave. Meqenëse modelet VAR janë modele në shkallë të vogël, zakonisht përdoren 2 deri në 8 variabla (Asteriou, Diitrios; Hall, Stephen G, 2011).

Lloji i transformimeve: shumë seri kohore ekonomike shfaqin tendencë me kalimin e kohës dhe janë qartësisht jo stacionare

Seri trend-stacionare: $Y_t = a + bt + u_t$ dhe seri stacionare sipas diferencave: $Y_t = a + Y_{t-1}u_t$

Rishikim literature

Literatura për çmimet e ushqimeve dhe lidhjes me inflacionin është kryesisht e dominuar nga teoritë bazuar në besimin se elementët e inflacionit të paqëndrueshëm siç janë çmimet e ushqimit nuk pasqyrojnë ndryshimet inflacioniste. Argumenti kryesor është se ndryshimet e çmimeve të mallrave janë kalimtare dhe të shpejta duke lënë agregatin afatmesëm (Jim, 2009, Cecchetti & Moessner, 2008). Megjithatë, në të kaluarën e afërt, pas episodeve të vazhdueshme të goditjeve të çmimeve të mallrave, axhenda e hulumtimit u zhvendos në drejtim të rishikimit të rolit të çmimeve të mallrave jo vetëm në inflacionin e përgjithshëm, por gjithashtu gjithashtu në inflacionin bazë.

Studime të shumta të ndikimit të çmimit të ushqimit në inflacion janë kryer në vendet në zhvillim, sidomos në dy dekadat e fundit.⁵ Megjithatë, literatura mbi ndikimin e çmimeve të ushqimit në inflacion në Shqipëri është shumë i pakët me disa analiza të brendshme të kryera nga banka qendrore.

Në hulumtimin tone me rëndësi të veçantë është literatura e mëposhtme.:

Cecchetti (1994) dhe Bryan kanë studiuar (1997) masën e ndikimit të çmimeve të ushqimeve dhe pijeve joalkoolike në inflacion.

OECD (2005) përcakton lloje të ndryshme të inflacionit bazë dhe teston fuqinë e tyre parashikuese për inflacionin e ardhshëm për vendet industriale (SHBA, Kanada, Japoni, Euro Zona dhe UK).

Cecchetti dhe Moessner (2008) vërtetojnë ndikimin e rritjes së çmimeve të ushqimit dhe energjisë mbi dinamikën e inflacionit total në vendet në zhvillim dhe vendet e zhvilluara. Richards dhe Pofahl (2009) analizojnë ndikimin e çmimeve të ushqimeve në inflacion dhe gjetën se ky ndikim nuk është konstant. Catão dhe Chang (2010), eksplorojnë në gazetën e tyre se si ekonomitë e vogla të hapura duhet të reagojnë ndaj presioneve të importuara inflacioniste, kryesisht që vijnë nga çmimet e mallrave. Walsh (2011) konstaton se ndikimi i çmimeve të ushqimeve në inflacion është i rëndësishëm veçanërisht në vendet me të ardhura të ulëta dhe se inflacioni bazë mund të çorientohet si pasojë e këtij ndikimi. Gómez dhe bashkëpunëtorët (2012) po eksplorojnë modele për parashikimin e inflacionit të ushqimit që do të përdoret nga vendet në zhvillim që kryejnë shënjestrimin e inflacionit. Anand dhe bashkëpunëtorët (2014) studiovan efektet e indeksit të çmimit të ushqimeve në IÇK në Indi dhe gjetën se ndikimi është relativisht i lartë për shkak të pjesëmarrjes së lartë të shpenzimeve të ushqimit në të ardhurat e familjes.

⁵ Walsh, J. P., "Reconsidering the Role of Food Prices in Inflation", IMF Working Paper WP/11/7, International Monetary Fund, (2011), Washington D.C., USA.

Kjo temë është studiuar gjerësisht në literaturën përkatëse të specialistëve, të cilët kanë treguar se ndryshimet në çmimet e mallrave kanë çuan në inflacion. Hulumtimet më të rëndësishme u kryen nga Hafer (1983), Garner (1985), Defina (1988), Ëebb (1989), Furlong (1989), Cody dhe Mills (1991), Kugler (1991) dhe Trivedi dhe Hall (1995). Në të njëjtën kohë, studimet e Garner (1995) dhe Bloomberg dhe Harris (1995) pohojnë se çmimet mallrave nuk kanë qenë tregues kryesorë të inflacionit që prej atëherë prej mesit të vitit 1980.

Sipas S. Cecchetti dhe R. Moessner (2008) për shkak të një rritje të lartë në çmimet e mallrave, u regjistruan rritjet e çmimeve në të gjithë botën. Sipas pikëpamja e tyre, rritja e çmimeve të mallrave në vendet e përparuara nuk ndikoi evoluimi i inflacionit bazë, për shkak të peshës së ulët të produkteve ushqimore në CPI. Rritja e inflacionit bazë nga rritja në çmimet e mallrave janë vërejtur në vendet në zhvillim, të cilat karakterizohen nga një përqindja e lartë e CPI-së së ushqimit prej rreth 30 %.

Në hulumtimin e tij Dospinescu (2010) tregon se ka një tendencë afatgjatë të CPI, e cila reflektohet nga ndryshimet e pakthyeshme të çmimeve të ushqimeve.

Studime të ndryshme janë bërë edhe në lidhje me peshën që kanë shpenzimet për edukim në totalin e shpenzimeve të familjeve. Sipas Zactton (2011) pesha e arsimit në CPI është rritur në mënyrë graduale (rritja nga viti 2016-2017 ka qenë 1.1%) dhe kjo ka ardhur si pasojë e dy faktorëve kryesor: Rritja e kostove të arsimit dhe Rritja e numrit të individëve që ndjekin arsimin në nivele të ndryshme.


Analiza empirike

Ky punim është i bazuar në të dhëna sekondare. Të dhënat sekondare janë të dhëna të mbledhura më parë për një qëllim tjetër dhe janë të disponueshme për të gjithë publikun dhe ne i përdorim për punimin tonë. Kemi marrë në analizë indeksin e çmimeve të konsumit CPI, dhe dy nënindekset ushqime dhe pije joalkolike UPJ dhe indeksin për arsim në Shqipëri për vitet 2007-2020 me frekuenca mujore. Të dhënat janë siguruar nga INSTAT (2022, n.d.). Modeli i përgjithshëm VAR(p) tre dimensional që do të vlerësojmë është:

$$\begin{cases} Y_{1t} = \sum_{i=1}^p \alpha_{1i} Y_{1,t-i} + \sum_{i=1}^p \alpha_{2i} Y_{2,t-i} + \sum_{i=1}^p \alpha_{3i} Y_{3,t-i} + u_{1,t} \\ Y_{2t} = \sum_{i=1}^n \beta_{1i} Y_{1,t-i} + \sum_{i=1}^n \beta_{2i} Y_{2,t-i} + \sum_{i=1}^p \beta_{3i} Y_{3,t-i} + u_{2,t} \\ Y_{3t} = \sum_{i=1}^n \gamma_{1i} Y_{1,t-i} + \sum_{i=1}^n \gamma_{2i} Y_{2,t-i} + \sum_{i=1}^p \gamma_{3i} Y_{3,t-i} + u_{3,t} \end{cases},$$

$$E(u_t) = E \begin{bmatrix} u_{1t} \\ u_{2t} \\ u_{3t} \end{bmatrix} = 0, u_t \sim WN(0, \Sigma).$$

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten marrëdhëniet midis tre serive kohore të marra në studim, ku dallohet një lidhje e forte pozitive midis CPI dhe indeksit të ushqime dhe pije joalkolike dhe një lidhje jo aq e forte por me tendenca pozitive me indeksin e shpenzimeve për arsim.



Grafiku 1: Lidhja midis tre serive kohore CPI, UPJ, ARSIMI

Lidhja e indeksit të shpenzimeve për arsim është e pranishme me të dy seritë e tjera ndaj dhe vlerësimi i modelit VAR është një mjet i mirë për modelimin e tyre.

Vlerësimi i modelit VAR(1) për indekset u realizua duke përdorur metodën e katrorëve më të vegjël. Modeli i vlerësuar jepet si më poshtë:

$$\begin{bmatrix} CPI_t \\ UPJ_t \\ arsimi_t \end{bmatrix} = \begin{pmatrix} 0.5 \\ 0.6 \\ 0.3 \end{pmatrix} + \begin{pmatrix} 0.98 & -0.02 & 0.04 \\ -0.04 & 0.94 & 0.10 \\ 0.022 & -0.004 & 0.98 \end{pmatrix} \begin{pmatrix} CPI_{t-1} \\ UPJ_{t-1} \\ arsimi_{t-1} \end{pmatrix} + \begin{bmatrix} u_{1t} \\ u_{2t} \\ u_{3t} \end{bmatrix}$$

Matrica kryesore e modelit të vlerësuar është:

$$A = \begin{pmatrix} 0.98 & -0.02 & 0.04 \\ -0.04 & 0.94 & 0.10 \\ 0.022 & -0.004 & 0.98 \end{pmatrix}$$

Le të analizojmë stacionaritetin e modelit të vlerësuar duke përdorur kushtin (6).

$$\Phi(B) = I_3 - AB = \begin{pmatrix} 1 & 0 & 0 \\ 0 & 1 & 0 \\ 0 & 0 & 1 \end{pmatrix} - \begin{pmatrix} 0.98 & -0.02 & 0.04 \\ -0.04 & 0.94 & 0.10 \\ 0.022 & -0.004 & 0.98 \end{pmatrix} B$$

$$\Phi(B) = \begin{pmatrix} 1 - 0.98B & 0.02B & -0.04B \\ 0.04B & 1 - 0.94B & -0.10B \\ -0.022B & 0.004B & 1 - 0.98B \end{pmatrix}$$

Gjejmë përcaktorin e matricës $\Phi(B)$:

$$\det(\Phi(B)) = -0.9B^3 + 2.8B^2 + 2.9B + 1$$

Meqenëse një nga rrënjët e këtij polinomi është afërsisht 3.9 dhe kjo vlerë qartësisht bie jashtë rrethit njësi, atëherë modeli VAR i vlerësuar është stacionar.

Për të studiuar qëndrueshmërinë e modelit duhet të njehsojmë verat e veta, të cilat gjenden si rrënjë të polinomit karakteristik:

$$\det(A - \lambda I_3) = \det \begin{pmatrix} 0.98 - \lambda & -0.02 & 0.04 \\ -0.04 & 0.94 - \lambda & 0.10 \\ 0.022 & -0.004 & 0.98 - \lambda \end{pmatrix}$$

$$\det(A - \lambda_3) = -\lambda^3 + 2.9 \cdot \lambda^2 - 2.80 \cdot \lambda + 0.90 = 0$$

Meqenëse polimoni karakteristik është polinom i gradës së tretë, atëherë të shumtën ky polinom ka tre rrënjë. Rrënjët e polinomit, të cilat janë dhe njëkohësisht vlerat e veta, janë

$$\lambda_1 \approx 0.92, \quad \lambda_2 \approx 0.98, \quad \lambda_3 \approx 0.99$$

Vëmë re, se vlerat e veta janë me modul më të vogël se 1 e për rrjedhojë modeli është i qëndrueshëm.

Meqenëse modeli VAR(1) ishte stacionar, por ishte i qëndrueshëm, ne do të kërkojmë një model tjetër më të mire, pasi në indekse zakonisht efekti është në periudha më të gjata se 1 muaj që është frekuenca deri në 12 vonesa. Për këtë arsye do të përdorim kriteret e selektimit të modeleve të treguara më lart në R për përzgjedhjen e vonesës dhe kemi:

Tabela 1: Përzgjedhja e vonesës në R

> info.bv\$selection		
AIC(n)	HQ(n)	SC(n)
12	12	12

Të tre kriteret kanë selektuar vlerësimin e modelit VAR(12) si modelin më të përshtatshëm për të dhënat tona.

Modeli i vlerësuar ka tre ekuacione, koeficientët e të cilëve po i paraqitim në tre tabelat në vazhdim.

TABELA nr 2: Koeficienti për ekuacionin e modelit të vlerësuar për indeksin e çmimeve të konsumatorit, modeli i vlerësuar për CPI

CPI.11	UPJ.11	arsimi.11	CPI.12	UPJ.12	arsimi.12	CPI.13	UPJ.13	arsimi.13
1.3636	-0.27614	-0.06802	-0.13817	0.00923	0.0575	-0.016	-0.019	0.0093
CPI.14	UPJ.14	arsimi.14	CPI.15	UPJ.15	arsimi.15	CPI.16	UPJ.16	arsimi.16
-0.75840	0.2681	0.140	0.519	-0.17961	-0.16577	0.1783	-0.040	0.04324
CPI.17	UPJ.17	arsimi.17	CPI.18	UPJ.18	arsimi.18	CPI.19	UPJ.19	arsimi.19
-0.32687	0.099	-0.06349	0.18691	-0.12137	0.01734	-0.03918	0.06046	-0.0125
CPI.110	UPJ.110	arsimi.110	CPI.111	UPJ.111	arsimi.111	CPI.112	UPJ.112	arsimi.112
0.27968	-0.10675	0.12007	-0.73627	0.37724	0.01749	0.49426	-0.09896	-0.06615

TABELA nr 3: Koeficienti për ekuacionin e modelit të vlerësuar për ushqime dhe pije joalkolike

CPI.11	UPJ.11	arsimi.11	CPI.12	UPJ.12	arsimi.12	CPI.13	UPJ.13	arsimi.13
0.5447	0.4693	-0.1520	-0.4151	0.0383	0.2118	0.6426	-0.3239	-0.0190
CPI.14	UPJ.14	arsimi.14	CPI.15	UPJ.15	arsimi.15	CPI.16	UPJ.16	arsimi.16
-1.8588	0.6617	0.2745	1.2611	-0.3693	-0.3380	-0.3495	0.1392	0.1269
CPI.17	UPJ.17	arsimi.17	CPI.18	UPJ.18	arsimi.18	CPI.19	UPJ.19	arsimi.19
0.4246	-0.2438	-0.2479	0.0233	-0.0809	0.0598	-0.5045	0.3007	-0.0219
CPI.110	UPJ.110	arsimi.110	CPI.111	UPJ.111	arsimi.111	CPI.112	UPJ.112	arsimi.112
0.7040	-0.2989	0.3493	-1.8486	0.9579	-0.0548	1.3808	-0.3033	-0.1192

TABELA nr 4: Koeficienti për ekuacionin e modelit të vlerësuar për indeksin e shpenzimeve në arsimit

CPI.11	UPJ.11	arsimi.11	CPI.12	UPJ.12	arsimi.12	CPI.13	UPJ.13	arsimi.13
0.26866	-0.09634	0.994	-0.22022	0.12769	-0.0842	-0.61805	0.12198	0.14734
CPI.14	UPJ.14	arsimi.14	CPI.15	UPJ.15	arsimi.15	CPI.16	UPJ.16	arsimi.16
-0.06034	0.09020	-0.056	0.23728	-0.15206	-0.00857	0.14022	-0.00490	-0.082
CPI.17	UPJ.17	arsimi.17	CPI.18	UPJ.18	arsimi.18	CPI.19	UPJ.19	arsimi.19
0.04528	-0.02080	0.08474	0.93238	-0.30033	0.00793	-0.72514	0.16545	0.02528
CPI.110	UPJ.110	arsimi.110	CPI.111	UPJ.111	arsimi.111	CPI.112	UPJ.112	arsimi.112
-0.01153	0.21726	-0.04637	-0.27954	-0.16080	-0.05696	0.32979	0.00168	0.04836

Më poshtë kontrollojmë nëse modeli i përzgjedhur është i qëndrueshëm:

Tabela 5: Kontrolli i modelit të përzgjedhur nëse është i qëndrueshëm

VAR Estimation Results:												
Endogenous variables: CPI, UPJ, arsimit												
Deterministic variables: none												
Sample size: 156												
Log Likelihood: -233.265												
Roots of the characteristic polynomial:												
0.9979	0.9979	0.9882	0.9882	0.9338	0.9221	0.9221	0.91	0.91	0.91	0.91	0.9079	0.9079
0.9068	0.9068	0.8895	0.8895	0.8847	0.8847	0.8686	0.8686	0.8566	0.8491	0.8491	0.8348	0.8348
0.8348	0.8348	0.8194	0.8194	0.7564	0.7564	0.6411	0.6411	0.5472	0.5472	0.022	0.022	0.002

Nga programi kemi që rrënjët e polinomit karakteritik të VAR(12), janë rrënjë më të vogla se 1. Pra, modeli ynë është i qëndrueshëm dhe modeli për analizën e indekseve është modeli VAR(12). Parashikimet e realizuara sipas modelit janë si më poshtë:

Tabela 6: Parashikimet e realizuara për modelin VAR 12

CPI				\$UPJ				\$arsimit						
fcst	lower	upper	CI	fcst	lower	upper	CI	fcst	lower	upper	CI			
[1,]	109.3773	108.6376	110.1171	0.7:	[1,]	119.1115	117.3380	120.8851	1.7	[1,]	102.5079	101.05406	103.9617	1.45
[2,]	110.5292	109.5860	111.4724	0.9:	[2,]	122.0684	119.9066	124.2302	2.1	[2,]	102.4916	100.43287	104.5504	2.05
[3,]	111.3173	110.2636	112.3709	1.0:	[3,]	124.1037	121.8570	126.3504	2.2	[3,]	102.6718	100.22115	105.1225	2.45
[4,]	111.0284	109.8699	112.1868	1.1:	[4,]	123.2231	120.9491	125.4970	2.2	[4,]	103.0663	100.25794	105.8747	2.80
[5,]	110.2121	109.0022	111.4221	1.2:	[5,]	121.2613	118.9353	123.5874	2.3	[5,]	103.0114	99.87387	106.1489	3.13
[6,]	109.3119	108.0677	110.5561	1.2:	[6,]	119.2181	116.8773	121.5590	2.3	[6,]	102.9672	99.51856	106.4159	3.44
[7,]	108.9180	107.6443	110.1918	1.2:	[7,]	118.3517	115.9947	120.7087	2.3	[7,]	102.7621	99.03722	106.4870	3.72
[8,]	108.9196	107.6151	110.2242	1.3:	[8,]	118.4926	116.1335	120.8516	2.3	[8,]	102.8678	98.89166	106.8440	3.97
[9,]	109.0123	107.6628	110.3618	1.3:	[9,]	118.7691	116.3832	121.1550	2.3	[9,]	103.0338	98.81582	107.2519	4.21
[10,]	109.0202	107.6375	110.4030	1.3	[10,]	118.7356	116.3270	121.1441	2.3	[10,]	103.6936	99.24601	108.1413	4.44

Përfundime

Në analizat ekonomike lidhja e serive kohore shpesh është e ndërvarur me vonesa kohore, ndaj studimi i modeleve të vektorëve të serive kohore në formë autoregressive ka shumë interesa nga studiues të shumtë.

Ndërtimi i modeleve VAR është një teknikë e cila ka nevojë për aparatit algjebrik me qëllim vlerësimin e modele sa më të mira për parashikime. Paraqitja e modeleve me shumë seri me vonesa kohore në trajta matricore na ndihmon në nxjerrjen e kushteve të nevojshme si për stacionaritet, qëndrueshmëri, vlefshmëri.

Duke përdorur elemente të algjebres lineare kemi konkluduar se një model i përgjithshëm VAR(p) mund të shndërrohet në një model VAR(1), duke krijuar matrica të reja me përmasa më të mëdha, gjithmonë bazuar në matricën fillestare të koeficientëve të modelit të vlerësuar. Duke marrë në studim matricën e koeficientëve të vlerësuar algjebrikisht kemi nxjerrë kushtin se një model VAR është i qëndrueshëm nëse vlerat e veta të matricës janë më të vegjël se 1, nga ana tjetër modeli është stacionar nëse rrënjët e polinomit karakteristik do të bien jashtë rrethit njësi.

Për të konkretizuar këtë analizë matematikore morëm në studim indeksin e cmimeve të konsumit, indeksin e nëngrupit ushqime dhe pije joalkolike dhe indeksin e shpenzimeve për arsim, për vitet 2007-2020 me frekuenca mujore në rastin e Shqipërisë. Modeli VAR(1) rezultoi një model stacionar dhe i qëndrueshëm, por kriteret e selektimit të modeleve AIC, BIC dhe HQ favorizuan modelin VAR(12) si modelin më të mirë për indekset e mara në studim. Modeli VAR(12) është një model i qëndrueshëm dhe stacionarë dhe me anë të tij kemi realizuar parashikimet për të tre indekset.

Referenca

- Akaike, H., "Information Theory and an Extension of the Maximum Likelihood Principle". Second International Symposium on Information Theory, (1974).
- Asteriou, Dimitrios, and Stephen G. Hall., "The Breusch–Godfrey LM test for serial correlation." Applied Econometrics (Second ed.). New York: Palgrave Macmillan (2011);159-61.
- Bilke, Laurent & Stracca, Livio., "A persistence-weighted measure of core inflation in the Euro area," Economic Modelling, Elsevier, vol. 24(6), (2007);1032-1047.
- Bryan M. F., Cecchetti, S. G., Wiggins R. L. "Efficient Inflation Estimation", Working Paper no. 6183, National Bureau of Economic Research, (1997) Cambridge, MA
- Cecchetti, S. G., & Moessner, R., "Commodity prices and inflation dynamics", BIS Quarterly Review, Basel, Sëitizlerland (2008), 55-66.
- Clark, Todd E.," Disaggregate Evidence on the Persistence of Consumer Price Inflation", FRB of Kansas City Working Paper, No.03-11, (2003).
<https://ssrn.com/abstract=560483> or <http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.560483>
- Gómez, M. I., González, E. R., Melo, L. F., "Forecasting Food Inflation in Developing Countries with Inflation Targeting Regimes vol.94(1), (2012), 153-173.

Gujarati, D.N. and Porter, D.C. *Basic Econometrics, 5th Edition*,. McGraw Hill Inc., (2009)New York.

Lütkepohl, H., “Stable vector autoregressive processes”. In *New introduction to multiple time series analysis* (pp. 13-68). Springer, Berlin, Heidelberg, (2005).

Wong, J., Choi, K., Fong, T., "A Framework for Stress Testing Bank's Credit Risk," Working Papers 0615, Hong Kong Monetary Authority, (2006).
<https://ideas.repec.org/p/hkg/wpaper/0615.html>.

Walsh, J. P., “Reconsidering the Role of Food Prices in Inflation”, IMF Working Paper WP/11/7, International Monetary Fund, Washington D.C., USA, (2011).

NJË ANALIZË MBI NIVELIN E VARFËRISË NË SHQIPËRI

Dr. Xhuljeta MEÇAJ¹ dhe Dr. Brunilda LUFU²

Abstract

For economic and sociological studies, the study of the distribution of income or well-being in a society is of interest. In Albania, but also in most developing countries, there is a perception that inequality is greater than in developed economies. In this paper we will analyze the relationship between inequality and economic growth. The data were provided by the World Bank (Bank, 2021) for GINI index and GDP per capita for the years 1999-2020 for the case of Albania. The Gini index is a number between 0 and 1. When it is zero it means that there is complete equality in the distribution of income. If the index is 1, we have a complete inequality in this distribution.

In order to detect the linear relationship between two variables, we will use the Pearson correlation coefficient by means of which we see if the relationship is strongly negative, there is no relationship, or strongly positive. To find out how strong the relationship is between two variables, we will use the t test for the correlation coefficient. To estimate the Gini model, we will use a number of economic variables such as GDP per capita, labor force, active population, population in rural areas and for the best selected model, we need to look for tests for the fulfillment of the OLS Assumption.

Keywords: GINI index, GDP, t test.

Hyrje

Për studimet ekonomike dhe ata sociologjike me interes është studimi i shpërndarjes të të ardhurave ose mirëqenies në një shoqëri. Le të jetë dhënë funksioni $L(x)$ i përcaktuar në segmentin $(0,1)$ i cili jep përqindjen kumulative të të ardhurave vjetore të marrë nga $x\%$ përqind e popullsisë me të ardhura më të pakta në një shoqëri. Një kurbë e tillë $y=L(x)$ quhet kurbë e Lorencit.

Drejtëza $y=x$ paraqet rastin ideal që i korespondon barazisë së plotë në shpërndarjen e të ardhurave. Meqënëse ky rast ideal nuk realizohet në praktikë, kurba e Lorencit zakonisht ndodhet poshtë drejtëzës $y=x$. Syprina e zonës midis drejtëzës $y=x$ dhe kurbës $y=L(x)$ paraqet devijimin e shpërndarjes aktuale të të ardhurave nga barazia e plotë dhe raporti i kësaj syprine me syprinën e zonës së kufizuar nga $y=x$ dhe boshtet në segmentin $(0,1)$ jep një tregues të pabarazisë në shpërndarjen e të ardhurës. Ky raport quhet Indeksi i Ginit dhe llogaritet nga formula:

$$I_G = \frac{\int_0^1 (x - L(x)) dx}{\frac{1}{2}} = 2 \int_0^1 (x - L(x)) dx = 1 - 2 \int_0^1 L(x) dx$$

¹ Department of Mathematics, Faculty of Information Technology “Aleksandër Moisiu”, University of Durrës

² University of Shkodra, brunalufi@yahoo.com

Indeksi i Ginit është një numër midis 0 dhe 1. Kur ai është zero kjo do të thotë se ka barazi të plotë në shpërndarjen e të ardhurave. Në qoftë se indeksi është 1 kemi një pabarazi të plotë në këtë shpërndarje.

Në Shqipëri, por edhe në shumicën e vendeve në zhvillim, ekziston perceptimi se pabarazia është më e madhe se në ekonomitë e zhvilluara.

Afrika e Jugut renditet si vendi me nivelin më të ulët të barazisë së të ardhurave në botë, fal një koeficienti Gini prej 63.0 kur u mat për herë të fundit në 2014. Thënë kështu, në vitin 2005, koeficienti Gini ishte edhe më i lartë, në 65.0. Në Afrikën e Jugut, 10% e më të pasurve zotërojnë 71% të pasurisë, ndërsa 60% më e varfër zotërojnë vetëm 7% të pasurisë. Për më tepër, më shumë se gjysma e popullsisë së Afrikës së Jugut jeton në varfëri.

Sipas raportit të Bankës Botërore për Varfërinë dhe Prosperitetin e Përbashkët 2020, koeficienti Gini rritet me rreth 1.5 pikë në pesë vitet pas epidemive të mëdha, si H1N1 (2009), Ebola (2014) dhe Zika (2016). Ndërsa efektet e pandemisë COVID-19 janë ende duke u llogaritur, vlerësimet e hershme parashikuan një rritje të koeficientit Gini prej 1,2-1,9 pikë përqindjeje në vit për 2020 dhe 2021, duke sinjalizuar një rritje të pabarazisë së të ardhurave (Population, n.d.).

Duke u bazuar në të dhëna CIA.gov kemi këto informacione në lidhje me indeksin në vende të ndryshme të Europës:

Tabela 1. Indeksi GIN për vendet e Europës

Vendi	Indeksi	Koha e informacionit	Ranku	Vendi	Indeksi	Koha e informacionit	Ranku
Bulgaria	40.4	2017 est.	60	Croatia	30.4	2017 est.	148
Montenegro	39	2015 est.	68	Estonia	30.4	2017 est.	149
Lithuania	37.3	2017 est.	81	Austria	29.7	2017 est.	150
Serbia	36.2	2017 est.	93	Poland	29.7	2017 est.	151
Romania	36	2017 est.	95	Malta	29.2	2017 est.	154
Italy	35.9	2017 est.	97	Kosovo	29	2017 est.	155
Latvia	35.6	2017 est.	101	Sweden	28.8	2017 est.	156
Luxembourg	34.9	2017 est.	109	Denmark	28.7	2017 est.	157
UK	34.8	2016 est.	110	Netherlands	28.5	2017 est.	159
Spain	34.7	2017 est.	111	Belgium	27.4	2017 est.	163
Greece	34.4	2017 est.	114	Finland	27.4	2017 est.	164
Portugal	33.8	2017 est.	120	Norway	27	2017 est.	165
Albania	33.2	2017 est.	129	Iceland	26.8	2015 est.	166
B&H	33	2011 est.	130	Ukraine	26.1	2018 est.	167
Ireland	32.8	2016 est.	132	Moldova	25.7	2018 est.	168
Switzerland	32.7	2017 est.	136	Belarus	25.2	2018 est.	169
Germany	31.9	2016 est.	140	Slovakia	25.2	2016 est.	170
France	31.6	2017 est.	142	Czechia	24.9	2017 est.	171
Cyprus	31.4	2017 est.	144	Slovenia	24.2	2017 est.	172
Hungary	30.6	2017 est.	147				

Burimi: CIA.gov (2022)

Në këtë renditje Shqipëria e ka vlerën e indeksit 33,2 dhe është e 129 në renditje, këto informacione i përkasin indeksit të vitit 2017. Ndërkohë në Shqipëri në vitin 2019 indeksi ishte 30.8. Kjo tregon se pabarazia ka ardhur në rënie. Sidoqoftë, Shqipëria


ngelet një vend me pabarazi më të madhe krahasuar me ekonomitë më të zhvilluara. Për vendet anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), që përgjithësisht prahen si vendet me ekonomi më të zhvilluara, mesatarisht indeksi Gini është në nivelin 31%, ose 4.4 pikë përqindje më i ulët se në Shqipëri. Për Bashkimin Europian, mesatarja e indeksit Gini është pothuajse në të njëjtin nivel. Vendet me pabarazinë më të ulët, sipas OECD-së, janë Sllovenia, Sllovakia dhe Republika Çeke, ku indeksi Gini qëndron poshtë nivelit të 25%. Eurostat dhe Bankës Botërore, nivelin më të ulët të pabarazisë në rajon e ka Kosova, me 29%, edhe më pak se mesatarja e BE-së dhe OECD-së. Ekonomia e dytë me pabarazinë më të ulët është Maqedonia e Veriut, me 31.9%. për Bosnjë Hercegovinën koeficienti Gini është 32.7%, por kjo shifër i takon vitit 2015, ndërsa nuk ekzistojnë të dhëna të përditësuara për vitet e fundit. Serbia dhe Mali i Zi janë në intervalin 35%-36%, duke qenë në nivele të pëafërta me Shqipërinë.

Sipas Instat (2022) rezulton se në Shqipëri pasuria, burimet dhe mundësitë ekonomike janë më të përqendruara në zonat urbane, pasi 30% e familjeve në zonat urbane janë në kuintilin më të lartë të pasurisë, krahasuar me vetëm 5% të familjeve në zonat rurale.

Në anën tjetër, vetëm 5% e familjeve në zonat urbane janë në kuintilin më të ulët, krahasuar me 42% të familjeve në zonat rurale, të cilat gjenden në kuintilin më të ulët të pasurisë.

Bazuar në të dhënat nga banka botërore kemi trendin e mëposhtem të koeficientit në Shqipëri:

Tabela 2.



Duket në vitet e fundit të kemi luhatje të indeksit pas rritjes së fortë në 2012 për stabilizmin e tij, por për vitet e fundit parashikimet janë për rritje të indeksit për shkak të ndikimit të pandemisë covid 19.

Në këtë punim do të analizojmë marrëdhënien midis pabarazisë dhe rritjes ekonomike. Të dhëna janë siguruar nga Banka Botërore (Bank, 2021) për GINI index dhe GDP për capita për vitet 1999-2020 për rastin e Shqipërisë.

Analiza empirike

Në lidhje me marrëdhënien midis GINI index dhe GDP për capita, rezultatet e marra nga punimet empirike të mëparshme ishin të përziera. Autorë të tillë si (Persson, T., and G. Tabellini, 1991) dhe (Alesina, A., and D. Rodrik, 1994) gjejnë dëshmi të një marrëdhënie negative midis dy variabla, përkundrazi, (Li, H., and H. Zou, 1998) dhe (Forbes, 2000) e gjejnë një pabarazi më të madhe, pabarazia që shoqërohet me rritje më të shpejtë ekonomike. Ndërkohë (Barro, 2008) pohon se pabarazia ka një efekt pozitiv në rritjen e GDP -së në ekonomitë e përparuara, por ka një ndikim negativ në ato në zhvillim.

Analiza korrelative

Për të zbuluar lidhjen lineare midis dy variablave përdorim koeficientin e korrelacionit të Pearson, i cili jepet nga formula (Thakur.M, 2018):

$$r = \frac{n \sum xy - (\sum x)(\sum y)}{\sqrt{[n \sum x^2 - (\sum x)^2][n \sum y^2 - (\sum y)^2]}}$$

Koeficienti i korrelacionit të Pearson-it merr vlerat midis -1 dhe 1 (Thakur.M, 2018). Interpretimi i koeficientit të korrelacionit është si më poshtë:

- Nëse koeficienti i korrelacionit është afer -1, ai tregon një lidhje të fortë negative. Ai nënkupton një marrëdhënie të forte negative midis variablave.
- Nëse koeficienti i korrelacionit është 0, ai tregon se nuk ka lidhje lineare midis variablave.
- Nëse koeficienti i korrelacionit është afer 1, ai tregon një marrëdhënie të fortë pozitive. Ai nënkupton një marrëdhënie të forte pozitive midis variablave.

Për të zbuluar se sa e fortë është lidhja midis dy variablave përdorim t test për koeficientin e korelacionit (Holmes. A & Illowsky. B and Dean. S, 2019) dhe jepet nga formula:

$$t_{STAT} = \frac{r - p}{\sqrt{\frac{1 - r^2}{n - 2}}}$$

Ngrihen hipotezat:

$H_0: \rho = 0$ (nuk ka korrelacion linear midis X dhe Y)

$H_1: \rho \neq 0$ (korelacioni ekziston)

Nëse t. stat në vlerë absolute është më i madh se vlera kritike, atëherë H_0 refuzohet. Vlera kritike e testit t të gjetur në tabelën t me n-2 shkallë lirie dhe vlerë domethënëse 5%, kjo është hipoteza e dy bishtave (Tabela e vlerave kritike: Korrelacioni Pearson, n.d.). Mund të përdorim edhe vlerën e p sipas së cilës në p është më vogël se niveli i rëndësisë së vendosur, atëherë hipoteza bazë bie poshtë.

Bazuar në rezultatet e koeficientit të korrelacionit rezultojnë se të gjitha lidhjet janë statistikisht të rëndësishme në nivelin 5% dhe për më tepër:

Ekziston një korrelacion mesatar pozitiv midis indeksit Gini dhe PBB-së për frymë, fuqisë punëtore dhe papunësisë, ndërkohë lidhja negative është mes popullsisë rurale dhe popullsisë aktive.

Në tabelën 3 e mëposhtme po paraqitim koeficientet e korrelacionit dhe vlerat e p-së:

Korrelacioni	X ₁	X ₂	X ₃	X ₄	X ₅
Gini	0.586 (0.002)	0.629 (0.001)	- 0.653 (0.000)	-0.773 (0.000)	0.630 (0.001)

2. Vlerësimi i modeleve

Për të vlerësuar modelin e Gini do të përdorim një sërë variablash ekonomike si PBB për frymë, forca e punës, popullsia aktive, popullsia në zonat rurale etj.

PBB për frymë (US\$ aktual): GDP për frymë është mënyra më e mirë për të krahasuar produktin e brendshëm bruto midis vendeve. Kjo për shkak se disa vende kanë rezultate të mëdha ekonomike, sepse kanë kaq shumë njerëz. Për të marrë një pamje më të saktë, është e dobishme të përdoret GDP për frymë.

Forca e punës: Përqindja e fuqisë punëtore në krahasim me popullsinë e përgjithshme në teori duhet të ketë një lidhje lineare me pabarazinë e të ardhurave. dmth. një vend me vetëm 10% fuqi punëtore do të ketë një pabarazi shumë të lartë të të ardhurave, sepse kurba e Lorencit do të fillojë nga vlera 90%. Ndërsa përqindja e fuqisë punëtore rritet, kjo pabarazi duhet të ulet, duke supozuar se përqindja e papunësisë si pjesë e fuqisë punëtore mbetet e njëjtë.

Popullsia e moshës 15-64 vjeç (% e totalit): Rritja e popullsisë së klasës punëtore përgjithësisht çon në përqindje më të lartë të fuqisë punëtore dhe numër më të lartë të njerëzve të punësuar. Kjo shkakton uljen e pabarazisë në të ardhura

Popullsia rurale: Ndryshe nga popullsia urbane, popullsia rurale ka vetëm një sasi të kufizuar mundësisish pune. Kjo çon në përqindje më të madhe të popullsisë me të ardhura të ngjashme. Kjo shkakton uljen e pabarazisë së të ardhurave.

Papunësia, totali (% e forcës totale të punës): Ndërsa shkalla e papunësisë rritet, konkurrenca për një punë të caktuar rritet, duke çuar në ulje të pagave në të gjithë bordin. Meqenëse përqindja e vendeve të punës me paga më të ulëta është përgjithësisht më e lartë se ajo e punëve me pagë më të lartë, kjo çon në një numër më të madh të njerëzve me paga më të ulëta. Pra, të ardhurat mesatare ulen më shumë se të ardhurat mesatare, duke çuar në pabarazi më të lartë të të ardhurave.

Modeli i përgjithshëm i regresit është:

$$Y_t = \beta_0 + \beta_1 X_1 + \beta_2 X_2 + \beta_3 X_3 + \beta_4 X_4 + \beta_5 X_5 + u_t$$

Ku Y_t është indeksi Gini

X_1 është GDP për frymë

X_2 Përqindja e fuqisë punëtore në krahasim me popullsinë e përgjithshme

X_3 Popullsia e moshës 15-64 vjeç (% e totalit):

X_4 Popullsia rurale

X_5 Papunësia, totali (% e forcës totale të punës)

Shenjat e pritura të koeficientëve janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Koeficientët	β_1	β_2	β_3	β_4	β_5
Shenja	+	-/+	-	-	+

Tregues që përdoren për përzgjedhjen e modelit

1. R katror: është madhësia e ndikimit ose aftësisë së variablave parashikues në të njëjtën kohë në përshkrimin e ndryshores së varur. Nëse vlera është më shumë se 0.5, atëherë aftësia e variablit parashikues është e fortë në shpjegimin e variablit të varur. Ndërsa anasjelltas nëse vlera është më e vogël se 0.5, atëherë aftësia e ndryshores parashikuese nuk është e fortë në shpjegimin e variablit të varur (Gujarati, D.N. dhe Porter, D.C, 2009) Koeficienti jepet me formulën:

$$R^2 = 1 - \frac{\sum_i (y_i - \hat{y}_i)^2}{\sum_i (y_i - \mu)^2}$$

ku y_i –janë vlerat e vëzhguara, \hat{y} janë vlerat e vlerësuarra dhe μ mesatarja për ndryshoren e varur.

2. Katrori R i rregulluar: është madhësia e ndikimit ose aftësisë së variablave parashikues në të njëjtën kohë në shpjegimin e ndryshores së varur duke vëzhguar gabimin standard. Shpjegimi është i njëjtë me R-katror, por kjo vlerë është korrigjuar me gabim standard (Gujarati, D.N. dhe Porter, D.C, 2009). R katror i rregulluar jepet nga formula

$$\overline{R^2} = 1 - (1 - R^2) \left[\frac{n - 1}{n - (k + 1)} \right]$$

Ku k është numri i ndryshoreve të pavarura.

3. Statistika F-Fisher: Kjo statistikë F tregon nivelin e rëndësisë së ndikimit të variablit parashikues ndaj variablit të varur. Për ta përdorur këtë, vlera F duhet të krahasohet me vlerat kritike të Fisher me shkallë lirie k dhe (n-k-1)e nivel rëndësie të caktuar nga studiuesi. Por për të lehtësuar, ne mund të shohim drejtpërdrejt vlerën e Prob (F-Statistics) (Gujarati, D.N. dhe Porter, D.C, 2009). Statistika Fisher jepet me formulën:

$$F = \frac{R^2/k}{(1 - R^2)/(n - k - 1)}$$

Hipoteza bazë është:

$$H_0: \beta_1 = \beta_2 = \dots = \beta_k = 0$$

Nëse vlera e vrojtuar e testit e kalon vlerën kritike, atëherë hipoteza bazë bie poshtë.

4. Kriete e informacionit. Kriteri (Akaike, (1974) AIC përdoret si statistika të përshtatjes së mirë dhe ne e përdorim atë për zgjedhjen e modelit nga klasa e modeleve të vlerësuarra për fenomenin nga e njëta bazë të dhënash. Formula matematikore për AIC tregohet në ekuacionin e mëposhtëm

$$AIC(M) = -2 \log L(M) + 2 \cdot p(M)$$

$L(M)$ është funksioni i përgjasisë maksimale MLE (Maximum Likelihood Estimators) që është përdorur për të vlerësuar parametrat në modelin M dhe $p(M)$ është numri i parametrave të vlerësuar në modelin kandidat.

Sipas kriterit të informacionit modeli më i mirë është modeli që ka vlerat më të vogla të kriterit.

Tabela 5. Statistika përmbledhëse për modelet e vlerësuara

Modeli i vlerësuar	Fisher statistics	R squared	Adjusted R squared	Akaike info criterion
$Y_t = 28.21 + 0.0008 * X_1$	13.38009 (0.000)	0.389181	0.360095	4.006496
$Y_t = 34.344 - 0.047 * X_2$	0.083371 (0.77)	0.003954	0.002954	4.495489
$Y_t = -8.034 + 0.593 * X_3$	15.63003 (0.000)	0.426700	0.399400	3.943105
$Y_t = 40.64 - 6.45e-06 * X_4$	27.24208 (0.000)	0.564695	0.543967	3.667742
$Y_t = 36.86 - 0.37 * X_5$	2.547184 (0.125)	0.108174	0.065706	4.384967
$Y_t = 51.15 + 5.63 * \ln(X_1) + 0.23 * X_2 - 2.59 * X_3 - 34.3 * \ln(X_4) + 1.02 * X_5$	22.40287 (0.000)	0.868232	0.829476	2.820567

Burimi: Punimi i autorëve

Bazuar në treguesit e mësipërm, modeli më i mirë është modeli i fundit, ku Gini shprehet në varësi të të gjithë variablave të përzgjedhur.

Vlefshmëria e modelit

Për modelin më të mirë të përzgjedhur, duhet të kërkojmë teste për plotësimin e Supozimit OLS (Gujarati, D.N. dhe Porter, D.C, 2009).

Të gjithë variablat shpjegues janë të pakorreluar me termin e gabimit. Ky supozim kërkon që vlerat e vëzhguara të variablave të pavarur të përcaktohen në mënyrë të pavarur nga termi i gabimit. Për të zbuluar problemet që shfaqen në gabimin e specifikimit të modelit të zgjedhur, ne përdorim testin RESET (Ramsey J. B., 1969) (Ramsey J. B., 1974).

Hipoteza zero është H_0 : modeli është specifikuar saktë

Statistikat Fisher përdoren për të testuar hipotezën.

$$F = \frac{(R_{new}^2 - R_{old}^2) / \text{number of new regressors}}{(1 - R_{new}^2) / (n - \text{number of parameters in the new model})}$$

Vëzhgimet e termit të gabimit janë të pakorreluara me njëra-tjetrën (pa korrelacion serik). Vëzhgimet e termave të gabimit nxirren në mënyrë të pavarur (dhe për rrjedhojë nuk lidhen) nga njëra-tjetra. Kur gabimet e vëzhguara ndjekin një model, ato thuhet se janë të ndërlidhura në mënyrë serike ose autokorrelative. Për të testuar nëse ky supozim është i plotë, ne përdorim testin Breusch-Godfrey (Asteriou, Dimitrios; Hall, Stephen G, 2011) për AR (p).

Hipoteza bazë e ngritur është H_0 : nuk ka korrelacion në termin e gabimit

Për të testuar hipotezën përdoret statistika Fisher ose Chi-square. Nëse vlera e vëzhguar e testit është më e madhe se vlera kritike, hipoteza bazë refuzohet.

Termi i gabimit ka një variancë konstante (pa heteroskedasticitet). Vëzhgimet e termit të gabimit vijnë nga e njëjta shpërndarje probabiliteti me një variancë konstante. Nëse varianca e shpërndarjes së termit të gabimit ndryshon për çdo vëzhgim ose gamë vëzhgimesh, atëherë kemi atë që quhet heteroskedasticitet

Për të testuar përmbushjen ose plotësimin e këtij supozimi ne përdorim Breusch-Pagan test (Breusch, T. S.; Pagan, A. R., 1979). Hipoteza zero e ngritur është H_0 : variancat e termit të gabimit janë konstante (pa heteroskedasticitet)

Për të testuar hipotezën përdoret statistikat Fisher ose Chi-square. Nëse vlera e vëzhguar e testit është më e madhe se vlera kritike, hipoteza bazë refuzohet.

Termi i gabimit shpërndahet normalisht. Tashmë kemi supozuar se vëzhgimet e termave të gabimit janë nxjerrë në mënyrë të pavarur nga një shpërndarje që mesatarja zero ka një variancë konstante Tani, ne specifikojmë formën e shpërndarjes. Shpërndarja normale supozohet. Për testim përdoret testi Jarque-Bera (Jarque, Carlos M.; Bera, Anil K., 1980). Statistikat e Jarque-Bera janë:

$$JB = \frac{n}{6} \left[S^2 + \frac{(k-3)^2}{4} \right] \sim \chi^2$$

Në këtë rast hipoteza zero është: H_0 : Termi i gabimit është i shpërndarë normalisht, $u_i \sim N(0, \sigma^2)$

Nëse vlera e vëzhguar e testit është më e madhe se vlera kritike, hipoteza bazë refuzohet.

Rregulli: Ne do të përdorim në çdo rast për testimin e hipotezave të vlerave p. Nëse vlera p e testit përkatës është më e vogël se vlera e rëndësisë (5%), atëherë hipoteza zero refuzohet.

Rezultatet përmbledhëse për të gjitha testet janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 6: Rezultatet e testeseve të vlefshmërisë

Testimi	Vlera e testit	Vlera e p	Rezultati
Heteroskedasticiteti	0.128116	0.9839	pranohet
Autokorrelacioni	0.13382	0.8758	pranohet
Specifikimi	1.452889	0.265	pranohet
Normaliteti	0.32	0.19296	pranohet

Burimi: Përpunim i autorëve

Bazuar në vlerën p kemi:

Për variancën konstante të mbetjeve kemi $p = 0.9839$ që është më e madhe se vlera 5% e rëndësisë së H_0 pranohet. Pra, modeli nuk vuan nga heteroskedasticiteti dhe supozimi plotësohet.

Për autokorelacionin kemi $p = 0,8758$ është më e madhe se vlera e 5% e rëndësisë së H_0 pranohet. Pra, modeli nuk vuan nga autokorrelacioni dhe supozimi është përmbushur.

Për testin mbi gabimin e specifikimit të modelit të zgjedhur kemi $p = 0.2650$ është më e madhe se vlera 5% e rëndësisë së H_0 pranohet. Pra, modeli nuk vuan nga gabimi i specifikimit të modelit të zgjedhur.

Për normalitetin e mbetjeve kemi $p = 0.19296$ është më e madhe se vlera 5% e rëndësisë së H_0 pranohet. Pra, mbetet e modelit kanë shpërndarje normale.

Meqenese modeli vuan nga autokorelacioni kryejme eliminin e tij duke përdorur metodën e Darbin dhe modeli i ri nuk vuan nga autokorelacioni

Pra nga analiza kemi se modeli i përzgjedhur si më i mirë dhe që mund të përdoret për parashikime është:

$$Y_t = 15.3 + 5.6 * \ln(X_1) + 0.23 * X_2 - 0.25 * X_3 - 34.3 * \ln(X_4) + 0.92 * X_5$$

Nga ku kemi se me rritjen 1% në secilin nga variablat e pavarur kur të tjerët mbahen konstant çon rritjen e indeksit me 0,056 GDP për frymë, 0,23 për fuqinë punëtore dhe 0.92 për fuqinë punëtore, ndërkohë për popullsinë aktive dhe atë rurale rënia është me 0.25 dhe 0.34

Konkluzione

Për studimet ekonomike dhe ata sociologjike me interes është studimi i shpërndarjes të të ardhurave ose mirëqenies në një shoqëri. Në Shqipëri, por edhe në shumicën e vendeve në zhvillim, ekziston perceptimi se pabarazia është më e madhe se në ekonominë e zhvilluara.

Duke analizuar marrëdhënien midis pabarazisë dhe rritjes ekonomike për GINI index dhe GDP për capita për vitet 1999-2020, për rastin e Shqipërisë, bazuar në rezultatet e koeficientit të korrelacionit rezulton se të gjitha lidhjet janë stastitkisht të rëndësishme në nivelin 5% dhe për më tepër: ekziston një korrelacion mesatar pozitiv midis indeksit Gini dhe PBB-së për frymë, fuqisë punëtore dhe papunësisë, ndërkohë lidhja negative është mes popullsisë rurale dhe popullsisë aktive.

Bazuar në statistiken përmbledhëse të modeleve të vlerësuar, modeli më i mirë është modeli, ku Gini shprehet në varësi të të gjithë variablave të përzgjedhur.

Për modelin më të mirë të përzgjedhur, përdorëm testet e vlefshmërisë së modelit dhe nga këto teste rezulton:

- a) modeli nuk vuan nga heteroskedasticiteti, variancat e termit të gabimit janë konstante.
- b) modeli nuk vuan nga autokorrelacioni,
- c) modeli nuk vuan nga gabimi i specifikimit të modelit të zgjedhur,
- d) mbetet e modelit kanë shpërndarje normale.

Arrijmë në përfundim se rritja 1% në secilin nga variablat e pavarur kur të tjerët mbahen konstant, çon rritjen e indeksit me 0,056 GDP për frymë, 0,23 për fuqinë punëtore dhe 0.92 për papunësinë, ndërkohë për popullsinë aktive dhe atë rurale rënia është me 0.25 dhe 0.34.

Bibliografia

- Akaike, H. ((1974). Information Theory and an Extension of the Maximum Likelihood Principle. *Second International Symposium on Information Theory*.
- Alesina, A., and D. Rodrik. (1994). Distributive Politics and Economic Growth. *The Quarterly Journal of Economics*, Vol. 109, <http://qje.oxfordjournals.org/content/109/2/465.short>.
- Asteriou, Dimitrios; Hall, Stephen G. (2011). The Breusch–Godfrey LM test for serial correlation. *Applied Econometrics*, pp. 159–61.
- Bank, W. (2021). *Word Bank data*. Retrieved from <https://data.worldbank.org/country/albania?view=chart>
- Barro, R. J. (2008). Inequality and Growth revisited. *Working paper series on regional economic integration*, n. 11, <http://ideas.repec.org/p/ris/adbrei/0011.htm>.
- Breusch, T. S.; Pagan, A. R. (1979). A Simple Test for Heteroskedasticity and Random Coefficient Variation. *Econometrica*, 1287–1294.
- Forbes, K. J. (2000). A Reassessment of the Relationship Between Inequality and Growth. *The American Economic Review*, Vol. 90, <http://www.jstor.org/stable/117312>.
- Gujarati, D.N. and Porter, D.C. (2009). *Basic Econometrics, 5th Edition*,. McGraw Hill Inc., New York.
- Holmes. A & Illowsky. B and Dean. S. (2019). *INTRODUCTORY BUSINESS STATISTICS*. <https://opentextbc.ca/introbusinessstatopenstax/chapter/testing-the-significance-of-the-correlation-coefficient/>.
- Jarque, Carlos M.; Bera, Anil K. (1980). Efficient tests for normality, homoscedasticity and serial independence of regression residuals. *Economics Letters*, 255–259.
- Li, H., and H. Zou. (1998). Income Inequality is not Harmful for Growth: Theory and Evidence. *Review of Development Economics*, <http://onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1111/1467-9361.00045/abstract>.
- Persson, T., and G. Tabellini. (1991). Is inequality harmful for growth? Theory and evidence. *NBER Working Paper No. 3599*, <http://www.nber.org/papers/w3599>.
- Population, W. (n.d.). <https://worldpopulationreview.com/country-rankings/gini-coefficient-by-country>.
- R, Zulfikar. (n.d.). Estimation model and selection method of panel data regression : an overview of common effect, fixed effect, and random effect model.
- Ramsey, J. B. (1969). Tests for Specification Errors in Classical Linear Least Squares Regression Analysis. *Journal of the Royal Statistical Society, Series B*, 350–371.
- Ramsey, J. B. (1974). Classical model selection through specification error tests. *Frontiers in Econometrics*. New York: Academic Press, 13–47.
- Table of Critical Values: Pearson Correlation*. (n.d.). Retrieved from <https://www.statisticssolutions.com/free-resources/directory-of-statistical-analyses/pearsons-correlation-coefficient/table-of-critical-values-pearson-correlation/>
- Thakur.M. (2018). Pearson Correlation Coefficient. *Financial Modeling Guides . Excel Modeling*, <https://www.wallstreetmojo.com/pearson-correlation-coefficient/>

DISA KONSIDERATA LIDHUR ME EKONOMINË INFORMALE

Dr. Dashmir ASANI

Abstract

The article analyzes some main models for calculating the informal economy which are affected by the speed of money circulation. Under these conditions, a considerable number of calculations must be performed to identify the most present factors in the formation of the informal economy. In monetary models, the fact that a certain number of indicators and indicators should be treated is dealt with.

Hyrje

Duke analizuar sipas modeleve kryesore ne konstatojmë se njehsimi i ekonomisë informale në rastin konkret është i ndikuar nga shpejtësia e qarkullimit të parasë që në mënyrë empirike në këtë punim është vlerësuar të jetë 8% më e lartë në sektorin formal se atë informal, gjë që duhet të reflektohet në një gabim marginal të këtij rendi për madhësinë e llogaritur. Për këto shkaqe kemi kryer një numër të konsiderushëm matjesh të veçanta dhe nëpërmjet regresioneve dhe kemi identifikuar setin e faktorëve më të pranishëm në formimin e ekonomisë informale në RMV që rezultojnë të jenë grupuar në klasa përkatësisht taksa, indekse dhe indikatorë. Për secilën kategori kemi marrë një ose më shumë elementë si pjesë e modeleve. Në modelet monetare ne vërejmë se taksat mesatare të ponderuara, TVSh dhe Taksa mbi lëndët e para shfaqen si “Taksa” d.m.th. simuluese për EI, në model me një besueshmëri statistikore të mirë. CPI rezulton me ndikim të papërcaktuar dhe natura e veprimit të tij mendohet e çftuar me varibala të tjera, gjë që është trajtuar posaçërisht.

Po kështu GDP duket sikur është e korreluar negativisht me EI. Variabli Remitancat, është gjetur me ndikim negativ në EI e llogaritur sipas modeleve të parasë. Disa variabala të tjera si ato të lidhura me pagat dhe intersat bankare shfaqen me ndikim të papërcaktuar ose të ndryshëm nga modeli në model ndaj janë trajtuar në kuadër të modeleve jolineare. Duke analizuar dinamikën e serive kohore të variablave ne konstatojmë jostacionaritet të gjendjeve, sjellje specifike dhe praninë e regjimeve ciklike që mund të ndikojnë në rezultate. Kështu, ne kemi identifikuar një regjim afatmesëm të parasë në qarkullim që ka nisur në 2003-2006 dhe mbaron më 2018, gjë që përkeqëson njehsimet në skajet e këtij intervali. Për këtë arsye në modelimin e përbashkët me shumë faktorë dhe shumë përgjigje (MIMIC) ne kemi ulur sinjifikancën statistikore në 0.9 ose dhe në 0.85 për të kapur efektet e çftimeve mes variabaleve dhe në modelet direkte kemi përjashtuar skajet e regjimeve.

Gjithashtu, në rastin e përfshirjes së një variabli faktor i tipit politik dhe social i sugjeruar nga modelet standarte, ne kemi konsideruar shfaqjen e tij ekonometerike për të evituar subjektivitetin e këtyre variableneve apo përfshirjen e vlerave kategorike që në kushtet e serive të reduktuara fusin gabim shumë të madh. Në këtë mënyrë është rianalizuar efekti i faktorëve në ekonominë informale nëpërmjet ekuacionit strukturor.

Ekonomia informale

Ekonomia informale është përkufizuar në mënyra të ndryshme por logjikisht mund të pranohet si e tillë **gjithshka që nuk është regjistruar**. Përgjithësisht EI trajtohet si problem dhe si shënjë e keqe për ekonominë, megjithatë në sasi të vogla nuk funksion si penguese. P.sh., *disa shërbime individuale, në banesë, në ekonomi të vogla janë të pamundura të hyjnë në sistemin formal të ekonomisë, pasi kostoja e këtij procesi është shumë më e lartë se përfitimi social*. Kështu edhe në shumë vende të demokracisë së lartë dhe shumë të formalizuara llogaritet se rreth 7-10% e gjithë GDP është informale. Vendet e zhvilluara kanë rreth 20%

të aktiviteteve në sektorin informal, ndërsa shifrat mbi 25 % konsiderohen të dëmshme. Nëse ekonomia informale arrin mbi 70% të ekonomisë së një vendi, praktikisht sistemi ekonomik i tij është i rënë. Ekonomia informale ka edhe një term të rëndësishëm për të kuptuar problemin: ekonominë e zezë dhe atë kriminale. Për këto shkaqe njohja e saj ka rëndësi jo vetëm ekonomike, por edhe sociale dhe politike. Situata (gjendja) makro e një entiteti ekonomik nacional a më gjërë është bashkësi e të gjithë faktorëve ekonomikë e financiarë që bashkëveprojnë ndërmjet tyre dhe me sistemet në kontakt pasi ekonomitë shkëmbejnë të mira dhe shërbime në mënyrë të vazhdueshme. Ndërsa në vështrimin klasik kjo gjëndje njihet/barazohet me faktorë që janë të matshëm dhe të regjistrueshëm, në kohët modern pikërisht për shkak të bashkëveprimit dhe transformimit të ndërsjelltë, makro, gjëndjes ekonomike i është shtuar edhe një tjetër dimension, përkatsisht pjesa e peregjistruar e ekonomisë, pra ekonomia hije. Njohja e saj edhe pse indirekte, ka rëndësi jetike për politikat e zhvillimit dhe suksesin e reformave.

Rritja e ekonomisë informale do të reflektohet në rritjen e kërkesës për para”.

Nëse do shënonim me E_{Sh} ekonominë hije që përfshin edhe ekonominë informale dhe me C_D do prisnim korrelacion pozitiv:

$$E_{hije} \sim Kërkesë_{para}$$

$$Ekonomia_{informale} \sim Kërkesë_{para}$$

Ekonomia informale e peregjistruar dhe ekonomia e pamatashme përbëhet kryesisht nga ekonomia e peregjistruar, ose që nuk zbaton ligjin fiskal dhe sidomos

- *Aktivitetet e perditshmërisë shtepijake.*
- *Aktivizimi në sektorin informal për nevoja familjare, si punësim apo kryerje shërbimesh ushtrim profesioni jashtë licensimit, etj, jashtë optikës shtetërore në kuptimin e regjistrimit dhe jo shmangies së taksave.*
- *Remitancat, paratë e sjella nga emigrantët në rrugë jo bankare, pajisjet e futura nga jashtë me transport ilegal.*

Ajo përfshin pjesën e padukshme të GDP në kuptimin e legjilacionit fiskal, d.m.th. e padukshme për optiken fiskale. Individë dhe firma kërkojnë të shmangin detyrimet (taksat) [shneider]] dhe për pasojë nuk regjistrojnë aktivitetin e tyre, ose e regjistrojnë pjesërisht. Rasti me i butë është ai i regjistrimit, por deklarimeve fallso financiare, p.sh. nëpërmjet bilanceve të rreme. Ekonomia informale e këtij tipi mund të bëhet e dukshme në kohë të caktuara, p.sh. në aksionet qeveritare për mbledhjen e taksave për tu ulur përsëri poshtë horizontit të pamjes fiskale. Kjo lloj ekonomie ka të gjitha tiparët e ekonomisë së rregullt përveç faktit të mospagesës së taksave. Supozimet klasike të njehsimit të madhësisë së ekonomisë informale vlejné për këtë pjesë. Kështu struktura e kapitalit, e prodhimit, utiliteti, ciklet e parasë janë të njëjta. Në çastin kur malli i prodhuar në këtë sektor del në treg ai humbet origjinën dhe kthehet në formal. Kështu perimet e prodhuara nga një fermer informal sapo hyjnë në treg, trajtohen si të gjitha prodhimet e tjera nga kompanitë e rregullta. Çmimet e mallit të prodhuar në këtë sektor janë pak më të ulta në momentin e shfaqjes (realizimit) në treg, por nuk dallojnë pas këtij momenti. Në këtë mënyrë, kjo ekonomi i bashkëngjitet ekonomisë së rregullt pa asnjë deformim shtesë dhe pritet të gjëndet në GDP në momentin e mëpastajmë, ose në të njëjtën kohë shfaqet në GDP sipas konsumit. Kjo e lehtëson identifikimin e saj dhe prej saj edhe njohjen e masës së taksave të paguara. Njehsimi i saj me një sërë teknikash është mjaftushmerisht i mirë.

Ekonomia e paligjshme me origjinë shkelje të ligjit dhe veprat korruptive.

Ekonomia e paligjshme është shumë e larmishme. Kjo komponente lidhet me nivelin e përgjithshëm ekonomik, me pragmatizmin negativ (p.sh. blerja e një të drejte, një çertifikate,

apo shërbimi), me utiletet rastësore (ngutja për të patur një dokument), me nivelin e taksave (evazioni fiskal në prodhim, tregtim, etj), lidhjet nepotike (përfitimet e paligjshme, p.sh. përdorimet me prokurimet publike, etj). Këtu hyjnë :

- *Përfitimet e paligjshme nëpërmjet mitdhënies e mitmarrjes*
- *Përfitimet aktive dhe pasive nëpërmjet sistemit të korrupsionit lidhur tjetësimet e pasurisë*
- *Ekonomia e zezë, ose ekonomia e vënë në dhunim flagrant të ligjit penal. Kjo ekonomi lidhet me veprat e kundraligjshme dhe kriminale. Këtu hyjnë :*
 - *Trafiqet e armeve drogës dhe përgjithësi trafiqet e paligjshme*
 - *Aktivitet shoqeruese të prostitucionit si hoteleritë ilegale apo legale që ushtrojnë aktivitet kriminal*
 - *Trafiqet e qënieve njerëzore*

Aspekte të përgjithshme të llogaritjes se Ekonomisë Hije dhe asaj informale në sistemin e përzgjedhur

Në të gjitha aplikimet përfshirë edhe rastin tone, Ekonomia informale është njehësuar duke realizuar zbatime pro-active të modeleve, duke verifikuar çdo variabël në model. Ndërkohë, përveç bazës teorike sikurse trajtohet në [43], 034- apo në aplikimet si në [33], [38] etj. Bazuar në përcaktimet teorike të modeleve dhe realiteteve faktike te sistemit si dhe nga punimet paraardhëse si [42], [36] kemi gjykuar që në analiza se:

- **Variablat faktorë që shqyrtojmë**
 - Taksa, detyrime, kontribute, tarifa të aplikuara, që ushtrojnë presion mbi ekonominë formale duke favorizuar evazionin fiskal, shmangie në detyrime.
 - Interesat që kanë karakter tërheqës për paranë
 - Inflacioni dhe indekset e çmimit të konsumatorit, kanë ndikim favorizues teorik pasi shprehin koston e parasë
 - Makroparametra si niveli i pagave, gjendja ekonomike (GNI_capita, GDP_Capita) etj.
 - Në disa referenca dhe rishikime janë shtuar edhe variabla të tjere si papunësia etj.
- **Variablat përgjigje në sistem dhe indikatorët e ekonomisë informale.**
 - Paraja në qarkullim, paraja jashtë depozitave.
 - Paratë në përgjithësi, Narrow Money, Broad Money etj
 - Deflaktori i GDP
 - Indekse të tjere specifike si identifikues për rastin tonë konkret.
- **Variabla dhe kushte perturbuese në sistem**
 - Remitancat në monedhë të huaj dhe balanca e tyre (inflow/outflow), pasi paraja e huaj qoftë Euro qoftë USD mund të shërbëjnë lehtësisht si mjet pagese pa u konvertuar.
 - Secili agragat (M0, M1, M2, etj)

Vështrim i përgjithshëm për vlerësimin e ekonomisë se përgjistruar

Në kohët moderne koncepti i ekonomisë informale ka fituar popullaritet dhe përfshihet rigorozisht në analizat makro. Situata makro e një entiteti ekonomik nacional a më gjërë konsiderohet si produkt i gjithë faktorëve ekonomik e financiar, në bashkëveprim me sistemet e kontaktit d.m.th. me ato që ekonomia përkatëse shkëmben mallra dhe produkte të tjera. Kjo mundëson vlerësimin e një variabli duke u nisur nga efektet direkte apo disturbancat e shaktuara në variabla të tjerë pra, aplikimin e metodave matëse matematikore. **Ekonomia Informale** është identifikuar në mënyra të ndryshme. Varianti që përmbledh gjithshka që nuk është formale do të konsiderohet në vijim si **Ekonomi Hije ose Ekonomi e Përgjistruar**. Tradicionalisht vlerësimi i termit “**Ekonomi Informale**” është bazuar në shfaqjen e efekteve të saj në disa makroparametra. Kështu një eksces në konsumin e energjise elektrike duhet të

tregojë madhësinë e ekonomisë që nuk shfaqet në GDP apo rritje të tij, transaksionet në cash duhet të lidhen me terma informale ekonomike, etj. Megjithatë ka një dallim të shënueshëm jo thjeshtë terminologjike. Në shfaqjen direkte të informalitet, GDP real p.sh. rezulton me i lartë se ai i llogaritur dhe diferenca është **Ekonomia totale e Paregjistruar**, ndërsa në matjet indirekte me modele, si rregull identifikohet **Ekonomia Informale** që nuk përfshin ekonominë vërtetë të padukshme që është ekonomia e zezë. Në këtë dallim e bëjmë të qartë në këte kapitull. Teknikat regresive në këtë rast kanë dhënë vlerësime të pranuar për shumë vende [72], [50] me dallime të vogla në variablat e përfshirë. Njehsimet dykahëshe d.m.th. me supozime strukture bazohen në mundësinë e shtrimit të një ekuacioni matricor i quajtur ekuacioni strukturor –SEM–(si rregull **MIMIC-Multi Indicator Multi Cause**), ku ekonomia informale ndërhyr si variabël i fshehtë dhe llogaritja duhet të konsiderojë variablin e kërkuar si komunikues ndërmjet shkaqeve dhe indikatorëve. Në këtë rast evidentohen më qartë lidhjet por shtohet edhe gabimi. Meqe lidhja e makroparametrave më së shumti karakterizon ekonominë që i shmanget detyrimeve për shkaqe ekonomike, njohja e kufijve të saj d.m.th. Ekonomisë Totale të Paregjistruar, është me rëndësi në studim. **Prandaj në këtë kapitull në veçanti ne konsiderojmë vlerësimin e parë të madhësisë së Ekonomisë Informale si Ekonomi e Paregjistruar, duke shënuar edhe fillimin e konturimit të tipeve të saj.** Duke aplikuar njehsimet empirike post factum d.m.th. me **metodikë matëse sipas indikatorëve**, është e mundur të kapet vlera marginale e saj. Meqë kjo kategori përfshin gjithë termat informale që trajtuam në kapitullin 1, më e përshtatshme dhe e bazuar është analiza e korrelimeve dhe qasjes së ecurive të disa vlerësuesve të përgjithshëm socioekonomike në sistem, me madhësinë e kësaj **Ekonomie të Paregjistruar**. Përkatsisht në këtë kuadër është vlerësuar bashkëlidhja me **përformancën e buxhetit të qeverisë; cilesinë e qeverisjes, korrupsionin apo remitancat**. Efekti i ndikimit të shkaqeve është trajtuar në disa raste për të nxjerë në pah aspekte të nevojshme për trajtimin vijues.

Modelet kryesore njehësuese

Teknikat e vlerësimit të ekonomisë informale janë diskutuar gjerësisht qoftë nga ana aplikative llogaritëse qoftë nga ana kritike. Ndër to më të aplikuara janë listuar në referencën [2] dhe si rregull shfaqen rutinë në të gjitha trajtimet për këtë çështje. Natyrisht që në këtë aspekt nuk mund të ketë kufizim dhe teknikat e tjera janë të aplikueshme, si dhe modele të reja janë propozuar. Proceset ekonomike, financiare dhe socioekonomike janë shumë më të komplikuar se sa paraqiten në modelime e aq më shumë në ato lineare. Kjo i klasifikon të gjitha llogaritjet si metoda të përafërta, ndaj ne i kushtojmë rëndësi në këtë punim vlerësimin faktik të kësaj përafërsie. Ndërsa formalisht, teknikat e njehsimeve janë të mirënjohura tashmë. Kështu modelet dinamike të referuar në [4], modelet e bazuar në householdings [6], modele të bazuar në ekuilibrin [11] dhe modele të tjera kryesisht simulime janë gjerësisht të aplikuara. Njehsimet e ekonomisë informale bëhen me metoda direkte dhe indirekte ose modele lineare analizuar në [2]. Përmbledhtazi po i sjellim në paragrafin vijues ndërsa në mënyrë të plotë do të trajtohen në kapitujt vijues.

Metoda e differences të ardhura - shpenzime (GDP-Approach).

Metodat e discrepancave shfrytëzojnë diferencat e dukshme mes faktit dhe pritshmërisë apo mes vlerave të një parametri të llogaritura sipas mënyrave të ndryshme. Në rastin e GDP këto vlera janë të mirënjohura nga databazet zyrtare ndaj ky vlerësim njëkohësisht konsiderohet teknika kryesore direkte e matjes dhe më e thjeshta. Teorikisht pranohet [2], [40] etj. se GNP apo GDP e llogaritur mbi bazë të të ardhurave apo prodhimit duhet të jetë saktësisht (me afërsi në gabime të përlloraritjeve) e barabartë me GNP apo GDP e llogaritur mbi bazën e shpenzimeve. Në realitet ato ndryshojnë. Diferenca duhet të tregojë ekonominë e paregjistruar. Në kushtet ideale shpenzimet e llogaritura në Gross National Product (GNP) duhet të jenë të

njejta me të ardhurat në GNP. Nëse është i mundur një vlerësim i pavarur i shpenzimeve në llogaritë kombëtare, diferenca mes këtyre shpenzimeve dhe të ardhurave të regjistruara është një indikator i ekonomisë hije sipas përcaktimit nga [49].

$$EH = [Shpenzime_{Totale}] - [Të Ardhura_{Totale}]$$

ku llogaritja është bërë në një cikël kohe të caktuar. Teknika është e thjeshtë por saktësia e saj e diskutueshme. Në mjaft raste me 2.1 është njëhësuar edhe EI por ne këtu bejmë dallimin mes këtyre dy elementëve duke mbajtur EH për të gjithë ekonominë e pajegjistruar ndërsa EI vetëm në atë pjesë që lidhet me aspekte ekonometrike d.m.th. gjenerohet nga faktorë ekonomike.

Metoda e raportit të monedhës në qarkullim-Simple Currency Ratio-SCR

Teknika Currency Ratio-SCR-pohon se deformimet e raportit *Para në Qarkullim (PQ) ndaj Parave në Depozita* shkaktohet nga efektet e ekonomisë hije. Këtu është supozuar se të gjitha transaksionet në ekonominë informale kryhen në cash, që në këtë mënyrë rrit sasine e parave në qarkullim krahasuar me depozitat. Në referencën [38] teknika e propozuar nga Cagan dhe Gutman është skicuar sipas procedurës se bazuar në një funksion produkti dhe pas një numri supoimesh dhe thjeshtizimesh prezantuar në [2] dhe paraqitur në Aneks, njehsimi do bëhet

$$GDP_h = GDP_f \frac{(C-\alpha_f D)}{(\alpha_f+1)D}$$

ku; $\alpha_f = \frac{C_f}{D_f}$ është raporti i parave në qarkullim me ato në depozita. Supozimi bazë është se

shpejtësia e qarkullimit të parave në sektorin formal (f) dhe informal janë të njëjta. Po kështu pranohet se struktura e kapitalit në të dy sektorët është e njëjtë.

$$\frac{C_f}{D_f} = \frac{C_h}{D_h}$$

Ekuacioni 2.3 është formula standarte e SCR me përafrimet e bëra në presumimet bazë të saj. Ndërkohë, duke marrë në konsideratë faktin se shpejtësitë e qarkullimit të monedhës në sektorin formal dhe informal mund të jenë të ndryshme, 2.3 nuk është i vërtetë dhe forma 2.2 ndryshon gjë që do ta shohim në paragrafin përkatës të kapitullit 3 dhe detajimet e kapitullit 5.

Metoda e transaksioneve

Për njehsimin e EI në sisteme ekonomike me regjistra të plotë, Feige ka propozuar (1979,) një teknikë llogaritëse që mbështetet në diferencën e transaksioneve totale llogaritur në forma të ndryshme. Kjo diferencë supozohet se shkaktohet tërësisht nga ekonomia informale EI apo ajo hije EH. Si bazë përdoret ekuacioni i balances monetare Fischer [49]

$$M * V = P * T$$

ku M është sasia totale e parave d.m.th. *currency +depozits* M, V është shpejtësia e qarkullimit të monedhës, përfaqëson çmimin dhe volumin e transaksioneve. Duke shënuar

$$r = \frac{GNP}{p * T}$$

në kushtet e gjëndjes së qëndrueshme ekonomike ky raport do duhej të ishte konstant në kohë. Nëse pranojmë një vit bazë kur EI nuk egzistonte dhe atëherë gjejmë raportin “normal”

$$r_0 = \frac{GNP}{p * T_{0, EI=0}}$$

$$GNP_n = r_0 * (p * T)_t$$

Ekonomia informale atëherë njehësohet

$$Ekonomia_{informale} = GNP_n - GNP_{zyrtar}$$

Teknika është kritikuar në një sërë aspektesh, kryesisht për pamundësinë e njohjes së volumit të transaksioneve dhe idenë e vitit origjinë me zero informalitet.

Currency Demand Approach-CDA-metoda e kërkesës për para.

Pozicioni prevalent dhe unik i parasë në ekonomi i bën analizat monetare substanciale në një trajtim llogaritës dhe njehsimi i EI është bazuar piksëpari në diskrepancat monetare. Teknika e kërkesës për para bazohet në vlerësimin e diferencës së parave në kushtet e informalitetit dhe në mungesën e tyre. Është futur së pari nga Cagan, pastaj është riparë nga Tanzi etj [2]. Supozimi fillestar, mbështetet në pranimin se ekonomia informale EI është efekt direkt i presionit të taksave të larta d.m.th. shmangie ndaj tyre. Logjika bazohet në optimizimin e funksionit të fitimit nga një ent ekonomik, për pasojë efekti i taksave duhet parë (marrë në konsideratë) i kundërbalancuar me performancën e mbledhjes së tyre që tregon se modeli mund të përfshijë variabla jo ekonomike. Kjo metode vlerësohet si një ndër më të rëndësishmet dhe ne do ti kushtohemi në këtë punim. Teknikat indirekte linearizuese të parasë bazohen në funksionin Cagan 3. 1. 1 për paranë

$$C = \prod_{(i)} (1 + A)^{\beta} X_i^{\alpha_i} \exp(-\gamma j)$$

që është riparë dhe axhustuar vijimësisht [2], [3], [30]. Trajta 3.1.1 është fleksibël dhe mbështetet nga një numër argumentesh teorike. Duke vënë në 3.1.1 dhe duke logaritmuar Cagan propozoi për njehsim

$$\log(C_t) = \alpha_i \log(GDP_t) + \beta \log(1 + Tax) - \gamma R + \varepsilon$$

ku C_t është paraja në qarkullim në çastin t. Më vonë versione që marrin këtë madhësi të normuar ndaj parasë M_1 ose M_2 janë më të pranuar. Versioni 2. 9 është pasuruar nga Tanzi dhe me pas është rishikuar në një numër rastesh. Si rregull variablat do të korrektohen me deflatorin e GDP gjithashtu [2], [49].

Si rregull shumë praktikues kërkojnë një vit origjinë (taksa minimale,) dhe marrin $EI = 0$. Në këte rast vlera e variablit shkak përkon me vlerën e atij momenti. Llogaritja me regresionin e gjetur jep vlerën «natyrale» të parasë me kushtin shkak zero dhe diferenca konsiderohet e shkaktuar nga informaliteti.

Përafrimi i papunësisit dhe përafrimi i konsumit të elektricitetit

Niveli i papunësisë zyrtare është një indikator informalitetit dhe vlerësimi i EI me studimin e papunësisit konsiderohet gjithashtu një metodë direkte matjeje. Kjo teknikë prezumon se diferenca mes fuqisë punëtore të punësuar zyrtare dhe asaj të vërtetë dëshmon për angazhim të fuqisë punëtore në tregun informal. Një rënie e fuqisë punëtore në tregun formal përbën një indikator të ekonomisë informale në vetvete. Nëse fuqia punëtore është prezumuar të mbetet konstante atëherë ndryshimi i nivelit të punësimit legal tregon prezencën e informalitetit. Një kritikë imediate [2] kësaj teknike i bëhet lidhur me shkaqet e punësimit në informalitet. Kështu, edhe pjesëmarrësit në punësim formal mund të jenë të punësuar në ekonominë informale d.m.th. si rregull kjo teknikë jep një vlerësim më të vogël. Sidoqoftë, një korrelacion mes papunësisit dhe ekonomisë informale mund të pranohet dhe mund të llogaritet EI nga lidhja

$$Ekonomia_{informale} = \mu U + \Sigma$$

ku U është shënuar raporti i nivelit të papunësisë me fuqinë aktive për punë ndërsa sigma shënon një term mbetës që në përafrimin linear njëvariabëlsh do të ishte thjeshtë një term stokastik ndërsa në modelim më të plotë një term mbetës funksion i variablave të tjere.

Inputet fizike kryesisht energjia janë tregues i aktiviteti në një mjedis ekonomik. Kaufman dhe Kalibera (1996) [2] kanë propozuar të vlerësojnë ekonominë informale duke u nisur nga mbishpenzimi i burimeve energjitike si elektriciteti, karburantet etj. Supozimi bazë është se

elasticiteti GDP konsum elektriciteti është pranë 1, por së paku është konstant dhe çdo largim nga kjo vlerë është indikator për praninë e informalitetit.

$$\frac{\Delta GDP}{\Delta E_{\text{Konsumuar}}} = k \cong 1$$

Punime të thelluara lidhur inputeve fizike kanë konsideruar kahun tjetër d.m.th. nga ekonomia tek inputet si fuqia punëtore si në rastin e DSGE –Dynamic Stochastic General Equilibrium-ne [29] që evidentojnë lidhje më komplekse mes faktorëve njeri me tjetrin dhe ambientit ekonomik. Duhet shtuar se në këtë rast madhesia e vlerësuar është në fakt më shumë ekonomia hije dhe jo thjeshtë ekonomia e ngushtë informale.

Metodat me ekuacione strukturore MIMIC, DYMIMI

Kjo teknikë e huazuar nga njehsimet sociometrike supozon se lidhja mes variablave indikatorë dhe disa variablave të quajtur shkaqe kryhet me ndërmjetesinë e një variabli latent apo disa syresh sikurse paraqitet ne Figurën 2.1. Njehsimi ketu është disi me algjebrik ndaj po prezantojmë vetëm idenë duke lënë shtjellimin e plotë në zonën përkatëse.

Variablat indikatorë të EI mund të jenë të shumtë, pasi ajo ndikon në një sërë parameterash ekonomike të vendit. P.sh. supozohet se zvogëlon GDP, rrit papunësinë zyrtare etj, që po i quajmë indikatorë $Y=[GDP \text{ PaPunësimi} \dots]$.

Ndërkohë EI shkaktohet nga një numër faktorësh, ose më saktë kushtezohet apo ndikohet nga një numër faktorësh: Taksat e larta, inflacioni i lartë, korrupsioni, supozohet se janë shtysë për rritjen e EI ndërsa zbatimi i ligjit, efikasitet fiskal, interesat e depozitave, gjëndja e përgjithshme e të ardhurave etj, kanë ndikim negativ d.m.th. ndikojnë në zvogëlimin e saj. I shënojmë të gjitha këto variabla me X pra $X=[Taksa, CPI, \dots]$. Lidhjet algjebrike kanë trajtën :

$$\begin{aligned} EI &= A * [X] + \varepsilon \\ [Y] &= B * E_I + \delta = B * (A * [X] + \varepsilon) + \delta = \\ & (B * A) * [X] + B * \varepsilon + \delta \\ & \Gamma [X] + B * \varepsilon + \delta \end{aligned}$$

ku ε dhe δ janë vektoret e devijimeve dhe Γ dhe B dy matrica që duhen njehësuar. Duke njehësuar dy matricat e fundit në fjalë ne mbërrim tek matrica e koeficienteve A që na jep EI. 2.11 nuk është një regresion i thjeshtë **zgjidhjet duhet të kënaqin të dy anët e lidhjes** së paraqitur në Figurën 2.1 ndaj llogaritjet kryhen me metodën MLE. Kjo teknikë ka gabim më të madh në dukje por është më solide pasi sikurse thamë **plotësimi i optimizimeve në të dy kahët mund të bëhet vetëm nëse modeli është i drejtë**. Pasi është konkluduar në sete të përshtatshme të indikatorëve Y dhe shkaqeve X , vijohet me njehsimin e EI pasi sikurse do të shohim në paragrafin perkates, ky njehsim bëhet me afërsinë (papërcaktueshmërinë) e një konstanteje. Përsëri kthehet problem fikismi i një momenti origjine, që përbën gjithashtu kritik për këtë model. Megjithatë me përmirësimet që i bëhen, modeli funksionon si një trajtim i mirëfillte shkencor i EI apo Hijë. Vërejmë se në të gjitha modelet ka për të diskutuar dhe se **eficenca e tyre varet fortësisht nga mjedisi ekonomik që studiohet**.




Figura 1. Skemë e një lidhjeje strukturore në modelin MMIC n-1-m.

Faktorët dhe variablat sipas modeleve

Ne studimin e Ekonomisë së Paregjistruar dhe Informale në vendet në zhvillim dhe ato në tranzicion ka disa vështirsi shtesë që u dalin ekonometristeve .

Së pari, të dhënat statistikore kanë pasaktësira burimore. P.sh. rritja e GDP në vlerësimet e FMN, BB, CIA Factbok dhe NBRMV nuk përkojnë. Në një hulumtim të detajuar për ekonominë shqiptare p.sh. [91] një mospërputhje e tillë është trajtuar gjerësisht dhe është komentuar si karakteristike. Sidoqoftë një ndër arsyt kryesore të mosperputhjes së rezultateve lidhet me metodologjinë e llogaritjes së treguesve ekonomik dhe financiar. Nga 2004 e në vijim, në RMV përlllogaritjet nga agjencitë shtetërore të menaxhimit të të dhënave është rikonceptuar dhe ridimensionuar duke reduktuar dukshëm ndjeshmerinë e indikatorëve ndaj rillogaritjeve. Sistemi i të dhënave të tilla në RMV i përpunon të dhënat ekonomike-financiare dhe konkludon në përputhje me Traktatin e KE të 2010 sikurse duket në faqen zyrtare të Bankës Qendrore [25].

Së dyti, ka terma mungues në databazë . Në RMV problemet me statistikën vijnë të jenë të dukshme edhe për shkaqe objektive. Nëse konsiderohet qarkullimi i parasë cash, që është një variabël thelbësor në trajtimin e EI, sistemi është i hapur, pasi sasi të konsiderueshme cash hyjnë e dalin pa mundur të regjistrohen duke krijuar një vakum të konsiderueshëm. Përkatësisht në periudhën 2000-2008 rreth 78% të remitancave nga emigracionini hynin në sistemin ekonomik të vendit jashtë sistemit bankar [15]. Një situatë e ngjashme haset edhe në vende me ekonomi të ngjashme në specifika dhe dimension si p.sh. në Shqipëri [18] dhe në shumë vende të tjera si kurse trajtohet në [3] etj.

Së treti , EI mund të ketë një komponent jo pa peshë në ekonominë e zezë, d.m.th. në ekonominë me origjinë korrupsionin dhe trafiket. Kjo ekonomi jo vetëm i përvdihet çdo sistemi zyrtar, por zhvillohet në një regjim krejt tjetër e për pasojë duhet të ndikojë në modelin në tërësi . Në [17] dhe [18] është trajtuar pjesërisht ky problem për një sistem të ngjashëm. Trajtimi i ekonomisë hije është mjaft i komplikuar sikurse vërehet dhe në vështrimin teorik në [2] në shumicën e tentativave një numër supozimesh mbi thjeshtëzueset e rrisin dukshëm gabimin në njohjen e saj pasi në thelb EI dhe ekonomia e zezë është subjekt analize me matje të tërthorta. Ky aspekt përforcon rëndësinë e njohjes së kontureve dhe trendit të përgjithshëm për secilin variabël në sistem.

Elemente të hapësirës së variablave të modelimit dhe variablat në modelet momentare dhe në MIMIC (DYMIMIC, EMIMIC)

Njohja e hapësirës së variablave faktorë merr rëndësi të veçantë në zbatimin konkret pasi nga një vënd në tjetrin ka ndryshime esenciale. Për këtë shkak renditja sipas taksonomise krijon lehtësira kuptimore në lexim dhe modelim. Një taksonimi e pranuar është si vijon

1. Aktivitete legale të karakterit penal (Ekonomia e Zezë)
 - Me transfertë monetare
 - *Prodhimi dhe tregtimi i drogërave*

- *Prodhimi dhe tregtimi i armëve dhe sendeve të tjera të ndaluara*
 - *Tregtimi i objekteve të tjera; falsifikimi dhe shitja e mallrave*
- Pa transfertë Monetare
 - *Shkëmbimi i mallrave të vjedhur/grabitur*
 - *Prodhimi i paligjshëm për përdorim vetiak si droga, armë, mjete të tjera*
 - *Mikse*
 - *Korrupsioni*
 - *Ushtrimi i ndikimeve të paligjshme*
- 2. Aktivitete legale të karakterit administrativ (Ekonomia Informale Klasike)
 - Me transfertë monetare
 - *Evazion Fiskal*
 - *Të ardhura të padeklaruara*
 - *Paga të padeklaruara*
 - *Vetpunësimi*
 - *Përfitimet të padeklaruara nga asetet/ shërbimet etj*
 - *Evitimi i taksave (shmangie detyrimesh)*
 - *Fshehje të fuqisë punëtore*
 - *Përfitimet dytësore*
 - Pa transfertë monetare
 - *Evazion Fiskal*
 - *Shkëmbimi i të mirave dhe shërbimeve legale*
 - *Evitimi i taksave (shmangie detyrimesh)*
 - *Punët vetiake*
 - *Punët në komunitet, puna vulnetare*
 - *Ndihmat. Shërbimet për të tretët pa pagesë*

Ndërsa vlera totale e EI nuk njihet pjesë te saja dhe sidomos ato te kategoria (2) me lart qe lidhen me transfertat monetare lene gjurme. Përgjithësisht modelet janë prirur drejt njehsimeve për këtë rast , në përputhje me specifikat e sisteme konkrete [2], [8]. Më vonë **modelet kanë përfshirë aktivitete me bazë marketin ose jo që prodhojnë të mira apo realizojnë transfertat, por që u shmangen detyrimeve dhe rregullimeve të tjera ligjore** [10]. Në këtë rast njehsimet bëhen më të ndërlikuara.

Teknikat e posaçme janë propozuar në secilin rast sikurse janë ato me bazë simulimin me bazë agentët [8]; me modelime bazuar në ekuacionet strukturore [10], [49]. Jo rrallë kuptimet e kufizuara janë marrë si defincione të plota dhe një sqarim i detajuar mongrafik në referencën [49] ka identifikuar pikërisht këto aspekte. Kështu, ekonomia hije apo informale e bazuar nga shmangiet e tipit 2 këtu lart karakterizohen nga këto vijësjetelje :

- a. *Evitimi i taksave, ose disa prej tyre, si p.sh.:*
 - *Taksa mbi të ardhurat*
 - *Taksa mbi vlerën e shtuar*
- b. *Evitimi pagesës së kontributeve*
 - *Sigurimet shëndetësore*
 - *Sigurimet për pensionin*
- c. *Evitimi i standarteve të imponuara si:*
 - *Paga minimale*
 - *Orët maksimale të punës*
 - *Sigurimet teknike*
- d. *Evitimi i detyrimeve administrative të tjera*

që përbëjnë edhe setin e faktorëve në modelet minimaliste.

Metodat monetare sikurse thamë pranojnë se treguesi kryesor i EI është paraja apo agregatet e saj. Këto metoda i kanë të përcaktuara faktorët kryesorë si dhe indikatorët. Megjithatë është e

rëndësishme të nënvizohet se aplikimet në vënde të ndryshme raportojnë sete krejt të ndryshme variablash ndikues si p.sh. në [33] apo dhe në trajtimet e zgjeruara [2]. Në punimet e mëparshme për rastin e RMV në periudhën deri në 2004, janë raportuar njehsime standarte të modeleve d.m.th. pa ndryshuar terma. Për shkaqet e trajtuara më lart ne do kualifikojmë termat (variablat) pas analizës dhe pas rezulttatit faktik.

Matematikisht për të gjitha këto raste, është realizuar studimi statistikor dhe njohja e dinamikës, sjelljet e posaçme në rastin e indikatorëve monetare. Ndërsa për të tjeret është ndjekur rruga e tatimeve për stacionaritet, rrënjë njësi etj.

Kategorizimi i variablove shkaqe dhe specifkat

Nga vështrimi i databazës, ky tip variablash kanë pësuar ndryshime të herë pas hershme ne terma dhe cilesime sipas akteve ligjore dhe nën ligjore të RMV. Ashtu sikurse në modelimin standart këto variabla mbeten gjithmonë kandidatë. Në punimin tone i kushtojmë rëndësi parësore se cili factor ka efektin dominant. Për pasojë ne do i konsiderojmë **variablat në kategori të specifikuar taksa, interesa, indekse socioekonomike**.

1. **Taksa, detyrime, kontribute, tarifa të aplikuara**, që ushtrojnë presion mbi ekonominë formale duke favorizuar evazionin fiskal, shmangie në detyrimeve. Mënyra e përfshirjes formale të tyre është trajtuar në çdo aplikim që si rregull kanë pikënisje interpretimet Tanzi [50], Cagan dhe rishikimin Shneider [72]. Këto variabla shfaqen si fraksione (përqindje) dhe për pasojë janë të limituara në shtrirje (të cingura në dy digite), por në shumë raste ato mund të zëvendësohen me raportin e taksave të mbledhura mbi ekonominë formale (GDP, pPP, GDI, GNI etj). Në teori rritja e taksave rrit ekonominë informale. Në praktike sjellja është e komplikuar.
2. **Interesat** interesat e mesatarizuara, që në një farë mase kryjnë rolin rregullator d.m.th. mund të ndikojnë që një pjesë e parave të marrë rrugën formale (depozita në banka), dhe si të tilla ndikojnë negativisht në rastin e kreditimit dhe pozitivisht në rastin e debisë, në qarkullimin e parasë jashtë sistemit banker që përafrohet me ndikimin e EI. Edhe këto kanë problemin e shënimit në digite por praktika në RMV pas 2010 njih vlerësimin faktik të interesave nëpërmjet mekanizave moderne të indeksimit duke i bërë këto seri më shumë të vazhdueshme.
3. **Inflacioni dhe** indekset e çmimit të konsumatorit, kanë ndikim favorizues teorike pasi shprehin koston e parasë
4. **Makroparametra si** niveli i pagave, gjendja ekonomike (GNI_capita, GDP_Capita) etj. Në disa referenca dhe rishikime janë shtuar edhe variabla të tjere si papunësia, etj
5. Një specifike per disa nga këto variabla është kufizueshmëria kohore, përgjithësisht janë vjetore si interesat depozitave, niveli i taksave, etj.

Variablat përgjigje në sistem dhe indikatorët e ekonomisë informale.

Modelimi standart i ka te fiksuara dhe ketu nuk bëhet fjalë për risi, janë koncepte fundamentale.

1. **Paraja në qarkullim**, paraja jashtë depozitave. Këto variabla janë të shënuara rregullisht dhe gjenden në seri mujore, 3-mujore pas 2010 dhe serri vjetore para 2010. **Parate në përgjithësi**, narrow Money, Broad Money etj
2. **Deflatori i GDP**, gjithashtu është një tregues me rëndësi pasi shfrytezohe si unifikues i te dhenave por një lidhje direkte ne model nuk është propozuar.

Pavarësisht sjelljes së indikatorëve bazë në nuk përjashtojmë mundësinë e përfshirjes së **Indekseve të tjerë** specifik si identifikues për rastin tonë konkret. Variabli përgjigje kryesor – *Paraja ne Qarkullim*-ka problemin e ndikimit të remitancave në monedhë të huaj dhe balancës

së tyre (inflow/outflow), pasi **paraja e huaj qoftë Euro qoftë USD mund të shërbejnë lehtësisht si mjet pagese pa u konvertuar**. Kjo ndikon fort në vlerësimin e parasë faktike në qarkullim dhe ne presim paraprakisht që modelet të ndjejnë këtë peshë. Për këtë shkak edhe roli i secilit agregat (M_0 , M_1 , M_2 , etj) është kompleks. Kështu ne kemi konsideruar si paranë e ngushte M_2 dhe paranë e ngushte plus remitançast M_{22} në rolin e normalizuesit të faktorit C/M sipas modelit bazë Tanzi. Si rregull variablat e tipit interes dhe inflacion shfaqen direkt në relacionet lineare ndërsa të tjerat janë në trajta logaritimike.

Përgjithësisht në këte pjesë ne nuk kemi konsideruar variabla **dummy** pasi efekti i tyre është marrë në konsideratë duke punuar jashtë zonave ekstreme, brenda cikleve ekonomike të analizuar paraprakisht, pasi aplikimi i tyre është subjektiv, ose paragjykses. Ndërkohë kjo ka krijuar lehtësinë e punës me variabla numerike që nuk kanë nevojë për transformime që në anën tjetër nuk vijnë pa ndikime në saktësinë e njehsimeve finale.

Modelet me ekuacione të strukturuar të njoftuara më lart pohojnë se mes shkaqeve dhe indikatorëve të EI ka një lidhje lineare por me ndërmjetësinë e kësaj të fundit që është njekohësisht edhe Variabli i Fshehur. Në këtë rast përcaktimi definitiv i mbetet stadi njehësues të kapitullit 4 dhe këtu mund të flasim për skema kandidate pasi duhet të verifikohet struktura në sistem edhe pse parimisht variablat shkaqe ose prediktore mbeten po ato të paragrafeve të mësipërme. Njehsimi është i varur nga skema e zgjedhur dhe duhet analizuar jo vetëm seria e të dhënave por edhe devijimet e ndërmjetme përgjatë implementimit të algoritmeve. Nëse variablat kanë lidhje të fortë shkasore, atëherë gabimin e përcaktimit të modelit apo mbetjet janë shumë pranë gaussianeve dhe në këtë mënyrë gabimi i metodës është pranë atij teorik. Në të kundërt gabimi do jetë më i madh. Për këtë shkak analiza e variablave, e setit të tyre dhe e dinamikës janë më të ndërlikuara në këte rast. Si rregull softet e dedikuara i kryjnë në mënyrë latente të gjitha këto duke prezumuar se jemi në kushtet e përcaktuara në teori, gjë që duhet testuar. Në fakt ne konstatojmë se seritë tona janë larg plotësisht të kushteve të kërkuara teorikisht apo të pranuar nga modeli për madhësinë, në stacionaritetin, variancën e tyre, fluktuacionet, etj. Nisur nga vërejtjet substanciale për këto zbatime në referencën [68] dhe vërejtjet ekonometrike në [49] etj, ne kemi trajtuar këtë pjesë pasi është nxjerrë një set konkluzionesh me njehsimet indirekte me teknikat monetare në kapitullin 3.

Konturi dhe permasa e ekonomisë së paregjstruar nëpërmjet matjeve direkte.


Në këtë paragraf ne konsiderojmë njehsimin e EH dhe jo thjeshtë EI në kuptimin e ngushte. Natyrisht që e para është vështirë të modelohet ndërsa e dyta më lehtë. Kështu p.sh. ne nuk mund të lidhim regresionin e taksave me EI kriminale, por e lidhim menjëherë me EI me origjinë evazionin. Për një studim të plotë të dukurisë dhe ndërtimin e modeleve funksionale, kemi filluar me **përcaktimin e piketave, kontureve, që do të na «udhezojnë» vlerësimin dhe modelet**. Kujtojmë se madhësia e kërkuar është e pamatshme dhe në këtë rast njohja e kontureve, d.m.th. fashës ku pritët të luhatet, është mjaft e rëndësishme në modelim: modelet që japin vlera totalisht ndryshe nga vlerësimi kornizë do shihen me shumë kujdes. Një tjetër pikë kornize është identifikimi i ekonomisë në studim në rangun e ekonomive të tjera. Duke identifikuar EH në vëndet me parametra ekonomike të ngjashme me RMV kemi krijuar një pikë orientimi për vlerën e pritit në rastin tonë. Në vijim të këtij paragrafi kemi trajtuar një aspekt matës të **drejtëpërdrejte** bazuar në discrepancat. Kjo teknikë matëse bazohet në presumimin se EI shkakton mosrakordim të vlerave të GDP (GNP) llogaritur sipas të ardhurave, apo prodhimit dhe shpenzimeve [40], [2]. Në rastin e RMV ka patur njehsime dhe raportime në vijimësi si në referencat [49], [42], [34] etj. Në rastin tone ky njehsim ka qëllim mbështetës dhe referues për modelet e mëpastajme. Në këtë rast janë shfrytëzuar të dhëna me afat të gjatë

kohor (3-mujore dhe njëvjeçare) për të mundësuar krahasimin adekuat me rezultate të modeleve të tjera për të cilat do të shfrytëzojnë vetëm këto tipe serish sikurse do diskutojmë posaçërisht. Për të sjellë më në pah evolucionin e ekonomisë informale po i referohemi njehsimeve të bëra në referencën [44] publikuar më 2017. Në këtë rast duke ju referuar [20] dhe [74] rezulton se shpërndarja e vlerave të EI për periudhën [1999-2007] nuk është stabilë siç shihet nga parametri i stabilitetit $q > 1$ në Figurën 2-3. Evolucioni është parë i realizuar, i faktuar në periudhën e mëvonshme [2008-2014]. Në Figurën 2.-4 shihet se sistemi është ndare në dy gjëndje, njëra me një shtrirje thujse gausiane ($q \sim 1.1$) me një qëndërzim tek 35%. Kjo zonë i përket vëndeve me të ardhura të mesme dhe me demokraci ekonomike të mirë. Vërejmë se në rankimin botëror RMV bie pikerisht në këtë diapazon. Zona tjetër i përket një numri vendesh me EI shumë të ulët, rreth 18%.


Një pjesë tjetër i përket bishtit të shpërndarjes që devijon nga gausiani dhe shfaqet si një turbullim dhe oshilime të mëdha për vlera mbi 50%. Prirja ekonomisë informale për t'u zvogëluar shfaqet në shumicën e ekonomive sipas [44] dhe kjo lidhet me:

- shkrimin e rregullimeve,*
- globalizimin*
- forcimin regjimit të ligjit*
- rritjen e peshës së politikave sociale.*

Vërejmë se secila nga pikat a=c është cekur specifikisht në periudhën 2004-2-16 dhe sidomos në 2010-2016 ka patur intensitet në nën rastet a dhe d, për pasojë ka shumë rëndësi studimi në këtë periudhë. Prirja për të shfaqur dy regjime që duket në Figurën 2-3 përkatësisht me vlera mesatare rreth 35% dhe 45% respektivisht, në kurbën e Figurë 1-3 ruhet akoma, duke pësuar transformimin drejt zonave me informalitet më të ulët.



1999-2007.




2007-2014.

Figura 2 Proporcioni EH/ GDP

Ndërkohë, prirja për të shfaqur dy regjime që duket në Figurën 1. 2 përkatësisht me vlera mesatare rreth 35% dhe 45% respektivisht, në kurbën në Figurën 2-3 ruhet akoma, duke pësuar transformimin drejt zonave me informalitet më të ulët. Pas 2007 një numër procesesh në ekonominë botërore kanë ulur mesataren e informalizmit dhe kanë qartësuar grupet e ekonomive informale. Duke analizuar këto shpërndarje dhe nëse zhvillimet i marrim në proces, grupi i madh është shumë me dinamik dhe gjëndja është e paqëndrueshme, sikurse duket nga parametri i stabilitetit në kufijtë torike të përcaktimit. Duke iu referuar komenteve në [20] lidhur stacionaritetit dhe vlerave të q -në shpërndarjen q -gaussian, fakti se grupi i parë kanë shpërndarje me $q > 5/3$ tregon se kjo seri është me variancë të papërcaktuar që do të thotë se ndryshimet eventuale janë në proces dhe ia ndryshojnë plotësisht parametrat shpërndarjes. Në këtë mënyrë, qëndra 35% nuk mund të jetë një atraktor në gjuhën e dinamikës jolineare. Ndërsa nga ana tjetër qëndra e grupimit të dyte $\sim 18\%$ i përket një q -gausiani thujse stabilë me $q \sim 1.1$ dhe si pasojë

Figura 3. EI në vendet e zhvilluara 2003-2016



funksionin si pikë kondensimi në kuptimin që ikje të tjera nga grupi i dytë pritet të ndodhin nëse proceset që kanë kontribuar në këtë zhvillim mbeten të pandryshuara. Në referencën [48] janë paraqitur rezultatet e përlogaritjes së EI në vendet e zhvilluara dhe Komunitetin European. Rezulton se sjellja është e ngjashme veçse sistemi rezulton më i stabilizuar. Në Figurën 1-6 kemi njuhësuar këto shpërndarje dhe analizuar në sensin e stabiliteti. Konkludojmë se

- *Prirja ulëse e ekonomisë informale është karakteristikë e përgjithshme globale*
- *Ngase RMV është një ekonomi e grupit të parë, gjetjet me rënie të lehtë të informaliteti janë të logjikshme sa kohë rregullat ekonomike janë të ngjashme.*
- *Nje kornize paraprake per EH ne RMV është ~35%*

Nga dy paragrafet më lart kemi kornizuar nivelin e EH në RMV. Në vijim kemi realizuar njuhsimet tona hap pas hapi duke u nisur nga rasti më i thjeshtë. Në fakt në rast të prurjeve joformale, shpenzimet agregate ose ndryshe GDP llogaritet sipas ekuacionit

$$GDP \equiv AE = C + I + G + NX.$$

ku C është konsumi nga popullisa (household çon smption), I janë investimet, G janë shpenzimet qeveritare dhe $NX = X - I$ janë exportet neto (eksport-import) dhe GNP

$$GNP = GDP + NR$$

ku NR janë të ardhurat nga jashtë, llogaritjet janë të komplikuar nga se në të ardhurat GNP nuk janë përfshirë *Informal_Cash* një term i rëndësishëm në EI.

Si rregull llogaritja bëhet në nivel viti fiskal. Në këtë mënyrë, nëse është i mundur një vlerësim i pavarur i shpenzimeve në llogaritë kombëtare, diferenca mes këtyre shpenzimeve dhe të ardhurave të regjistruara është një indikator i ekonomisë hije sipas përcaktimit nga [shneider xs].

$$Ekonomia_{Hije} = [Shpenzime_{Totale}] - [Teardhura_{Totale}]$$

Shpenzimet përcaktohen si levizjet në cash ose cash-ekuivalent për të mira dhe shërbime, detyrime të përcaktuar në kontrata shit-blerjesh. Ato mund të jenë shpenzime nga të ardhurat dhe shpenzime nga kapitali. Secili zë më vete ka një kuptim plotësisht të detajuar [23]. Shpenzimet e kapitalit (CAPEX) maten me sasi të shpenzuara për blerje apo rinovim kapitalësh dhe asetesh me qëllim rritjen e kapaciteteve prodhuese, eficientë e kompanisë ose performancën e saj në treg. Shpenzimet e llojit *income expenditure* përfshijnë blerjet dhe shërbimet. Për këtë shkak, vlerësimi total në një kohë të caktuar p.sh. vit fiskal, etj., sjell gabime (në kuptimin error) d.m.th. pasaktësi statistikore të pashmangshme që ndikojnë në llogaritjet finale. Ndodh që statisticienët të orientuar nga nevoja e rritjes së saktësisë përformojnë rrillogaritje me synim ulje në pasaktësitë statistikore, proces gjatë të cilit sipas analizës [2], [49] një pjesë e indikatorëve të EI zhduken.

Nga ana tjetër [2], [49] etj, pohon se nëse gjithë ky proces bëhet pa gabime, atëherë diferenca e mësipërme tregon madhësinë e EH. Në fakt situatë të tillë në praktikë nuk ka. Diferenca 1.3.2 përfshin edhe gabimet e matjeve

$$Ekonomia_{Hije} + Gabimi_{Total} = Shpenzime_{Total} - Ardhura_{Total}$$

Nëse me një metodë është e mundur matja e gabimit total në vlerësimin e parametrave të anës së djathtë po shënojmë me G_A dhe G_S atëherë

$$Ekonomia_{HiJe} = [Shpenzime_{Total} - Ardhura_{Total}] + [G_A + G_S]$$

Evidence fillestare e natyrës së korrelacioneve mes shkaqeve dhe indikatorëve në rastin e variablave socioekonomike.

Në këtë vështrim paraprak nisur vetëm nga matjet, kemi tentuar testimin e mundësisë së lidhjeve jo-shkaksore dhe konturimin e setit të variablave shkaqe dhe indikatorë. Në këtë fazë nuk kemi prezumuar lidhje nëse nuk janë të verifikuara, por kemi insituar në mundësinë e kuptimit të tyre qoftë edhe me vlerësime fillestare gjë do tu shërbente vrojtueseve cilësore apo të shpejtë. Kështu, nëse flasim për ekonominë e pajegjistruar në tërësi EH është e vështirë të identifikojmë shkaqe direkte pasi pjesë të saj ndryshojnë thelbësisht njëra me tjetrën në kuptim ekonometrik. Psh., shpejtësia e qarkullimit të parasë nuk është e njëjtë si në EI dhe në atë të zezë. Rezulton se në një njehsimin tonin paraprak ky ndryshim është rreth 10% [16] d.m.th. shumë ndikues. Në analizën e variablave dhe ndarjen në faktorë dhe indikatorë jemi kujdesur të jemi më analitike. Kjo për shkak se bazuar vetëm në disa gjetje statistikore pa mbështetje ekonomtrike mund të konkludohet gabim pasi variablat mund të jenë njekohësisht shkaqe dhe pasoja dhe po ashtu konkludimet ekonometrike pa mbështetje statistikore matematike janë subjektive dhe joshprehese. Një rast tipik i komplikimit është korrupsioni që është edhe shkak edhe pasojë dmthe një variabël tipik miks.

Korrupsioni si variabël i përzjer dhe rregullimet ligjore, krizat dhe variablat dummy

Mënyra e indikimit të sjelljeve korruptive janë trajtuar gjerësisht në literaturë dhe ka një numër konfirmimesh se ai ndikon në rritjen e peshës së informalitetit. Njehsimet në [15], [34] kanë mbështetur formulimet e përgjithshme në [2], [49] etj, por marrëdhënia nuk është e thjeshtë. Korrupsioni në vetëvetë është një variabël i indeksuar mirë dhe i përshtatshëm për llogaritje. Në shqyrtimin e databazës ne kemi vërejtur se kjo madhësi është trajtuar në mënyrë konsistente dhe me ecuri të njëjtë pavarësisht metodikave. Sidoqoftë fakti se është një variabël kategorik me matje subjektive krijon vështirësi në përfshirjen në modelime, ndërsa në rastin e evidencës së korrelacioneve kjo gjë nuk ndikon. Në një hap te dytë kemi përfshirë këtë madhësi në modelet përkatëse strukturur SEM. Pas njehsimit fillestar I te EH me teknikën thjeshtë të GNP/GDP është e mundur të verifikojmë pohimin lidhur korrelimit dhe trendeve të dy madhësive. Me të dhënat e disponuara dhe me një përafrim empirik mbështës linear provë

$$EI = a + b * Indeks_korrupsioni$$

përkatësisht pranohet me nivel shumë të mirë besimi hipoteza:

H₀="Korrupsioni dhe ekonomia Informale janë të korreluara pozitivisht"

Por, natyrisht nuk mund të vijohet më tej lidhur shakësisë. Korrupsioni është një variabël shumë kompleks. Ai prodhon dhe emeton informalitetin biles "informalizon" nga vetë natyra edhe regjistrimin e informalitetit duke i kthyer matjet për të delikate dhe objekte të vështire për tu inkorporuar në model. Megjithatë, duke arsyetuar në modelime më të detajuara se MIMIC, por më delikate për t'u përgjithësuar, na ka rezultuar se ecuria e ekonomisë informale është thujse e njëjtë me korrupsionin. Po kështu në një modelim MIMIC $n - 1 - [Korrupsion, GDP]$ prove, ku korrupsioni është edhe shkak edhe pasojë (d.m.th. në model shfaqet edhe tek variablat indikatorë edhe tek shkaqet) na rezultoi se përafërsisht EI e normalizuar sipas GDP dhe indeksi i korrupsionit janë proporcionale, me një shumëzues 0.93 plus një term perturbues. Pozicioni i këtij faktori është adresuar në një numër rastesh si në Rumani [13], Egjipt [32] e shumë raste të tjera apo edhe teorikisht në [2] dhe [32], etj. Por ajo çfarë veçohet për trajtimin e këtij

paragrafi është se ky parametër nëse është i rëndësishëm pengon teknikat direkte statistikore bazuar në auditimet dhe anketimet që janë një test i forte e i drejtëpërdrejtë për modelet në vetëvete. Në rastin e parë auditimet nuk japin vlerën e vërtetë të auditi fiskal dhe evazonit duke shteruar mundësinë e matjes direkte me këtë metodë. Në rastin e dytë, në prani të korrupsionit, anketat bëhen të pavlefshme pasi individët pjesë e strukturave informale janë dhe vetë pjesë e strukturave formale gjithashtu dhe për pasojë nuk ka logjikë të vetëzbulohen. Korrupsioni është i shënueshëm edhe në RMV. Në tabelën në Figurën më poshtë shihet se korrupsioni pas një uljeje të ndjeshme, në mesvitet 2012-2014 është ngjitur në nivele alarmante. Vërejmë se mjaft sociologë dhe politologë e vlerësojnë kritike pikën mbi 45% për indeksimin e korrupsionit(1:100) Përkatësisht me 2016 indeksi është 37 pikë d.m.th. ***nuk flitet për një shoqëri me prani korrupsioni por një shoqëri të korruptuar.*** Ndërsa nga njëra anë kjo do favorizonte EI dhe do prisnim se në kushtet ceteris paribus, për shkak të korrupsionit informaliteti në RMV është rritur pas 2012, paralelisht më të edhe mundësia e identifikimit të informalitetit sidomos me metoda direkte auditi apo, anketat. Korrelacione pozitive të tilla janë raportuar edhe në vrojtime me metoda të tjera sikurse raportohet në [32]. Për më tepër, korrelacioni i fortë dhe pozitiv i korrupsionit me EI është matur edhe numerikisht në rastin Brazilit sipas referencës [33] dhe raste të tjera të ngjashme që nuk po i listojmë. Duke testuar statistikisht korrelimin, ose me saktë varesinë lineare të EH nga korrupsioni i matur me indeks të shiftuar sipas z-transformit 2.3 na rezulton se korrelimi është i lartë dhe formalisht ka një lidhje të dyanshme:

$$Ekonomia_{informale} = 0.001 + 0.945 * Indeks_Korupsion$$

me $p_{value} = 0,044$, por ne nuk e supozojmë në këtë pikë lidhjeje shkaksore pasi nuk është **evidentuar natyra e EI**. Kjo është detyrë e paragrafeve vijues pasi ne në këtë punim nuk kemi pranuar rrjedhoja matematike pa mbështje faktike dhe në disa drejtime. Megjithatë në këtë pikë edhe në kushtet e kufizimeve të vlerësimit të EH me metoden GDP, rezulton se ***indeksi i korrupsionit dhe EI ne RMV kanë të njëjten ecuri dhe përputhja e tyre është mjaft e shënueshme në intervalin [2006-2016]***. Matematikisht ekuacioni linearizues 2. 4. 2 provohet në këtë interval.

Analiza të ngjajshme me më lart mund të bëhen efektive edhe për tregues të tjerë duke mundësuar profilizimin e modeleve vijuese bazuar në të dhëna dhe fakte të testuara shkallë-shkallë dhe jo implantim nga rutinat teorike. Kështu problemet me rregullimet ligjore kanë një ndikim të shumfishtë gjithashtu dhe i komplikojnë llogaritjet. Së pari evoluimi i legjislacionit fiskal krijon terma dhe reaksione që mund të mos jenë të lidhura me EI, por me turbullinë e çastit, ose krijojnë shanse për një ekranizim të indikatorëve të saj. Legjislacioni fiskal në RMV ka ndërruar disa herë deri me 2010 dhe përkatsisht:

- *Ligji për marrëdhëniet e punës*
- *Ligji për të drejtën e autorit dhe copyright-in*
- *Ligji për tregtinë*
- *Ligji për doganat*
- *Ligji për Regjistrin e pagesave cash*
- *Ligji për parandalimin e pastrimit të parave*
- *Ligji për tatimin e të adhurave personale*
- *Ligji për inspektoriatin shtetëror tregtar*
- *Ligji për policinë financiare*

Ne lidhje me skemën e kategorizimit për disa variabla ne kemi propozuar shkallen likert

Pikëzimin e kemi marrë nga raportet zyrtare, megjithatë nuk kemi një seri kohore për ta përfshirë në ekuacione. Në raportin e FMN më 2016, është vërejtur **se policimi fiskal ka qënë i dobët në RMV** dhe rekomandohen disa rregullime. Po kështu misioni i FMN ka gjetur se **policimi financiar ka qënë i mirë dhe sistemi banker, gjithashtu**. Vlerësimi lidhur **veprimin të ligjit** dhe efikasitetit të qeverise është në nivelin **“dobët”**.

Tabela 1. Disa variabla kategorikë

Variabli	Vlera	Vlera Likert	Koha
Qeverisja fiskale	Dobët	2	Deri 2014, çast i pafiksuar
Policimi Financiar	Mirë	4	Deri 2014, çast i pafiksuar
Sistemi Bankar	Mirë	4	Deri 2014, çast i pafiksuar
Veprimi i Ligjit	Dobët	2	Deri 2014, çast i pafiksuar

Ndërkohë në të gjitha përlllogaritjet e bëra për EI në RMV pas 2014 ka një rënie. Ky fakt rikthen çështjen e modeleve që përfshijnë këto parametere kategorik si variabël. Edhe nëse si faktor mund të gjykohet si i përshtatshëm nga mjaft autorë për modelin MIMIC p.sh. në analizën paraprake duket se veprimi i tij nuk përputhet me ecurinë faktike, pasi një efikasitet ligjor i dobët duhet të forcont e informalitetin. Ne mund të përfshijmë sidoqoftë cilesisht këto variabla në interpretimin e Figurës 2. 6 dhe 2. 7. Së pari vërejmë se vlera e Tabelës 2.1 nuk duhet të jenë momentale por me një shtrirje deri në disa vite para datës së vlerësimit. Duke konstantuar se në vitet 2012-2014 ka filluar rënia e EH sipas njehsimit empirik, atëherë nga tabela 2.1 duhet pranuar se: **“Qeverisja fisikale dhe veprimi i ligjit kanë ndikim më të dobët në EH se sa Policimi Bankar dhe ai Financiar”**

Por, nuk e ngrejmë në testim si hipotezë pasi nuk kemi mundësinë e pranimit apo kundërshtimit statistikor. Pavarësisht kësaj, duke mbetur në nivelin e korrelimit, mund të themi se **“Policimi Bankar dhe ai Financiar janë të korreluar negativisht me ekonominë hije”**

Disa variabla faktorë në modelet elementare të EH për RMV

Ndërkohë që njehsimi dhe përpunimi do të trajtohen në dy kapitujt vijues, në vijim do të paraqesim dinamikën e disa faktorëve duke u ndalur në ato raste kur lidhjet e variablit me EI nuk përcaktohet dhe sistemi i llogaritjes do bëhet me teknikën e ekuacioneve të strukturara (SEM). Kështu, ndërsa në të gjitha referencat flitet për lidhjen Ekonomisë Hijë me Fuqinë Punëtore nuk jepet një njehsim direkt d.m.th. këto variabla do lidhen ose me ndërmjetsinë e një tjetri ose në praninë, influencën e variablave të tjere [2], [43], [48]. Njohja e ecurisë së tyre është hapi i parë në verifikimin e natyrës së lidhjes. Më tej, kjo analizë cilësore do të shërbejë për të evidentuar se ekonomia informale jep indikacion edhe pa u shfaqur si e matshme, dhe se këto indikacione mund të turbullohen në momente të ndryshme pikërisht për shkak të specifikës së vetë faktorëve.

Në teori *raporti i të ardhurave nga pagat me GDP* (GDI) është një parametër që ndikon në ekonominë informale. Si term ai përfshin edhe nivelin e punësimit d.m.th. tregon masën e përfitimeve të të punësuarve në raport me prodhimin e përgjithshëm. Në ecurinë e grafikut të Figurës 2.8, shihet se ky variabël ka një trend të butë dhe sillet thujt në këtë mënyrë në një interval të gjatë kohor (2010-2017) në vlerësimin 3 mujor. Në këtë trend nuk vërehet kulmim në zonën ku merr maksimum EH. Në këtë kuadër ne theksojmë **“Nuk konfirmojmë një lidhje lineare për të Ardhura nga Pagat Publike/GDP me EH”**

Ky pohim nuk mund të mohojë lidhjen qoftë edhe lineare me EI pasi EH e vlerësuar këtu përfshin të gjithë termit informal. Variabli tjetër, *raporti i Paga në Buxhetin Publik ndaj GDP* është më dinamik sikurse shihet në Figurë. Cilësisht Shpenzimet Buxhetore ndaj GDP janë një tregues me interes pasi tregojnë barrën e administratës mbi prodhimin. Në këtë vështrim paraprak, një variabël më shprehës do të shihet pikërisht raporti i shpenzimeve për paga ndaj Buxhetit dhe i Buxhetit ndaj GDP. Duke bërë njehsimet që janë materializuar në Figurat 2-

8,9 ne vërejmë se raporti Paga/GDP është i koreluar me gjetjet e mëparshme për ekonominë hiqe, dhe në këtë kuadër kemi një **“Korrelim pozitiv të të ardhurave totale nga pagat/GDP me EH”**

Në mënyrë të përgjithshme konstatohet se verifikohen korrelime që mund të indikojnë relacione varësie mes disa variablave lidhur me të Ardhurat nga Pagat (/GDP) dhe EH. Rezulton se

• **H₀: Variabli «Të ardhurat totale nga Pagat /GDP është i korreluar pozitivisht me EH»**

Të ardhurat kombëtar gjithashtu shfaqin një dinamikë oshiluese me trend rritës sipas 3 mujorëve Trendi ndërkohë nuk linearizohet mirë pasi përafrimi më i mirë është një polinom i rendit të 4 ndërsa ekstrapolimi i vlerës pasardhese duke u bazuar në ato paraardhëse nuk e mbështet një vijueshmëri të mirë me këtë funksion. Kjo do të thotë se përputhja është matematike dhe në thelb reflekton pak substancë procesesh, pak lidhje natyrale. Kujtojmë se seritë me përputhje polinomiale të rëndeve të larta dëshmojnë për multiplicitet procesesh dhe mosdominancë të njerit apo pak faktorëve dhe si rregull shërben vetëm për të treguar trendin lokal.

Remitancat

Migracioni dhe emigracioni janë dy aspekte mjaft të rëndësishme për vendet me ekonomi të vogël dhe në zhvillim. Ato pritet të ndikojnë edhe në dinamikën e informalitetit. Ata paraqesin një masë të madhe lëvizjeje të fuqisë punëtore duke modifikuar rëndësishëm nivelin real të punësimit dhe papunësisë, si dhe pasjellin hyrje të qenësishme të kapitalit likuid. Për këto arsye ato janë trajtuar në veçanti në mjaft kërkime dhe referenca sidomos në rastin e vendeve me ekonomi dhe situatë të ngjashme me RMV. Edhe pse në preferojmë ti vlerësojmë hap pas hapi analitikisht ndikimet, gjetjet e mëparshme dhe trajtimet teorike kanë një peshë mjaft të rëndësishme në konsideratat rreth këtij parametri. Ashtu sikurse në mjaft vende të tjera, *të ardhurat e migracionit si rregull anojnë nga transaksionet informale.*

Studimet në RMV kanë evidencuar se rreth 70% e parave të sjella nga jashtë prej emigracionit maqedonas janë manaxhuar në rrugë jo zyrtare [15]. Anketimet dhe matjet e tjera ekonometrike vlerësojnë se rreth 500,000 persona ose rreth 25% e popullatës ka migruar [56] kryesisht në shtetet e zhvilluara Evropiane dhe USA për arsye ekonomike. Ata nuk kanë patur sjellje rezidenciale në vendet e punës dhe të ardhurat e punës i kanë transferuar në vendin e origjinës duke krijuar një masë të konsiderueshme fluide financaiare. Me kohë, sjellja e migrantëve është afuar me rezidencialin duke ulur remitancat. Ecuritë e studjuar në [15] dhe [56], is dhe të dhënat e FMN, BB dhe NBM janë shfrytëzuar këtu për të shfaqur ecurinë e këtij variabli interesant. Vëzhgimet tregojnë se emigrantët nga RMV janë kryesisht të rinj d.m.th. të aftë për punë të mirfillta dhe qendrojnë jashtë për një kohë relativisht të gjatë, rreth 5-10 vite [56]. Njehsimet tregojnë se krahasuar me 1993, në vitin 2008 transfertat e përgjithshme private përfshirë remitancat janë rritur rreth 23 herë nga 58.8 milionë në 1,376 milionë dhe përbëjnë një vlerë treherë më të lartë të të gjithë FDI në të njëjtën periudhë [56]. Ecuria e transfertave është paraqitur po nga kjo referencë me burim NBRMV. Ky variabël ka një serë specifikash që duhen renditur dhe konsideruar. Së pari ai është jo fort i njohur me rigozitetin e termave të tjerë gjë e evidencuar në referencat e këtij paragrafi si dhe në metodikat bazë të vlerësimit. Gjithshtu, është shumë dinamik sikurse shihet nga niveli i rritjes në kohë. Ecuria ka karakter intervalor në kohë, d.m.th. në kohë të ndryshme sillet në mënyra të ndryshme.

Një problem tjetër nga vetë natyra është se remitancat kanë karakter të dyfishtë: ato janë aspekt jo formal në pozicion pasi si rregull nuk lëvrohen në rrugë bankare por nuk janë informale në mekanizëm pasi nuk shfaqen si zhvendosje e strukturuar nga objektivi fiskal. Futja e këtij

variabli në modelimet ndirekte monetare është e mundshme por sikurse thamë argumentet teorike dhe referencat e tjera dëshmojnë për një variabël me efekt të komplikuar.

Konstatohet se ky variabël kulmon në periudhën e kulmimit të EH dhe ka cilësisht të njëjtën ecuri. Megjithatë nuk mund ta fiksojmë as në nivelin e një pohimi pasi është një variabël me ndikim të komplikuar dhe jo përfshirë direkt në interpretimet teorike të referuara si [2], [49] etj. Gjithashtu variabli në fjalë paraqet edhe specifika të tjera që do trajtohen në pjesën e implementimit si variabël në modelin MIMIC që në vetëvete të krijon me shumë mundësi përfshirje për shkak të marrjes në konsideratë të shkaqeve të shumfishta që në supozimet bazë.

Proceset dinamike në disa variabla indikator dhe sjelljet kritike dhe evidencë e cikleve në Paranë në Qarkullim

Trajtimi i këtij Kapitulli synon edhe përgatitje të llogaritjeve më të detajuara në vijim. Sikurse pamë deri tani, variablat shkaqe kanë sjellje jo të lëmuar dhe në rastin Deficitit Buxhetor si një matës i performancës financiare qeverisëse vërehen kapërcime të theksuara. Megjithatë, këto variabla karakterizohen nga trende të lëmuara dhe në një farë mase monotone sikurse shihet nga grafet e paraqitura në Figurat 2. 8-12. Në metodat indirekte indikator kryesor për EH dhe EI është një funksion i agragateve të parasë si C , C/M_i PQ, pQ/M_i , etj . Në një farë shkalle mund të trajtohet cilësisht madhësia e interesit, përkatësisht EI, EH etj, me vet indikatorin, dhe nga kjo ngjashmëri mund të lexohen sjelljet e saj duke analizuar “pasqyrën”, indikatorin. Po është me vend që para se të vijohet me përpunimin analitik dhe kompjuterik, ecuria e madhësive të shqyrtohet nga jashtë dhe në një farë mënyrë të njihet sjellja e saj. Meqë në teknikat pasardhëse indikator bazë është funksioni i kërkesës për para [2], është me interes studimi paraprak i tij. Ky funksion me bazë strukture në formën e produktit (tipi Cob-Douglas) [49]

$$C = \prod_{(i,j,k)} (1 + X_i)^{\beta_i} X_j^{\alpha_j} \exp(-\gamma_k X_k)$$

ku si $\{X(i,j,k)\}$ janë variablat e pavarur dhe $\{\alpha_i, \beta_j, \gamma_k\}$ në modelet njehsuese si rregull shfaqet në trajtë logaritmike që ka monotoni të njëjtë me 3. 2. 1. Por ana a majtë në 3. 2. 1 në veçanti, ka ecuri të ngjashme me indekset, kurset e këmbimit, që karakterizohen nga procese shumë dinamike dhe si rregull sjellja e tyre është e vetorganizuar dhe me strukturë fraktale [76] që vështirson përdorimin nga njera anë, dhe dëshmon për kompleksitetin e madhësisë së kërkuar nga ana tjetër. Një sjellje e tillë përbën edhe kufizim për përdorimin e diferencave të logaritmit të 3. 2. 1 sikurse në modelet kryesore Tanzi, Cagan, Bajada etj. dhe në aplikimet e tyre si p.sh. në [2], [33], [34], [50]. Kjo gjë ka rëndësi për të kuptuar edhe potencialin e divergjencave të mëdha në ndonjë rast, por sidomos kufizueshmëri në linearizim dhe dinamikë të fshehur të EI apo EH. Kështu, ndërsa në rekordet vjetore të parasë apo parasë në qarkullim, agragateve të tjere dhe indekseve përkatës nuk shohim ndonjë veçori pasi numri i pikave është i ulët, në të vërtetë proceset dinamikë brenda tyre janë shumë komplekse dhe është mjaft me interes vështrimi në kohë më të shkurtra.

Sjellja e vetngjasisë dhe struktura fraktale e serive kohore të parasë në qarkullim

Dihet se paraja në qarkullim shprehur në madhësitë C dhe PQ karakterizohet nga një sjellje fraktale e pastër. Spektri multifraktal është një kurbë shumë e lëmuar që tregon se kjo seri është e dominuar nga vetngjasimi




Figura 4. Shyrtimi i strukturës vetngjasuese (fraktale dhe multifraktale për seritë kohore 3 mujore të parasë në qarkullim)

Exponenti multifraktal tregon se seria e diferencave për serinë e diferencave $h=1.3$ dhe për serinë e diferencave relativizuar në vlerë $(dx/x)h=1.7$ që u përkojnë procesve jostacionare dhe të pakufizuara [78]. Për rrjedhojë **operacionet e zakoshme të heqjes së jostacionaritetit dhe eliminimit të rrënjës njësi për seritë mujore të Parasë në Qarkullim/M nuk prodhojnë seri stacionare.**

Llogaritja e një madhësie ekonometrike të fshehtë si Eonomia Hije apo Informale, pranohet se ka gabim të konsiderueshëm, të paktën shumë më të madh se ajo e variablave me të cilën bëhet. Edhe nëse shmangiet janë Gausiane, ata mblidhen në kuadraturë d.m.th. rriten sipas fuqisë $1/2$, ndërsa në raste të tjara ata mblidhen thuajse linearisht. Për të ulur gabimet në llogaritje ne propozojmë të punojmë në zona (periudha kohore), intervale të studimit:

- **Larg sjelljeve kritike ku variabli indikator luhetet vrellshëm**
- **Larg skajeve një cikli ose duke përfshirë shumë cikle nëse ka të tilla**

Për këtë analizë të shkurtër ne kemi aplikuar disa funksione speciale të quajtura « logperiodike », të përdorur në shumë analiza të ecurive kritike lidhur me indekset, agragatet e parasë, etj analizuar në mënyrë të detajuar [77], [89] etj. Meqë këndvështrimi i këtij paragrafi është cilësor, nuk jemi ndalur në detaje për t'i paraqitur këtu duke i kalura në Kapitullin 3 dhe Aneks.

Rezultoni se në ecuritë mujore

- *seritë C/M dhe C/D karakterizohen nga ecuri kritike me piknisje në vitet 2003-2006 dhe me ndryshim regjimi (koha kritike) rreth 2018*
- *Diferencat korresponduese kanë karakter më të reduktuar në sjelljen kritike (logperiondiku me përputhje të dobët)*




Figura 5. Dinamika logperiodike e diferencave dhe logaritmeve për variablat C/M2

Gjithashtu vërehet se brenda tyre ka edhe oshilime 1.5-2 vjeçare, gjurmët e së cilave duken në Figurën 2.19. Për më tepër një analizë shtesë u është bërë ecurive që mund të shfaqin cikle

dhe lëkundje kohore që mund të na ndihmojnë në kapjen e regjimeve të caktura d.m.th. fiksimit e kohës së përshtatshme për të operuar me regresionin linear të një seti variablash.




Figura 6. Evidence e modeve vetjake dhe trendit kohor për serinë C/M2

Në kemi analizuar dhe këtë aspekt duke iu referuar shumë shkurtimisht një teknike që gjurmon ciklet në këto seri e quajtur: "Empirical Mode Decomposition" trajtuar gjerësisht në referencën [91]. Një lëvizje e tillë na diktohet nga fakti se edhe në praktikën e literaturës për ekonominë informale aplikohet futja e variablove dummy duke pranur një moment kritik kohë. Në thjeshtë këtë moment nuk e pranojmë por e hulumtojmë në seritë kryesore të parasë .

Vërejmë se në analizën EMD, modi i fundit apo i mbetjeve tregon ecurinë kohore të serisë në tërësi që sikurse duket nga grifiku i fundit i Figurës 3.18 tenton në një cikël të hapur që bie jashtë periudhës [2010, 2016] (Figura 2. 19), diku tek T~230 d.m.th. pas 3-4 vitësh. Pa kaluar në hollësira për teknikën analitike të modeleve vërejmë se variabli C/M shfaq këto specifika:

1. Ka strukturë fraktale me koeficient holder 1. 7 ndërsa diferencat 1. 27 që i përkon strukturave jostacionare dhe të pakufizuar sipas refenceës [78]
2. Është i ndërtuar nga 5 mode apo sinjale të qendëruara në zero që karakterizohen nga sjellje ciklike me periudhë nga disa muaj në disa vite; dy të fundit kanë ciklet 3 vjeçare dhe i fundit është në proces.

- a. Modi i parë që i korrespondon serisë reale të korigjuar nga trendi (detrend) shfaq një modulim me shtrirje 18-20 mujore që përbëjnë cilësi perturbuese që pengojnë stacionaritetin në çdo rend të diferencimit
- b. Modi i fundit që shpreh edhe trendin bazuar në [91] ka një shtrirje aftagjatë që dëshon se në një rend të caktuar tolerimi (sa amplituda e modit të parë) është e mundur të realizohet një seri stacionare, pavarësisht se në vetëvete seria nuk është e kufizuar sipas pikës 1 më sipër.




Figura 7 Oshilimet bazë (modi i parë) në raportin C/M2

Disa konkluzione për ndikimet e ekonomisë informale dhe rekomandimet

Rreth efektit total të ekonomisë informale në ekonomi ka debate. Përgjithësisht mendohet se ekonomia informale e dëmton ekonominë. Analiza e ofruar në detajimet [2],[49], etj rendit kostot e përgjithshme si

- *Përfitimet për bizneset e ligjshme:*
- *Konkurrencë të padrejtë për bizneset e ligjshme;*
- *Inkurajon “efektin zinxhir” pasi bizneset e ligjshme do të shmangen edhe ato, në mënyrë që të konkurrojnë me bizneset në hije*
- *Pengon rritjen pasi është e pamundur për të patur akses në kapital, siguruar mbështetje biznesi apo të reklamojë hapetazi.*

Po kështu renditen disfavoret për punëtorët e padeklaruar:

- *Mungesë aksesi në marrjen e kredisë dhe shërbimeve financiare, pjesërisht për shkak të historisë së kreditimit të limituar.*
- *S’ka aplikueshmëri të drejtave të punës (p. sh. Pagesë minimale, pagesë gjatë problemeve shëndetësore, të drejtat kur ka shkurtim të vendeve të punës).*
- *Barriera më të mëdha hyrjeje në tregun formal, për shkak të paaftësisë për të ofruar histori punësim*
- *Nuk mund të sjell të drejta për pension shtetëror, apo përfitime prej kontributeve të tjera, apo të ketë akses në skemat e tjera të pensioneve*
- *Mungesë aksesi për standardet e sigurisë dhe shëndetësisë, si dhe pamundësia për të negociuar dhe për të ngritur zërin kur shkelen të drejtat*

Nga ana tjetër ka edhe mbështetes pasi ekonomia informale është edhe mundesi për

- *Burim të ardhurash.*
- *Reduktim barrierash për t’u futur në punë pasi shumica e punës së padeklaruar lidhet me marrëdhëniet e ngushta shoqërore.*
- *Produkte dhe shërbime më të përballueshme për konsumatorët.*

Për klientët ka me shumë të këqija si mungesë e së drejtës ligjore nëse është bërë një punë e dobët, mos-mbulim siguracioni, mungesë garancie në lidhje me punën e kryer, si dhe mungesë garancie, që janë ndjekur rregullat e sigurisë dhe shëndetit.

Për qeveritë

- *Shkakton humbje të ardhurash për shtetin në kuadër të mospagimit të tatimit mbi të ardhurat personale, kontributeve të sigurimit dhe TVSH-së.*
- *Redukton të ardhurat në qarkullim për qeveritë që duan të promovojnë integrimin dhe lëvizshmëri në shoqërore.*

Ne lidhje me këto aspekte dha bazuar në njehsimet numerike të bëra më lart, në diskutimet rreth saktësisë së njehsimit në rastet konkrete dhe përfundimet në çdo kapitull, mund të përmbledhim rezultanten e gjetjeve të këtushme.

Disa aspeket të modelimit dhe llogaritjes

Punimi ka konkluduar edhe në disa verjetje dhe rekomandime të rëndësishme lidhur kërkimit sasiore dhe llogaritjeve ekonometrike. Në sistemet me shumë pak të dhëna dhe me ecuri dinamike, mundësia më oportune për kryerjen e regresioneve lineare është ulja e nivelit të signifikancës së pohimeve pasi jo vetem seritë nuk permbushin kushtet e kërkua nga kriteret e hipotezave dhe analiza sasiore, por garancitë e larta janë pakuptim dhe një vlerë me e natyrshme e vlerës së besimit mundëson njehsime të mira.

Në seritë e imta është me mjaft rëndësi të njihet dinamika dhe të evidencohen ciklet nëse ka të tilla si dhe të njihen sjelljet e jashme në sistem. Përkatësisht rekomandohet që linearizimi dhe regresioni të perdoren si seri dhe të dhëna

- *Larg skajeve të cikleve ose që përfshijnë shumë cikle*
- *Larg zonave me sjellje ekstreme, me ngjarje kritike*
- *Tu perkasin gjendjeve me shpërndarje stabile ose së paku me variancë të përcaktuar*

Po kështu vlerësohet si e dobishme që të evitohen sa më shumë transformimet e variblave sidomos në rastin e serive vjetore. Alternimi i metodave dhe modeleve ndihmon në evitimin e kokluzioneve të parakohshme.

Referencat

1. Andreas Buehn, Friedrich Schneider. Mimic models, cointegration and error correction: an application to the french shadow economy . IZA, DP no. 3306
2. Dean Fantazini, Modellinga nd fore çastng global crisis: initial findigs using heteroskedastic log për iodici model. Economics Bulletin, Volume 30, Issue 3, 2010. Pp1833-1841
3. Didier Sornethe, Ryan Wodard, , Wanfeng Yan, Wei-Xing Zhou. Clarifications to Questions and Criticisms on the Johansen-Ledot-Sornethe bubble Model. ETH-RC-11-004.
4. Ermelinda Meksi and Ermelinda Xhaja (2015) “On economic çon vergence of Albania and other Balkan countries with EU”, International Journal of Science, Inovation and New Technology, Vol. 1, no. 13
5. Fatmir Memaj, Some hypothesis regarding corrupetion at privatisation proces, Ekonomia dhe tranzicioni Special issue of Review. , 1998
6. Goldberger, Arthur S. (1964). E çon ometric Theory . N ew York: John Wiley & Sons. Pp. 238–243
7. Herve Abdi. Partial least squares regression and projection on latent strukture regression (PLS Regression). DOI: 10. 1002/wics. 051. □ 2010 John Wiley & Sons, Inc.
8. Hien Thu Pham, Shino taksayama. Revisiting the “Mising Middle”: Production and Corrupetion. Working Papër Series . N o. WP02/2015
9. Konstantino Tsallis. The Nonadditive Entropy Sq and Its Applications in Physics and Elsewhere: Some Remarks. Entropy 2011, 13, 1765-1804;
10. Liza Borlnad. aTheory of Non-Gaussian option Pricing: capeturing the smile and the skew (2004) www. Spiedl. org/data/ conference s/SPIEP
11. Lisa Borland. Fat Tails in Financial Markets: from option pricing to market panic Evninë & Associates, Inc. Brazil 2010.
12. Lorenzo Cappiello, Roberto A. De Santis. Explianing exchangeRate dynamicsthe unco veredequity return parity condition. Eurpean central bank. Working papër series. N o. 529 / Sepetember 2005.
13. Merita Boka. Informal economy in Albania. Academic journal of interdisciplinary studies Mcser publishing, Rome-Italy. Vol 2 no 8 october 2013
14. Rajev K. Goel, James W. Saunoris, Friedrich Schneider, Dri vers of the Undërground Economy around the Millienium: aLong Term Lok for the United states. IZA DP No. 10857
15. Ranimir Jovanovic. Kalman Filter Estimation of the Unrecorded Economy in Macedonia. N ational Bank of the Republic of Macedonia. Research Papër. 2015.

MENAXHIMI KORPORATIV I KOMPANIVE NË RMV DHE STRUKTURIMI I TYRE NË TREGUN NDËRKOMBËTAR (QASJA NË TREGJET E KAPITALIT)

PhD Candidate Elmedina SHUAJIBI¹

Abstract

The importance of economic policies to the access to the international market of companies from the Western Balkans through their good corporate governance, which in the broadest sense of the word, refers to the way in which the balance of interests is established in relation to certain companies exists between different persons and entities, through this in a more successful approach to the market and competition, is the basic problem that is addressed in this research.

The success of good corporate management of companies in RNM is shown through high competition and easier access to the national or international market. In this study, the success of good corporate governance is represented by the value indices of companies, the economic and financial evaluation of companies and the confidence index of companies in RNM, while through their success towards easier access at the national level. or the international market with the market index of export market penetration (Index of Export Market Penetration) and the Hirschman Herfindahl index (HH Hirschman Herfindahl index) of competitiveness.

At the same time, through the descriptive and final statistical operations applied, for the connection and influence of these indices, this study establishes a link between the good management of companies and their approach to the market. Through the correlation coefficient and linear regression, there is a relationship between the performance indicators of good corporate governance and the International indices of penetration and competition in the market, where it is distinguished according to the level of influence, trust and financial condition of the companies.

Key words: corporate governance; company value; confidence index; economic and financial indicators; Export market penetration index; Hirschman Herfindahl index of competition.

Hyrje në problemin e kërkimit

Termi qeverisje korporative, në kuptimin më të gjerë, i referohet mënyrës në të cilën vendoset ekuilibri i interesave që ekziston në lidhje me një shoqëri të caktuar ndërmjet personave dhe subjekteve të ndryshme. Përmes të cilit përcaktohen dhe arrihen qëllimet e kompanisë, vlerësohen rreziqet e saj dhe zgjidhen taktikat për të arritur performancë të mirë.

Bazuar në këtë parim, ky hulumtim përcakton lidhjen e qeverisjes së suksesshme korporative në kompanitë nw RMV sipas së cilës kompanitë menaxhuese shfaqin konkurrencë të lartë dhe qasjes më të lehtë në tregun kombëtar apo ndërkombëtar. Në këtë studim, ecuria e qeverisjes së mirë të korporatës përfaqësohet nga indekset e vlerës së kompanive, vlerësimi ekonomik dhe financiar i kompanive dhe indeksi i besimit të kompanive në RMV dhe performanca e tyre drejt qasjes më të lehtë në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar me Indeksën e Penetrimin të Tregut të Eksportit (Indeks i

¹ e.shuajibi@eust.edu.mk.

Penetrimit të Tregut të Eksportit) dhe Indeksi Hirschman Herfindahl (indeksi HH Hirschman Herfindahl) i konkurrueshmërisë.

Objekti i këtij hulumtimi është një studim i plotë, gjithëpërfshirës i qeverisjes së suksesshme korporative në kompanitë RMV, sipas të cilit kompanitë qeverisëse shfaqin konkurrencë të lartë dhe qasje më të lehtë në tregun kombëtar apo ndërkombëtar. Synimi kryesor i hulumtimit vijon: përcaktimi i suksesit të menaxhimit të mirë korporativ të kompanive në RMV sipas të cilit tregojnë konkurrencë të lartë dhe qasje më të lehtë në tregun kombëtar ose ndërkombëtar.

Paraqitja e rezultateve të kërkimit

Siç u tha më lart në pjesën teorike të këtij studimi, kompanitë me qeverisje të mirë korporative sigurojnë edhe qasje më të lehtë në tregjet e kapitalit.

Tabela 1. Treguesit ekonomikë për kompanitë në RMV dhe indekset për përqendrim dhe depërtim në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar

	Indeksi Hirschman Herfindahl (Kompanitë nw RMV)	Indeksi i Depërtimit të Tregut të Eksportit (Kompanitë nw RMV)	Indeksi i Penetrimit të Tregut të Eksportit (Tregu Ndërkombëtar)	Indeksi Hirschman Herfindahl (Tregu Ndërkombëtar)	Treguesi i vlerës së kompanive në RMV	Vlerësimi i gjendjes ekonomike të kompanive në RMV	Përqindja e gjendjes financiare të kompanive në RMV	Indeksi i besimit të kompanive në RMV
2012	.1089	3.5057	83.1924	.0389	112.31	24.1	19.1	14.6
2013	.1399	3.6128	81.5416	.0386	106.61	27.3	18.8	12.9
2014	.1596	3.7232	79.4353	.0403	109.46	27.2	18.1	14.0
2015	.1629	3.5495	76.0163	.0426	116.45	29.6	19.1	15.1
2016	.1752	3.7184	74.3470	.0425	121.08	31.8	21.1	16.7
2017	.1806	3.6593	63.3940	.0473	122.48	32.2	22.3	17.9
2018	.1889	3.7533	62.3340	.0479	134.69	32.4	24.4	18.6
2019	.1764	3.6593	63.3940	.0479	156.86	33.3	26.2	19.1
2020	.1056	3.2286	62.3340	.0386	109.75	28.5	17.3	17.1

Burimi: Trading Economics <https://tradingeconomics.com/macedonia/indicators>

Tabela 1 shfaq treguesit ekonomik për kompanitë në RMV (Treguesi i vlerës, Vlerësimi i Situatës Ekonomike, Vlerësimi i Situatës Financiare, Indeksi i Besimit) nga 2012-2020 dhe indekset e përqendrimit dhe depërtimit në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar (Indeksi Hirschman Herfindahl -HH Indeksi Hirschman Herfindahl, Indeksi i Penetrimit të Tregut të Eksportit) gjithashtu nga 2012-2020.


Një vend me tregwti (eksporte ose importe) që është i përqendruar në shumë pak tregje do të ketë një vlerë me indeks afër 1. Në mënyrë të ngjashme, një vend me një portofol tregtar të diversifikuar në mënyrë perfekte do të ketë një indeks afër zeros. Sa më afër të jetë tregu me një monopol, aq më i lartë është përqendrimi i tregut (dhe aq më i ulët konkurrenca e tij). Nëse, për shembull, do të kishte vetëm një firmë në një industri, ajo firmë do të kishte 100% pjesë të tregut dhe Indeksi Herfindahl-Hirschman (HHI) do të ishte i barabartë me 10,000, që tregon një monopol. Nëse do të kishte mijëra firma që konkurronin, secila do të kishte pothuajse 0% të tregut dhe HHI do të ishte afër zeros, duke treguar konkurrencë pothuajse të përsosur.

Grafiku 1 tregon dispersionin e indeksit të porosive të kompanive në RMV nga viti 2012-2020, nga ku shihet se nga viti 2017 indeksi ka një trend pozitiv në rritje, që sipas të gjitha raporteve të brendshme dhe të jashtme i referohet qeverisjes së mirë të


korporatës, por vitin e kaluar për shkak të krizës së koronës, ky indeks shënoi një rënie drastike.

Tabela 2. Statistikat përshkuese për treguesit ekonomikë për kompanitë në RMV dhe indekset për përqendrim dhe depërtim në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar

	Indeksi Hirschman Herfindahl (Kompanitë në RMV)	Indeksi i Depërtimit të Tregut të Eksportit (Kompanitë në RMV)	Indeksi Hirschman Herfindahl (Tregu Ndërkombëtar)	Indeksi i depërtimit të tregut të eksporteve (Ndërkombëtar)	Treguesi i vlerës së kompanive në RMV	Vlerësimi i gjendjes ekonomike të kompanive në RMV	Përqindja e situatës financiare të kompanive në RMV	Indeksi i besimit të kompanive në RMV
Madhesia e mesme	.1554	3.6012	.0427	71.7765	121.0633	29.600	20.711	16.222
Mediana	.1629	3.6593	.0425	74.3470	116.4100	29.600	19.100	16.700
Moda	.1056	3.6593	.0479	62.3340	106.61 ^a	24.1 ^a	19.1	12.9 ^a
Devijimi standard	.0306	.1617	.0040	8.8584	15.96228	3.0749	3.0354	2.1684
Minimum	.1056	3.2286	.0386	62.3340	106.61	24.1	17.3	12.9
Maximum	.1889	3.7533	.0479	83.1924	156.86	33.3	26.2	19.1




Grafiku 1. Indeksat e vlerës së qarkullimit të kompanive në RMV 2012-2020



Grafiku 2. Vlerësimi i gjendjes ekonomike të kompanive (vija blu) dhe vlerësimi i gjendjes financiare të kompanive (vija e gjelbër) në RSM 2012-2020

E njëjta situatë e tendencës statistikore paraqitet edhe në grafikun 2 më sipër për shpërndarjen e indeksit të vlerësimit ekonomik të shoqërive dhe vlerësimit financiar të shoqërive në RMV për periudhën 2012-2020.



Grafik 3. Indekset e besimit (konfidencës) të kompanive në RMV 2012-2020

Një nga treguesit më të rëndësishëm për suksesin e kompanive në treg është treguesi i besimit, në grafikunin numër 3, tregohet dispersioni i këtij treguesi, ku shihet se që nga viti 2014 kompanitë kanë shënuar rritje të besimit, por edhe në vitin e kaluar si rezultat i krizës së koronës, ashtu si shumica e kompanive dhe kompanive botërore në RSM shënojnë rënie të besimit.

Marrëdhënia ndërmjet treguesve të performancës dhe indekseve të tregut

Pas përpunimit të të dhënave me koeficientin e korrelacionit në Tabelën 3, siç pritej, vihet re një korrelacion i fortë pozitiv i treguesve të performancës së kompanive në RMV me Indeksën Ndërkombëtar Hirschman Herfindahl (indeksi HH Hirschman Herfindahl), përkatësisht $R = .841 .869 .917 .812$ me një koeficient të rëndësishëm $\text{sig} = .005.002.000.008$ ($p < 0.05$) me fjalë të tjera nëse indeksi Hirschman Herfindahl (indeksi HH Hirschman Herfindahl) - dhe HHI do të kishte qenë afër zeros, duke treguar një konkurrencë pothuajse perfekte në treg, që do të thotë se vlera, vlerësimi ekonomik dhe financiar, si dhe besimi i kompanive në RMV rritet ose do të rritet kur të ketë konkurrencë të fortë në tregun ndërkombëtar, ku cilësia e shërbimit si mjet. për një përparim në konkurrencë ndoshta vjen në konsideratë Por nga ana tjetër, nuk ka asnjë lidhje midis treguesve të performancës së kompanive në RMV dhe Indeksit Hirschman Herfindahl vendas-kombëtar (indeksi HH Hirschman Herfindahl), me fjalë të tjera, në tregun kombëtar konkurrueshmëria është më e ulët dhe disa kompani të mëdha ende mbajnë një lloj monopoli.

Gjithashtu, sipas tabelës 3, është paraqitur një lidhje negative ose korrelacion negativ ndërmjet vlerësimit të situatës ekonomike të shoqërive me Indeksën Ndërkombëtar të Penetrimit në Tregun e Eksportit (Indeksi i Penetrimit në Tregun e Eksportit) $R = -.766$ ($\text{sig} = .016$ $p < 0.05$) dhe nga ana tjetër, indeksi i besimit të kompanive gjithashtu ka një korrelacion negativ me Indeksën Ndërkombëtar të Depërtimit të Tregut të Eksportit (Index of Export Market Penetration) $R = -.914$ ($\text{sig} = .016$ $p < 0.05$).

Tabela 3. Lidhja (korrelacioni) ndërmjet treguesve ekonomikë për kompanitë në RSM dhe indekseve për përqendrim dhe depërtim në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar.

		Indeksi Hirschman Herfindahl (Kompanitë nw RMV)	Indeksi Depërtimit të Tregut Eksportit (Kompanitë nw RMV)	i Indeksi të Penetrimit të Tregut Eksportit (Tregu Ndërkombëtar)	i Indeksi të Hirschman të Herfindahl (Tregu Ndërkombëtar)
Treguesi i vlerës së kompanive në RMV	Pearson Correlation	.599	.384	-.603	.841
	Sig. (2-tailed)	.088	.308	.085	.005
	N	9	9	9	9
Vlerësimi i gjendjes ekonomike kompanive në RMV	Pearson Correlation	.816	.418	-.766	.869
	Sig. (2-tailed)	.007	.262	.016	.002
	N	9	9	9	9
Përqindja e gjendjes financiare kompanive në RMV	Pearson Correlation	.721	.556	-.580	.917
	Sig. (2-tailed)	.028	.120	.101	.000
	N	9	9	9	9
Indeksi i besimit të kompanive në RMV	Pearson Correlation	.482	.092	-.914	.812
	Sig. (2-tailed)	.188	.814	.001	.008
	N	9	9	9	9

Niveli i ndikimit individual ose grupor të treguesve të performancës së kompanisë në indekset e tregut

Pas futjes së katër treguesve të vlerës, vlerësimi ekonomik, vlerësimi financiar dhe besimi i kompanive në RSM me Indeksit të Penetrimit në Tregun Ndërkombëtar në analizat e regresionit linear me metodën hap pas hapi, për t'i përjashtuar ato sipas peshës së ndikimit. Para se të fillojmë me analizat nga tabela 4, më poshtë në tabelën 7 janë renditur treguesit e përjashtuar sipas regresionit linear të cilët, si grup apo individualisht, nuk kanë ndikim në indeksin e depërtimit në tregun ndërkombëtar, përkatësisht treguesi i vlerës së kompanisë, treguesi ekonomik dhe treguesin financiar. Prandaj, në tabelën 4, me ndikimin më të fortë në indeksin e depërtimit në tregun ndërkombëtar, mbetet vetëm Treguesi i Besimit të Kompanisë, përkatësisht $R=.914$ dhe sipas Tabelës 5 $\text{sig}=.001$ $p<0.01$

Tabela 4. Regresioni linear i treguesve për kompanitë sipas Indeksit të Penetrimit të Tregut të Eksportit (Tregu Ndërkombëtar)

Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate
1	.914 ^a	.835	.812	3.844283838285389

a. Predictors: (Constant), Treguesi i besimit të kompanive

Tabela 5. Koeficienti i rëndësishë për regresionin linear të treguesve për kompanitë sipas indeksit të penetrimit të tregut të eksporteve (Tregu Ndërkombëtar)- ANOVA^a

Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	524.328	1	524.328	35.479	.001 ^b
	Residual	103.450	7	14.779		
	Total	627.777	8			

a. Dependent Variable: Indeksi i Depërtimit të Tregut të Eksportit (Tregu Ndërkombëtar) - WORLD_Index_Of_Export_Market_Penetration

b. Predictors: (Constant), Treguesi i besueshmërisë të kompanive

Tabela 6. Koeficientët standardë dhe jo standardë për regresionin linear të treguesve për kompanitë sipas indeksit të penetrimit të tregut të eksporteve (Tregu Ndërkombëtar)

Model		Unstandardized		Standardized	t	Sig.
		Coefficients		Coefficients		
		B	Std. Error	Beta		
1	(Constant)	132.342	10.249		12.913	.000
	Treguesi i besimit të kompanive	-3.734	.627	-.914	-5.956	.001

a. Dependent Variable: Indeksi i depërtimit në tregun e eksportit (tregu ndërkombëtar) - WORLD_Index_Of_Export_Market_Penetration

Tabela 6 tregon qartë këtë ndikim në konstante dhe sipas koeficientit B, nëse kompanitë në RMV kanë një rënie prej -3,734 indekseve të besimit, qasja në tregun ndërkombëtar bëhet më e vështirë (me një rritje të indeksit të penetrimit prej 132,342 njësi - sa më i lartë të jetë indeksi i depërtimit, aksesimi më i dobët).

Tabela 7. Përfshihen variablat nga regresioni linear - Excluded Variables^a

Model		Beta In	t	Sig.	Partial Correlation	Collinearity Statistics
						Tolerance
1	Treguesi i vlerës së kompanive në RMV	.346 ^b	1.469	.192	.514	.363
	Vlerësimi i gjendjes ekonomike të kompanive në RMV	-.054 ^b	-.187	.858	-.076	.330
	Përqindja e gjendjes financiare të kompanive në RMV	.333 ^b	1.472	.191	.515	.394

a. Dependent Variable: Indeksi i Penetrimit të Tregut të Eksportit (Tregu Ndërkombëtar)- WORLD_Index_Of_Export_Market_Penetration

b. Predictors in the Model: (Constant), Treguesi i besimit të kompanive

Prandaj, Tabela 11 ndan variablat e përjashtuar nga regresioni, përkatësisht vlerën e kompanisë, vlerësimin ekonomik dhe indeksin e besimit të kompanisë. Që do të thotë se në tabelën për analizë të mëtejshme, vlerësimi financiar i kompanisë mbetet si një variabël me një efekt domethënës dhe më ndikues në performancën në Indeksin Ndërkombëtar të Hirschmann Herfindahl për konkurrencën.

Tabela 8 tregon koeficientin e regresionit prej $R = .917$ dhe sipas tabelës 9 $\text{sig} = .000$ $p < 0.01$ e cila tregon një ndikim të madh, pra treguesi financiar i kompanisë ka një ndikim të madh në shkallën e konkurrencës në tregun ndërkombëtar (sa më e mirë të jetë gjendja financiare e kompanisë sa më e lartë të jetë cilësia e shërbimit, aq më mirë mund të aksesojë konkurrencën e tregut ndërkombëtar).

Tabela 8. Regresioni linear i treguesve për kompanitë sipas Indeksit Hirschman Herfindahl (Tregu Ndërkombëtar)

Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate
1	.917 ^a	.841	.819	.001720177634045

a. Predictors: (Constant), Përqindja e gjendjes financiare të shoqërive bo PCM - Assessment_of_current_finacial_situation

Tabela 9. Koeficienti i rëndësisë për regresionin linear për treguesit për kompanitë sipas Indeksit Hirschman Herfindahl (Tregu Ndërkombëtar)-ANOVA^a

Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	.000	1	.000	37.087	.000 ^b
	Residual	.000	7	.000		
	Total	.000	8			

a. Dependent Variable: Indeksi Hirschman Herfindahl (Tregu Ndërkombëtar)-WORLD_HH_Market_concentration_index

b. Predictors: (Constant), Përqindja e gjendjes financiare të kompanive në RMV-Assessment_of_current_finacial_situation

Tabela 10. Koeficientët standardë dhe jo standardë për regresionin linear të treguesve për kompanitë sipas indeksit Hirschman Herfindahl (Tregu Ndërkombëtar)

Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
		B	Std. Error			
1	(Constant)	.018	.004		4.179	.004
	Përqindja e gjendjes financiare të kompanive në RMV	.001	.000	.917	6.090	.000

a. Dependent Variable: Indeksi Hirschman Herfindahl (Tregu Ndërkombëtar)-WORLD_HH_Market_concentration_index

Tabela 11. Përjashtohen variablat nga regresioni linear - Excluded Variables^a

Model		Beta	In t	Sig.	Partial Correlation	Collinearity Statistics
Tolerance						
1	Treguesi i vlerës së kompanive në RMV	-.267 ^b	-.541	.608	-.215	.104
	Vlerësimi i gjendjes ekonomike të kompanive në RMV	.386 ^b	1.814	.120	.595	.378
	Treguesi i besimit të kompanive	.248 ^b	1.038	.339	.390	.394

a. Dependent Variable: Indeksi Hirschman Herfindahl (Tregu Ndërkombëtar)-WORLD_HH_Market_concentration_index

b. Predictors in the Model: (Constant), Përqindja e situatës financiare të kompanive në RSM - Assessment_of_current_finacial_situation

Sipas tabelës 10, me një rritje prej 0,001 njësi të situatës financiare të shoqërisë në RSM, do të ketë një ndryshim në Indeksin e Konkurrueshmërisë Ndërkombëtare prej 0,018, i cili sipas këtyre vlerave dhe sipas statistikave përshkruese të variablave Në tabelën 2, ndikimi sipas këtyre shifrave është shumë i vogël, por ky variabël veçohet individualisht nga tre të tjerët me një ndikim të madh në qasjen ndaj konkurrencës në tregun ndërkombëtar.

Përfundim

Bazuar në qëllimin kryesor të këtij hulumtimi, i cili kishte për qëllim përcaktimin e suksesit të menaxhimit të mirë korporativ të kompanive në RMV, sipas të cilit kompanitë menaxhuese tregojnë konkurrencë të lartë dhe qasje më të lehtë në tregun kombëtar ose ndërkombëtar, mund të konkludojmë se qëllimi dhe objektivat e këtij hulumtimi janë arritur.

Siç e theksuam në pjesën metodologjike të studimit, suksesin e qeverisjes së mirë korporative e kemi përfaqësuar me indekset e vlerës së kompanive, vlerësimin ekonomik dhe financiar të kompanive dhe indeksin e besimit të kompanive në RMV dhe suksesin e tyre drejt qasjes më të lehtë në tregun kombëtar ose ndërkombëtar me Indeksin e depërtimit në tregun e eksportit (Index of Export Market Penetration) dhe Indeksin Hirschman Herfindahl (indeksi HH Hirschman Herfindahl) i konkurrueshmërisë. Rezultatet e këtij hulumtimi, sipas operacioneve të aplikuara të koeficientit statistikor rezultoi se ekziston një lidhje midis treguesve të performancës së qeverisjes së mirë të korporatave dhe indekseve ndërkombëtare të penetrimit dhe konkurrencës në treg ku kemi ndarë sipas nivelit të ndikimit besimin dhe gjendjen financiare të kompanive, si përfundim i përgjithshëm. mund të konkludojmë se qëllimi dhe objektivat e këtij hulumtimi janë arritur.

Por nga ana tjetër, për shkak të përjashtimit (me regresion linear) të shumicës së variablave sipas nivelit të ndikimit, mund të konstatojmë se edhe pse në kompanitë në RMV ekziston një qeverisje e mirë korporative e vendosur dhe e strukturuar, veçanërisht në për kompanitë e mesme dhe të mëdha, rezultati i kësaj qeverisje është ende i parëndësishëm, veçanërisht në segmentin e performancës së aksesit në treg të këtyre kompanive, ndërkohë që rekomandohet që qeverisja e mirë korporative të mos mbetet vetëm si dokument në programet dhe programet etike të kompanive, por për të gjetur një mekanizëm (qeveri) me të cilin do të ndërhyhej realisht në fushën e qasjes dhe konkurrencës së tregut të kompanive RSM.

Literatura

- Беличанец Тито, Климовски Александар, Корпоративно управување, Скопје, 2011
- Becht Marco, Patric Bolton and Alisa Roel, „Corporate Governance and Control“, NBER (National Bureau of Economic Research) Working Paper Series, Working Paper 9371, December 2000
- Бобек Шуклев, Корпоративно Управување, 2008.
- Monks, RAD and Monow, N., „Corporate“, Blackwell Business, Oxford, 1995.
- Tricker, R, „Internatioanl Corporate Governance, Readings and Cases“ Prentice Hall International, Singapore, 1994.

- Бела книга за корпоративно управување во Југоисточна Европа, цитирано издание, 2003, преземена дефиниција од Принципи за корпоративни управување на ОЕЦД, П реамбула, (OECD Principles of Corporate Governance Preamble) 1999
- Becht Marco, Patrick Bolton, „Corporate Governance and Control“, цитирано издание, Коевски Горан, „Компаративно управување“, цитирано издание, 2005,
- Andrew H van de Ven, Marshall Scott Poole, 1995, Explaining Development and Change in Organizations, Academy of Management Review, Vol. 20, No.3,
- Marshall Scott Poole and Andrew H. Van de Ven (eds.), (2004) “Handbook of Organizational Change and Innovation”, (New York: Oxford University Press)
- Peter M. Senge, (1990) The Fifth Discipline: „The art and practice of the learning organization”, Does your organization have a learning disability: The parable of the boiled frog, p.22-23
- Porras J & Robertson P., (1987), Organization Development Theory: A Typology and Evaluation, Research in Organizational Change and Development, vol. 1, pp/ 1-57
- Pendlebery J., Grouard B., Meston F., (1995), Successful Change Management, New York: Wiley, исто така Dunphy D., Bennis S., (2003), Organizational Change for Corporate Sustainability, London: Routledge
- B. Barney, 1990, How firm’s capabilities affect boundary decisions, Sloan Management Review, 40 (3):137-145; J. B. Barney, 1991, Firm resources and sustained competitive advantage, Journal of Management, 17:99-120
- K. M. Eisenhardt & S. L. Brown, 1999, Patching: Restitching business portfolios in dynamics markets, Harvard Business Review, 77 (3): 72-84; D. J. Collis & C. A. Montgomery, 1995, Competing on resources: Strategy in the 1990s, Harvard Business Review, 73
- R. Coff, 1999, When competitive advantage doesn’t lead to performance. The resource-based view and stakeholder bargaining power, Organization Science, 10:
- Robert M. Grant: „The Resource – Based Theory of Competitive Advantage: Implications for Strategy Formulation“, California Management Review, Vol. 33, No. 3, Spring 1991,
- Higgins James M., Julian W. Vincze: Strategic management and Organizational Policy: Text and Cases, The Dryden Press, Chicago, 1986.

SFIDAT E PUSHTETIT VENDOR PËR ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI NË SHQIPËRI PËR GARANTIMIN E TË DREJTAVE TË PERSONAVE LGBTI

Av. Altin HAZIZAJ, Dr. Merita PONI¹

Abstract

Although Albania has taken steps forward towards respecting LGBTI rights, at the central and local level, public officials continue to have serious barriers to accept the exercise of sexual rights regarding the expression of sexual orientation and gender identity by LGBTI persons.

In recent years there has been a significant reduction in cases of public violence against LGBTI persons while the level of social acceptance has increased, still LGBTI organisations in Albania continue to report increasing cases towards LGBTI people in family settings, almost total exclusion of transgender people, social discrimination at the workplace. Furthermore, the slow pace of change has increased the tendency to leave the country and seek asylum in the European Union countries.

LGBTI organizations and several international institutions have undertaken efforts to assess the level of access to public services at the local level by persons belonging to the LGBTI community. This has been coordinated with the introduction of new provisions of social services, free legal aid or measures considering the wider protection and access to services.

The Law on Social Services in Albania (2016) guarantees equal access to social services for all individuals who need them. The Law on Protection from Discrimination (2010) grants equal protection from discrimination on any grounds to every person born or residing in Albania. Yet, social prejudices, personal beliefs, traditional values, lack of consideration towards knowledge on sexual orientation and gender identity, religious belief, etc., could be used as a reason to refuse access to services.

In this context, we developed a tool to measure how the personal beliefs of public officials influence access to public services, which are provided at local level, and consequently, identify discriminatory practices against LGBTI persons that would be in violation of the current legal framework. The paper seeks to demonstrate that using social research methods and tools such as focused groups, questionnaires and surveys can be used as a method of scientific research in legal sciences, establishing wider opportunities for scientific measurement of the knowledge, recognition and degree of the implementation of laws, while provide evidence for the causes and factors affecting the lack of implementation of legal norms in given social environments.

Among others, the paper seeks to identify the main barriers that the LGBTI persons face when seeking or accessing local services, based on interviewing officials in six major municipalities in Albania. The data were collected and processed by the authors of this paper in the framework of cooperation with the PINK Embassy Albania during 2015-17.

TË JESH LGBTI NË SHQIPËRI

Të jesh lezbike, gej, biseksual, transgjnor apo interseksual në Shqipëri nuk është diçka e lehtë. Si një orientim seksual apo identitet gjnor², të qenit LGBTI është parë dhe shihet ende nga shoqëria me paragjykime, qëndrime negative deri tek dhuna apo urrejtja e hapur kundër çdo personi që dyshohet apo pranon së është LGBTI ose shoqërohet me ta.

Shqipëria e dekriminalizoi zyrtarisht homoseksualizmin në vitin 1995, me hyrjen në fuqi të Kodit të ri Penal, 18 vjet pasi sistemi brutal komunist kishte vendosur të ndëshkojë orientimin seksual vetëm për djemtë dhe burrat në Nenin 137 (Pederastia) të Kodit Penal të Republikës

¹ Altin Hazizaj është Kandidat-Doktor pranë Katedrës të të Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, ndërsa Dr. Merita Poni është lektore dhe pedagoge pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës.

² Orientimi seksual përshkruan një model ose strukturë të qëndrueshme tërheqjeje emocionale, romantike dhe seksuale ose kombinim të tyre kundrejt seksit të kundërt, seksit të njëjtë, të dyja seksve ose asnjërit prej seksve dhe gjinive që i shoqërojnë ato². Identiteti gjnor është mënyra se si një njeri vet-identifikohet me një kategori gjnore, si për shembull të jesh femër ose mashkull, apo në disa raste asnjë prej tyre, i cili mund të jetë i dallueshëm nga seksi biologjik. – sipas përkufizimit të bërë nga Shoqata Amerikane e Psikologëve (APA)

Popullore Socialiste të Shqipërisë³. Numri i personave që u dënuan përgjatë kësaj periudhe për kryerjen e marrëdhënieve në seks të njëjtë mbetet ende edhe sot e kësaj dite e panjohur. Ndonëse ka patur disa thirrje drejtuar Kuvendit, që të dëmshpërblejë dhe t'ju kërkojnë ndjesë ndaj të gjithë të dënuarve për këtë veper penale, deri më tani kjo nuk ka ndodhur⁴.

Rrëzimi i sistemit komunist dhe fillimi i ndryshimeve demokratike bënë të mundur krijimin e një lëvizje modeste LGBTI që në vitin 1994 u kurorëzua me krijimin e Shoqatës Gay Albania⁵, e para organizatë në historinë e Shqipërisë për të drejtat e komunitetit LGBTI. Megjithatë u desh viti 2010 që Shqipëria të fillonte të fliste haptazi për personat LGBTI.

Mungojnë të dhënat mbi gjendjen e diskriminimit në shërbimet publike dhe private përsa i përket komunitetit LGBTI. Mungesa e studimeve, rasteve, vlerësimeve apo ankesave, është një tregues ndër të tjera edhe i mungesës së njohjes së mbrojtjes që ofron ligji për mbrojtjen nga diskriminimi në Shqipëri, kulturës së mos-ankimit dhe sigurisht frikës për bërjen publike të orientimit seksual apo identitetit gjinor nga familja apo edhe publiku i gjerë.

METODOLOGJIA E PËRDORUR

Të dhënat e përdorura për përgatitjen e këtij punimi, bazohen në studimin “Aksesi në shërbimet vendore nga komuniteti LGBTI në Shqipëri”, të Ambasadës PINK Shqipëri të zbatuar gjatë vitit 2016. Për të përmbushur objektivat e kërkimit dhe për të adresuar pyetjet kërkimore, u përzgjedh një përfaqesë metodologjike sasiore, ku kampioni u përcaktua duke marrë në konsideratë numrin e të punësuarve në sektorin publik pranë gjashtë bashkive: Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan, Korçë dhe Vlorë, si dhe duke studiuar sektorët e shërbimit që pushteti vendor ka për detyrë të ofrojë përkundrejt banorëve të tyre. Të dhënat e mbledhura si edhe kampioni nuk janë përfaqësues, pavarësisht tendencave, diferencave apo të përbashkëtave që kampioni mund të tregojë nëpërmjet krahasimit nga bashkia në bashki.

Përsa i përket qasjes sasiore, studiuesit përgatitën instrumentin (pyetësor) përgjatë vitit 2015 dhe e testuan atë paraprakisht në dy fokus grupe me përfaqësues të përzgjedhur nga të gjitha bashkitë pjesë e studimit. Instrumenti i kërkimit përmbante 32 pyetje, të cilat ndaheshin në 4 fusha: aspekte të përgjithshme të të intervistuarit (qyteti, mosha, gjinia), aspekte personale të të intervistuarit (martesa, formimi, besimi fetar etj.), perceptimet personale ndaj personave LGBTI (niveli i pranimit ose refuzimit), qëndrimet personale përkundrejt personave LGBTI (niveli i shërbimit apo refuzimi sipas shkakut etj.), e së fundi edhe nevoja për trajnime apo njohja e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi. Instrumenti i kërkimit (pyetësori) ushte me vetë-plotësim, për të shmangur çdo influence apo ndërhyrje nga intervistues të jashtëm.

KAMPIONI DHE TË DHËNAT DEMOGRAFIKE

Kampioni përbëhej vetëm nga përfaqësues të niveleve të ndryshme hierarkike, të profesioneve dhe pozicioneve në Bashki. Bashkitë u përzgjedhën për shkak të zbatimit të projektit të Ambasadës PINK të mbështetur nga Delegacioni i Bashkimit Europian në këto 6 bashki dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara ndërmjet PINK dhe bashkive.

Në total u shpërndanë 350 pyetësorë në të gjitha Bashkitë, nga 50 pyetësorë për çdo bashki, me përjashtim të Tiranës, ku për shkak të numrit të lartë të të punësuarve, krahasuar me Bashkitë e tjera, u shpërndanë 100 pyetësorë. Në total u dorëzuan të plotësuar 64.2 përqind e

³ Neni 137 I Kodit Penal të vitit 1977, nën termin “pederastia” thotë: Pederastia dënohet me burgim gjeri në 10 vjet”

⁴ Deklaratë Publike e Ambasadës PINK, për Dëmshpërblimin e të Dënuarve për Homoseksualizëm në periudhën komuniste (<http://www.pinkembassy.al/qeveria-t%C3%AB-d%C3%ABmshp%C3%ABrblej%C3%AB-t%C3%AB-gjith%C3%AB-personat-lgbt-t%C3%AB-d%C3%ABnuar-gjat%C3%AB-regjimit-komunist>)

⁵ Gazeta “Koha Jonë”, Prill 1994. / Gazeta “Shqiptarja” Homoseksuali shqiptar: Ja si jetonim në kohën e monizmit (<http://shqiptarja.com/news.php?IDNotizia=75719>)

pyetësorëve. Niveli i refuzimit ishte 35.8 përqind nga ana e zyrtarëve vendorë, të cilët nuk e plotësuan ose refuzuan ta plotësojnë instrumentin e studimit.

TABELA 1: Niveli i plotësimit dhe refuzimit të pyetësorit, nga zyrtarët publikë vendor

Rrethi	Nr. i pyetësorëve të shpërndarë për Bashki	Nr. i pyetësorëve të plotësuar	% e pyetësorëve të plotësuar për Bashki
Durrës	50	27	54
Elbasan	50	32	64
Korçë	50	23	46
Shkodër	50	41	82
Tiranë	100	55	55
Vlorë	50	47	94
Total	350	225	64.2

Nga të dhënat sasiore të mbledhura rezultoi se kampioni përfaqësohej në këto përqindje, sipas bashkive: Durrës (11.6%), Elbasan (14.2%), Korçë (10.3%), Shkodër (18.3%), Tiranë (24.6%) dhe Vlorë (21.0%).

TË DHËNAT DEMOGRAFIKE

Të anketuarit ishin punonjës të administratës vendore në pozicionet specialist dhe drejtues sektori shërbimesh publike vendore. Rreth 82.6 përqind e të anketuarve punonin si specialistë dhe 17.4 përqind si drejtues të sektorëve të shërbimeve. Përqindjen më të lartë të të anketuarve e zenë punonjëset vajza dhe gra të cilat përbëjnë 72.2 për qind, ndërsa 21.4 përqind ishin burra. Përsa i përket moshës, të anketuarit u ndanë në pesë grup-mosha me intervale 10-vjeçare: 19-30 vjeç, 31-40 vjeç, 41-50 vjeç, 51-60 vjeç, mbi 60 vjeç – deri në moshë pensioni 65 vjeç. Të dhënat e kërkimit tregojnë se administrata vendore ka një moshë relativisht të re. Rreth 59.4 për qind i përkasin grup-moshës 19-40 vjeç, ndërsa 39.7 përqind janë të grup-moshës 41-60 vjeç. Vetëm 3.0 përqind ishin mbi moshën 60 vjeç. Përqindja e lartë e grupmoshës 20-40 vjeç në administratën vendore, me rreth 60 përqind të të anketuarve, është tregues i rëndësishëm për perceptimet kulturore që ata kanë në lidhje me personat LGBTI.

Për të kuptuar nëse perceptimet dhe qëndrimet e punonjësve të administratës vendore ndaj personave LGBTI ndikohen prej nivelit arsimor, të anketuarit u përzgjedhën bazuar edhe tek niveli arsimor. Shumica e të anketuarve ishin me shkollë të lartë, 93.3 për qind, ndërsa një pakicë e vogël prej 7.7 për qind janë me shkollë të mesme. Përsa i përket formimit universitar, pjesa më e madhe e tyre, 29.9 përqind, kanë përfunduar studimet për ekonomi, të ndjekur nga punonjës me profil të shkencave sociale. Rreth 14.3 përqind e të punësuarve janë me formim juridik, të ndjekur nga mësuesia, inxhinieria apo mjekësia, sipas grafikut. Shumica e të anketuarve në studim, 65.6 përqind ishin të martuar. Rreth 25.9 përqind ishin beqarë. Brenda kësaj grup-moshe një pjesë e vogël, thuhetse 5 përqind bashkëjetojnë. Një përqindje e vogël e të anketuarve (3.6 përqind) ishin të divorcuar ose të ve.

KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL NË LIDHJE ME TË DREJTAT E PERSONAVE LGBTI NË SHQIPËRI.

AKTET NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (1948) sanksionon parimin e barazisë dhe të mos diskriminimit në nenin 7 të saj, ku parashikon se “Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe

kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për t'u mbrojtur barabar kundër çdo diskriminimi që çënon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitje për një diskriminim të tillë”.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (1966) në Nenin 26 thekson: “...ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë dhe efektive, kundër çdo diskriminimi e sidomos për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik dhe çdo opinionit tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, lindjes ose çdo situatë tjetër”.

Konventa mbi Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAË) e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1994. Si shtet anëtar në CEDAË Shqipëria ka raportuar 2 herë në komitetin përkatës të konventës, përfshi edhe të drejtat e LBT-ve;

Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF) e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1992, ndër të tjera garanton mbrojtjen e integritetit fizik, mendor dhe seksual të çdo personi nën moshën 18 vjeç.

Konventa e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1996. Neni 14 i KEDNJ, Protokollin Nr. 12 i KEDNJ-së dhe Jurisprudenca e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, mbështesin të drejtën për të mos u diskriminuar për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Karta Sociale Europiane (ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2002) sanksionon parimin e barazisë (neni 20) duke përcaktuar në mënyrë të shprehur se “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit” dhe parimin e mosdiskriminimit (neni 21).

Rekomandimi CM/Rec (2010)5 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës “Mbi masat për të luftuar diskriminimin mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor”, Komiteti i Ministrave, rekomandon shtetet që të marrin masa në drejtim të garantimit të së drejtës për jetën, sigurinë dhe mbrojtjen nga dhuna, të personave për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

LEGJISLACIONI SHQIPTAR PËR TË DREJTAT E PERSONAVE DHE KOMUNITETIT LGBTI

Kushtetuta e Shqipërisë në një serë dispozitash të saj synon nxitjen e respektimit të barazisë dhe mosdiskriminimit (kryesisht neni 18, por edhe nenet 16 e 20)⁶. Kushtetuta nuk e parashikon shprehimisht orientimin seksual dhe identitetin gjinor tek shkaqet e përmendura shprehimisht për mbrojtjen nga diskriminimi, duke i përfshirë ato tek gjendjen sociale të njeriut.

Kodi Penal përtej eliminimit të kriminalizimit të marrëdhënieve në seks apo gjini të njëjtë nuk ofroi për një kohë të gjatë mbrojtje të posaçme për personat LGBTI. Falë një përpjekjeje të Avokatit të Popullit dhe të Ambasadës PINK, në vitin 2013 Kodi përfshiu ndryshime të rëndësishme që bëjnë të mundur mbrojtjen e personave LGBTI nga gjuha e urrejtjes (Neni 253 dhe 265) apo duke caktuar si rrethanë rënduese krimet që mund të bëhen kundër tyre (Neni 50).

Kodi i Familjes (Neni 7) thotë se “martesa mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç”. Ky nen në mënyrë të qartë ndalon martesën mes personave të të njëjtit seks, përfshi edhe bashkëjetesën. Adoptimi i një fëmije gjithashtu nuk lejohet për çiftet e të njëjtit seks, neni 242 të Kodit të Familjes parashikon se “ I mituri nuk mund të birësohet nga shume persona, përveç rastit kur ata janë bashkëshortë.”

⁶ Në nenin 18 Kushtetuta parashikon: 1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si **gjinia**, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.

Kodi i Punës (i ndryshuar në vitin 2016) përfshiu për herë të parë në mbrojtjen nga diskriminimi edhe orientimin seksual dhe identitetin gjinor, falë kërkesave të vazhdueshme të Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Neni 9 i Kodit⁷, paragrafi 2, paraqet të gjitha elementet se kur ndalohet diskriminimi në marrëdhëniet e punës.

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” (Ligj Nr.10 221, datë 4.2.2010), për personat dhe komunitetin LGBTI përbën një hap pozitiv në mbrojtjen e të drejtave të tyre. Ky ligj përmban një listë jo shteruese shkaqesh, për të cilat ofron mbrojtje nga sjellja diskriminuese, dhe parashikon shprehimisht mes tyre edhe orientimin seksual dhe identitetin gjinor⁸. Gjithashtu ligji jep përkufizimet e një sërë konceptesh të rëndësishme si diskriminim i drejtpërdrejtë, diskriminim i tërthortë, diskriminim për shkak të shoqërimit, viktimizimi etj.

Ligji për Arsimin Para-universitar në Shqipëri (2013) në vijim të rekomandimeve të institucioneve të të drejtave të njeriut dhe në zbatim të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, përfshiu për herë të parë edhe mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të orientimit seksual, por la jashtë për arsye që nuk dihen identitetin gjinor. Ndër të tjera ligji parashikon ngritjen e Komisioneve të Etikës pranë çdo shkolle për të trajtuar rastet e dhunës apo diskriminimit ndaj fëmijëve apo edhe qeverisjesve.

Ligji për Vetëqeverisjen Vendore (Ligj Nr. 139/2015) ka si objekt të tij të rregullojë “organizimin dhe funksionimin e njësisë të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse.” Në këtë kuadër, një ndër detyrat funksionale të pushtetit vendor është (Neni 3/b) “respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera” dhe (Neni 3/c) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.”

Ligji për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror (Ligj Nr. 121/2016) i hapi rrugë riorganizimit të shërbimeve ekzistuese si dhe krijimit të tipologjive të reja të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Ligji për herë të parë përfshiu ndër të tjera edhe parimin e mos-diskriminimit të ofrimit të shërbimit, i cili thotë (Neni 3): “ë) Parimi i mosdiskriminimit. Ndalohet çdo formë e diskriminimit të përfuturit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në shkaqet e përmendura në legjisllacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.” Ligji garanton akses të barabartë për çdo qytetar në shërbimet shoqërore, përfshi edhe personat LGBTI.

Ligji për Strehimin Social (Ligj Nr. 22/2018) është një tjetër normë juridike që bën pjesë në korpusin e ligjeve në kuadër të shërbimeve që ofrohen nga pushteti vendor. Qëllimi i ligjit është “përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm...”

⁷ Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.

⁸ Neni 1 i ligjit përcakton se qëllimi i tij është “zbatimi dhe respektimi i parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

POLITIKA KOMBËTARE PËR PERSONAT LGBTI NË SHQIPËRI

Në vijim të zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në vitin 2011, Qeveria e Shqipërisë dhe respektivisht Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, punoi për të përgatitur një plan modest veprimi në mbështetje të komunitetit LGBTI. Kjo përbën një arritje madhore për Shqipërinë, pasi është plani i parë në historinë e vendit, ku një politikë publike përgatitet dhe miratohet për të mbrojtur të drejtat e personave LGBTI, përfshirë edhe aksesin në shërbime.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBTI në Republikën e Shqipërisë (2021-2027), është dokumenti i katërt politik dhe strategjik që Qeveria shqiptare ka miratuar ndër vite në mbështetje të avancimit të të drejtave LGBTI në vend. Ai bazohet mbi këto qëllime strategjike: (a) Përmirësimi i aksesit të personave LGBTI+ në shërbime publike dhe shërbime mbështetëse të specializuara efektive, cilësore dhe të disponueshme në mbarë vendin, në përputhje me nevojat specifike të tyre dhe me standarde kombëtare të harmonizuara me ato europiane/ndërkombëtare; (b) Garantimi i mbrojtjes dhe sigurisë për personat LGBTI+ përmes përmirësimit të kuadrit ligjor, zbatimit efektiv të tij, si dhe rritjes së aksesit të personave LGBTI+ në sistemin e drejtësisë. (c) Krijimi i një shoqërie gjithëpërfshirëse, pranuese dhe jo-diskriminuese kundrejt personave LGBTI+ në Shqipëri. Zbatimi i Planit drejtohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si institucioni përgjegjës i kësaj politike publike, në koordinim me të gjitha ministrinë e linjës.

PERCEPTIMET E ZYRTARËVE PUBLIKË VENDORË PËRKUNDREJT PERSONAVE LGBTI NË SHQIPËRI

1.1 Akresi në shërbime dhe trajtimi i personave LGBTI nga zyrtarët në nivel vendor

Të anketuarit u pyetën mbi përceptimet që ata kanë për shërbimin që ju ofrohet personave LGBTI nga ana e bashkisë ku ata punojnë. Informacioni i marrë ndriçon disa aspekte cilësore të shërbimit vendor që lidhen me trajtimin korrekt dhe mikpritës për qytetarët, me mundësinë e tyre për t'u ankuar, nëse nuk janë të kënaqur me shërbimet, me qëndrimet negative ndaj LGBTI dhe shfaqjen e sjelljeve diskriminuese ndaj tyre. Tabela e mëposhtme paraqit një përmbledhje të opinioneve të të anketuarve.

TABELA 2: Trajtimi nga shërbimi publik në nivel vendor (në %)

Trajtimi nga shërbimi publik në nivel vendor në %	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Pa përgjigje	Total
A u krijohet një mjedis mikpritës kur vijnë të marrin shërbime?	9.4	11.2	64.7	14.7	100
A kanë mundësi ankimi për shërbimin?	10.7	17.4	52.7	19.2	100
A kërcënohen me mos-marrje shërbimi?	70.5	7.2	4.9	17.4	100
A ushtrohet dhunë verbale ndaj tyre (sharje, fyerje, komente denigruese, etj)?	75	4.9	1.8	18.3	100
A ushtrohet dhunë fizike ndaj tyre (shtyrje, hedhje, goditje, terheqje me force, etj)?	78.6	2.7	0.4	18.3	100
A ka pasur konflikte me punonjës?	77.7	5.3	0	17	100

Akresi në shërbime dhe qëndrimet e punonjësve ndaj personave LGBTI

Shumica e të anketuarve, rreth 65.0 përqind, deklarojnë se personave LGBTI iu ofrohet një mjedisi mikëpritës gjatë marrjes së shërbimeve në bashki. Në fakt këtë opinion të anketuarit e kanë për shërbimin që ofrojnë vetë për të gjithë qytetarët në përgjithësi, përfshirë edhe LGBTI, pra përgjigja e tyre nuk ka të bëjë specifikisht me personat LGBTI, pasi ata i konsiderojnë këta si të gjithë qytetarët e tjerë. Duke qenë se të anketuarit japin një vlerësim të punës së tyre si ofrues shërbimesh, ata tentojnë ta paraqesin punën e tyre si shumë pozitive, prandaj shumica deklarojnë se janë miqësorë me qytetarët.

Edhe pse përgjithësisht punonjësit vendorë duken të predispozuar t'u ofrojnë shërbime qytetarëve LGBTI, pa i diskriminuar, jo të gjithë shprehen se mjedisi shoqëror në administratën është miqësor ndaj tyre. Rreth 9 përqind e punonjësve shprehen se personeli i bashkisë nuk është mikpritës ndaj personave LGBTI. Ndërsa rreth 15 përqind e punonjësve janë të pasigurtë nëse bashkia ofron aktualisht një mjedisi mikpritës për personat LGBTI.

Refuzimi i të drejtës për të marrë shërbime nga bashkia




Përgjigjet e dhëna nga shumica, rreth 71 përqind e të anketuarve, në lidhje me faktin nëse personave LGBTI iu mohohet e drejta për të marrë shërbim nga ana e administratës vendore janë përgjithësisht negative, pra ata nuk kërcënohen me refuzim shërbimi.

Pjesa tjetër, rreth 12 përqind e punonjësve janë përgjigjur se personat LGBTI kërcënohen të mos marrin shërbime nga ana e

administratës vendore, prej të cilëve 7 përqind shprehen se kjo ndodhë *ndonjëherë*, ndërsa 5 përqind shprehen se kjo ndodh *shpesh*.

A duhet të marrin shërbime personat LGBTI në bashki?




Në përgjithësi, të anketuarit, thuajse 90 përqind u shprehen se personat LGBTI duhet të marrin shërbime në bashki si gjithë qytetarët e tjerë. Një pjesë e të anketuarve, rreth 11 përqind u shprehen se personat LGBTI nuk duhet të marrin shërbime në bashki, por shërbime të veçuara të destinuara vetëm për ata ose veç të tjerëve ose aspak.

Për të eksploruar me tej arsyen që i ka shtyrë një pjesë të të anketuarve të shprehen se personat LGBTI duhet të marrin

shërbime veç të tjerëve, ata u pyetën se në të mirë të kujt është kjo? Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve, 38.4 përqind nuk shohin ndonjë dobi specifike tek shërbimet e veçuara. Kur pyeten në lidhje me shërbimet e veçuara të destinuara vetëm për personat LGBTI përqindja e të anketuarve që mendojnë se shërbimet duhet të jenë të njëjta (88.8 për qind) gati përgjysmohet (50.4 për qind) kur ripyeten për të rikonfirmuar ose rishikuar këtë opinion. Përgjysmimi i mbështetësve të shërbimeve të përbashkëta është shumë problematik, pasi konfirmon pozitën e lëkundur të punonjësve në lidhje me formën e shërbimit më të përshatshëm për personat LGBTI.

Gatishmëria e punonjësve për të ofruar shërbime sipas moshës




Punonjësit që shfaqen më të hapur dhe më pranues për personat LGBTI i përkasin grup-moshës 19-29 vjeç, ndërsa më pak pranues duket të jetë grup-mosha 40-49 vjeç, ku një në tre punonjës nuk do ishte i gatshëm për t'i shërbyer një personi LGBTI

Formimi universitar është një tjetër variabël që është

analizuar në korrelacion me qëndrimet ndaj shërbimeve. Të dhënat e analizuar tregojnë se mjekët dhe arkitektët janë më miqësorë në dhënien e shërbimeve ndaj personave LGBTI, krahasuar me profesionistët e tjerë. Interes paraqesin të dhënat bazuar tek variablat gjinorë dhe arsimorë me gatishmërinë për t'u shërbyer personave LGBTI. Në profesionet inxhinieri, juridik dhe ekonomik vihet re qartë se punonjëset vajza dhe gra janë më të gatshme se sa burrat të ofrojnë shërbime për personat LGBTI.


Shërbimet e kërkuara nga personat LGBTI pranë njësisive të pushtetit vendor



Rreth 30 për qind e të anketuarve shprehen se personat LGBTI kanë kërkuar shërbime në bashki si: punësim, strehim, ndihmë ekonomike, etj., ndërsa rreth 70 për qind shprehen se nuk kanë ofruar shërbim për ndonjë person LGBTI. Kjo përqindje korrespondon me përqindjen e atyre që nuk kanë njohje me personat LGBTI, pra është i njëjti

grup të anketuarish që përgjigjet se nuk ka njohje dhe nuk ka ofruar shërbime për personat LGBTI. Mosnjohja me personat LGBTI bën që dy të tretat e punonjësve të bashkive të shprehen se nuk kanë pasur mundësi të ofrojnë shërbime për personat LGBTI.

Mbrojtja e privatësisë së personave LGBTI



Në lidhje me mbrojtjen e privatisisë së personave LGBTI, pjesa më e madhe e të anketuarve, 81 për qind shprehen se nuk e dinë nëse privatisia e tyre ruhet apo jo nga ana e stafit vendor. Kjo përqindje e lartë hezitimi tregon se sa të pambrojtur janë personat LGBTI në privatisinë e tyre nga ana e shërbimit publik vendor. Të dhënat e tyre personale dhe identiteti i

tyre gjinor mund të jenë objekt diskutimi, komentesh denigruese dhe mund t'i ekspozojnë ata ndaj praktikave diskriminuese për shkak të orientimit seksual. Përqindja e lartë e të anketuarve të pasigurtë rreth mbrojtjes së privatisisë së personave LGBTI tregon nevojën e madhe që ka personeli i bashkive për trajnim në fushën e ruajtjes së privatisisë së të dhënave të personave LGBTI dhe personave të tjerë që ndodhen në pozita të pafavorshme sociale.

OPINIONET DHE PERCEPTIMET E ZYRTARËVE VENDORË PËR PERSONAT LGBTI

TABELA 4: Opinione kryesore në lidhje me të drejtat e personave LGBTI?

Sa përputhet mendimi juaj me pohimet e mëposhtme për qëndrimin – ndaj LGBTI?	Shkalla e përputhshmërisë në %				
	Shumë	Disi	Pak	Aspak	Pa përgjigje
a- janë qytetarë si gjithë të tjerët	68.3	13.4	1.8	5.4	11.2
b- kanë të drejtë të arsimohen me të tjerët	81.7	6.3	0.4	0.9	10.7
c- kanë të drejtë të punësohen në administratën publike	73.2	8.0	3.6	3.1	12.0
d- kanë të drejtë të frekuentojnë të njëjta mjedise shërbimi	79.0	6.3	0.9	1.3	12.5
e- kanë të drejtë të ankohen nëse ju shkelen të drejtat	80.8	4.9	0.4	1.8	12.0
f- kanë të drejtë të martohen	42.4	8.5	5.8	20.5	22.7
g- kanë të drejtë të krijojnë familje	33.9	11.6	4.0	25.4	25.0
h- janë po aq korrektë sa qytetarët e tjerë në sjellje	55.8	16.5	1.3	5.8	20.6
i- janë më miqësorë se njerëzit e tjerë	28.6	17.0	5.4	14.7	24.4
j- duhet të gëzojnë më pak të drejta	10.3	4.0	4.9	58.9	21.9
k- janë më inferiorë se të tjerët	5.8	16.5	10.3	43.8	23.7

Përgjithësisht të anketuarit shprehen pozitivisht në lidhje me respektimin e të drejtave të personave LGBTI. Midis 70-80 për qind e tyre mendojnë se personat LGBTI janë si gjithë qytetarët e tjerë, kanë të drejtë të arsimohen me të tjerët, kanë të drejtë të punësohen në administratën publike, kanë të drejtë të marrin shërbime publike në të njëjtat mjedise me qytetarët e tjerë dhe kanë të drejtë të ankohen nëse ju shkelen të drejtat.

Ndërkohë që miratojnë pasjen e të drejtave në përgjithësi për personat LGBTI, të anketuarit në mënyrë paradoksale nuk miratojnë dy të drejta themelore, atë të martesës dhe të krijimit të familjes, gjë që kundërshton opinionin e mëparshëm. Pra, të anketuarit nuk i miratojnë të drejtat themelore të personave LGBTI për t'u martuar (57.5 për qind) dhe për të pasur familje (66 për qind). Përveç të drejtës së martesës dhe familjes, të anketuarit janë pozitivë për të drejtat e tjera themelore si ajo e arsimit dhe e punësimit.

Në lidhje me opinionin se a ndihen inferiorë apo jo personat LGBTI për identitetin e tyre rreth gjysma, 55.5 për qind e të anketuarve janë të pasigurtë. Kjo tregon për një mosnjohje nga ana e tyre të personave LGBTI dhe problemeve që këta hasin me procesin e vet-deklarimit të identitetit LGBTI (procesi i coming-out). Një shkallë të lartë pasigurie, të anketuarit paraqesin edhe në lidhje me opinionin mbi sjelljen miqësore të personave LGBTI. Shprehen se nuk e dinë nëse personat LGBTI janë apo jo më miqësorë se të tjerët rreth 56.7 për qind e të anketuarve. Ky fakt konfirmon rezultatin e mësipërm, sipas të cilit, punonjësit vendorë nuk kanë shumë njohje me persona LGBTI. Mospasja e kontakteve dhe e njohjeve me personat LGBTI duket edhe në përgjigjet e pasigurta të dhëna nga të anketuarit për korrektësinë e sjelljes dhe marrëdhënieve të krijuara nga LGBTI, pasi janë afërsisht 40 për qind ata që shprehen se nuk dinë të shprehen për këtë opinion

Gjetjet kryesore dhe rekomandimet kryesore

Në përfundim të këtij procesi, ne identifikua disa gjetje, të cilat po i grupojmë në katër fusha kryesore, si më poshtë:

zyrtarët vendorë dhe njohja me komunitetin lgbti

- Zyrtarët vendorë në gjashtë bashkitë që u bënë pjesë e studimit ishin të hapur për t'u bërë pjesë e studimit për një çështje që në të vërtetë është sensitive për shumë persona. Ky është një tregues i rritjes së maturisë së institucioneve publike vendorë, të cilat përtej detyrimit ligjor për të mbështetur çdo qytetar që jeton në territorin e tyre, ishin të hapur për të biseduar dhe për t'u intervistuar në kuadër të këtij studimi.
- Nga analiza e të dhënave demografike, vihet re se zyrtarët që kanë studiuar për profesione më bazë sociale janë edhe më të hapur për të mbështetur dhe punuar për avancimin e të drejtave të personave lgbti.

Qëndrimet e zyrtarëve vendorë përkundrejt personave lgbti

- **Qëndrimet negative** përkundrejt personave LGBTI ndikojnë drejtpërsëdrejti në cilësinë e ofrimit të shërbimeve në nivel vendor. Rreth 9% e zyrtarëve publikë vendorë deklarojnë se kanë qëndrime negative (pra nuk duan) që t'i ofrojnë shërbime personave LGBTI ndërsa 15% të tjerë janë të pasigurtë në këtë drejtim. Ky nivel i lartë i qëndrimeve negative është i lidhur si me mungesën e kontakteve direkte me komunitetin LGBTI, mungesën e informacionit si dhe të trajnimeve në fushë. Mungesa e politikave, kodeve të sjelljes apo standardeve bazë të punës me minoritetet në çdo bashki rrit mundësinë e përforcimit të qëndrimeve negative, në vend që ato me kalimin e kohës të eliminohen tërësisht;
- **Refuzimi i shërbimit (5%), dhuna verbale (7% në total) dhe fizike (3%) apo ngritja e shërbimeve të veçanta për personat LGBTI (2.2 % dhe 6.3%)** janë tregues se mungesa e standardeve të komunikimit dhe supervizimit të ofrimit të shërbimeve i detyron një pjesë të vogël të zyrtarëve publikë të jenë përjashtues, ndëshkues dhe diskriminues ndaj personave LGBTI. Ky qëndrim mund të jetë i njëjte edhe për personat jo LGBTI, por për shkak të mungesës së studimeve është e vështirë që të analizohet ky aspekt. Qëndrime të tilla vetëm përforcojnë sjelljet negative ndaj personave LGBTI dhe rrjedhimisht edhe përjashtimin e tyre të mëtejshëm social, gjë që është në kundërshtim me të gjithë politikën shtetërore dhe legjisllacionin vendas.

- **Mosha, aspektet kulturore dhe traditat** mund të bëhen pengesë për ofrimin e shërbimeve të barabarta për qytetarët, përfshi edhe personat LGBTI. Nga krahasimi i bërë ndërmjet gjashtë bashkive rezulton se disa bashki kanë nivel më të lartë të ofrimit të shërbimeve miqësore për personat LGBTI (Korça psh) sesa disa të tjera (Durrës dhe Vlorë). Nga ana tjetër mosha është një kontribuues i rëndësishëm në pranimin dhe respektin e orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Sa më i ri më moshë të ishte personi aq më pozitive ishte tendenca e zyrtarëve publikë vendorë për të punuar dhe pranuar personat LGBTI. Në vetvete kjo do të thotë që në trajnimet dhe informacionin që ofrohet për zyrtarët nga vetë bashkia, mosha duhet të jetë një faktor që duhet marrë në konsideratë për të përforcuar qëndrime të reja dhe pozitive, që ndihmojnë ofrimin e shërbimeve.
- **Gratë dhe vajzat në shërbimet publike** janë më të hapura dhe mbajnë qëndrime më pozitive përkundrejt personave LGBTI, krahasuar me djemtë dhe burrat. Ka një serë studimesh që shpjegojnë shkaqet dhe faktorët që shpjen në diferenca të tilla midis gjinive. Ajo çka paraqet rëndësi për politikanët vendorë dhe për të gjithë ata që punojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve është fakti se gjinia dhe seksi janë një faktor që ndikojnë në ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët;

OPINIONET DHE PERCEPTIMET E ZYRTARËVE PËR PERSONAT LGBTI

- Pavarësisht se në tërësi studimi ka gjetje pozitive në drejtim të qëndrimeve përkundrejt komunitetit LGBTI, përsëri ka një nivel të lartë paragjykimesh, mos-pranimi apo refuzimi për barazinë midis personave LGBTI dhe atyre heteroseksualë. Kështu studimi arriti të identifikonte se 32% e të intervistuarve mendonin se personat LGBTI janë më inferiorë se pjesa tjetër e qytetarëve; 24% e tyre mendojnë se personat LGBTI nuk duhet të punësohen në administratën publike; 26% e të pyeturve thonë se personat LGBTI nuk janë qytetarë si gjithë të tjerët dhe së fundmi 10% e zyrtarëve mendojnë se personat LGBTI duhet të kenë më pak të drejta se të tjerët.
 - Zyrtarët publikë kanë një nivel të lartë paragjykimesh dhe mos-pranimi përkundrejt personave transgjinorë. Nisur edhe nga fakti që një pjesë e komunitetit transgjinor jeton në kushte ekstreme të varfërisë, në rrugë apo duke ushtruar prostitucion, përjetimet që zyrtarët publikë kanë ndaj tyre ndryshojnë nga ato përkundrejt personave LGB. Ky ndryshim është edhe tregues i mungesës së përgatitjes së zyrtarëve publikë për t'u përballur me identitetin gjinor, si një çështje komplekse që kërkon vëmendje të posaçme institucionale.
- Niveli i trajnimeve dhe nevoja për trajnime të vazhdueshme për zyrtarët publikë vendorë
- Zyrtarët publikë kanë një nivel të lartë të njohjes së koncepteve për të drejtat lgbti dhe si rrjedhojë edhe një mungesë në drejtim të marrjes së trajnimeve përkatëse. Rreth 75% e të gjithë zyrtarëve vendorë të intervistuar deklaruan se nuk ishin trajnuar asnjëherë në këtë fushë specifike të të drejtave të njeriut.
 - Një tjetër gjetje interesante ishte fakti se pavarësisht se shqipëria ka një legjislacion të përparuar në fushën e mbrojtjes të të dhënave personale, rreth 81% e zyrtarëve vendorë të intervistuar nuk ishin të informuar nëse të dhënat personale të personave lgbti ishin trajtuar në një mënyrë të tillë që të garantonin privatësinë e tyre dhe mbrojtjen e identitetit të tyre në lidhje me orientimin seksual apo identitetin gjinor.

Rekomandimet

Në përfundim të analizës së kryer studiuesit rekomandojnë sa më poshtë:

- Kuvendi luan një rol të pazëvendësueshëm për njohjen dhe përmirësimin e situatës të të drejtave të njeriut të personave lgbti. Ky rol nuk mund të kufizohet vetëm në dhënien e rekomandimeve për institucionet publike në të gjitha nivelet, por përkundrazi ai duhet shtrirë edhe në rritjen e kërkesës së llogarisë përkundrejt të gjitha institucioneve dhe zyrtarëve publikë.
- Pavarësisht se pushteti vendor gëzon një gradë të lartë autonomie nga qeveria qendrore, përsëri marrëdhënia e tyre dhe përgjegjësitë e përbashkëta që ato ndajnë, e bëjnë rolin e qeverisë të pazëvendësueshëm. Në këtë aspekt, nisur edhe nga gjetjet e studimit, ne rekomandojmë krijimin e një sektori për të drejtat e personave lgbti pranë ministrisë përgjegjëse, me qëllim së pari zbatimin e planit kombëtar të veprimit, dhe së dyti, për të nxitur zhvillimin e politikave dhe standardeve të reja për përfshirjen dhe respektin e personave lgbti në të gjitha nivelet e qeverisë dhe organeve të saj.
- Mbështetja publike e lëvizjes dhe komunitetit lgbti është tepër e rëndësishme për rritjen e vizibilitetit të kësaj kauze të rëndësishme për të drejtat e njeriut. Studimet kanë provuar se përfshirja e politikanëve dhe zyrtarëve publikë në promovimin dhe mbështetjen e kauzës lgbti nuk ka pasoja negative në karrierën e tyre politike, gjë që hedh poshtë shumë mite që ekzistojnë edhe në shqipëri në lidhje me këtë çështje. Pranimi i hapur dhe mbështetja e personave lgbti rrit masën e respektit të të drejtave të njeriut, tolerancën në komunitetet qytetare, si dhe ndikon në uljen e dhunës në familje, komunitet dhe publik përkundrejt tyre.
- Forcimi i kontakteve dhe bashkëpunimit midis zyrtarëve publikë vendore dhe organizatave dhe përfaqësuesve të komunitetit lgbti. Bashkitë dhe ojf-të lgbti mund të ndërtojnë programe të përbashkëta ndërhyrjeje që përmirësojnë cilësinë dhe nivelin e shërbimeve vendore, futjen e praktikave të reja pozitive dhe rritjen e pranimin dhe respektimit të vetë personave lgbti. Kësaj mund t'i shërbejë edhe organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere apo kulturore në datën 17 maj, që njihet edhe si dita ndërkombëtare kundër homofobisë dhe transfobisë;
- Është e nevojshme që çdo bashki të zhvillojë politikën e saj të mos-diskriminimit, ku përfshihet edhe orientimi seksual dhe identiteti gjinor, e detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë zyrtarët apo të kontraktuarit e bashkisë (njësisë vendore). Kjo mund të realizohet edhe përmjet përgatitjes dhe nënshkrimit të një kodi sjellje për eliminimin dhe denoncimin e diskriminimit apo edhe krijimit të praktikave të vlerësimit të zyrtarëve që ofrojnë shërbime miqësore për personat lgbti (dhe jo vetëm);
- Është po aq i nevojshëm trajnimi i zyrtarëve publikë në lidhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, sistemin e referimit të rasteve, planifikimin e shërbimeve të reja të kujdesit shoqëror etj. Mos-njohja e ligjit nuk përbën një shkak për mos-zbatimin e tij, pavarësisht se në praktikë kjo ndodh shpesh. Në këtë aspekt forcimi i zyrave juridike pranë bashkive apo krijimi i sektorëve të të drejtave të njeriut, do ta rriste ndër të tjera respektin dhe zbatimin e akteve ligjore, si dhe eliminonte shkeljen e të drejtave të njeriut.

REFERENCAT

Botime

- Ambasada PINK, 2013, Manifesti i të Drejtave LGBTI për Zgjedhjet Parlamentare 2013; Avokati I Popullit, 2012, Raport i Posaçëm i zyrës së Avokatit të Popullit per LGBTI
- Council of Europe, 2010, .Study on Homophobia, Transphobia and Discrimination on Grounds of Sexual Orientation and Gender Identity Sociological Report: Albania,
- Danish Human Rights Institute / European Union Agency for Fundamental Rights, 2014, European Union lesbian, gay, bisexual and transgender survey, , Vienna.
- Fridrich Ebert Stiftung,, 2012, Rinia shqiptare 2011, mes besimit per te ardhmen dhe dyshimit per te tashme, Tiranë.
- Hungarian Academy of Sciences, 2008 Social Exclusion of lesbian, gay, bisexual and transgender people in Hungary, Institute of Sociology;

- ILGA Europe, 2006, Social Exclusion of lesbian, gay, bisexual and transgender people in Europe, , April 2006;
- INSTAT, 2011, Census i Popullsisë, Tiranë.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 2015. Raport i Posaçëm i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (2013) për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të personave LGBTI në Republikën e Shqipërisë,
- Komiteti Shqiptar i Helsikut, 2010, Aktet Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, , Tiranë.
- Ministry of Labor, Social Affairs and Equal Opportunities, 2015, .REPORT ON THE ACTION PLAN FOR NON-DISCRIMINATION ON THE BASIS OF SEXUAL ORIENTATION AND GENDER IDENTITY 2012-2014, Alida Tota
- Nancy Fraser, 1997 From Redistribution to Recognition? Justice Interruptus, Neë York: Routledges
- United Nations, 2013, The Universal Periodic Review: The situation of lesbian, gay, bisexual and trans (LGBTI) people in Albania. Submitted to UN by: PINK Embassy / Alliance Against Discrimination of LGBTI Albania / Ilga Europe, 3 September 2013.
- United Nations, 2011, Discriminatory laws and practices and acts of violence against individuals based on their sexual orientation and gender identity, Report of the United Nations High Commissioner for Human Rights, November 2011.
- Vendimi i zyrës së Komisioneres për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Nr.5, date 23.01.2014.

Burime ligjore

- Kushtetuta e Shqipërisë (1998)
- Kodit Penal, Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë (1977)
- Kodi Penal i Shqipërisë (1995 / me shtesat e vitit 2014)
- Kodi i Punës (me shtesat e vitit 2016)
- Kodi i Procedurave Administrative (2015)
- Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi (2010)
- Ligji për Arsimin Parauniversitar (2013)
- Ligji për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror (2016)
- Ligji për Stehimin Social (2018)
- Ligji për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore (2000 / 2015)

Burime elektronike

- Deklaratë Publike e Ambasadës PINK, për Dëshmipërblimin e të Dënuarve për Homoseksualizëm në periudhën komuniste (<http://www.pinkembassy.al/qeveria-t%C3%AB-d%C3%ABmshp%C3%ABrblej%C3%AB-t%C3%AB-gjith%C3%AB-personat-LGBTI-t%C3%AB-d%C3%ABnuar-gjat%C3%AB-rregjimit-komunist>)
- Gazeta “Koha Jonë”, Prill 1994. / Gazeta “Shqiptarja” Homoseksuali shqiptar: Ja si jetonim në kohën e monizmit (<http://shqiptarja.com/news.php?IDNotizia=75719>)
- Hillary Clinton diskuton për homofobinë në Shqipëri, mund të lexohet në këtë lidhje: <http://www.pinkneës.co.uk/2010/06/24/hillary-clinton-discusses-subject-of-homophobia-in-albania/>
- Aport i Situatës të të Drejtave të Njeriut të Personave LGBTI në Shqipëri (2011-2014), Ambasada PINK. Aksesuar online në adresën: <http://www.pinkembassy.al/publikime/raporte-te-shkeljeve-te-te-drejtave-te-njeriut>
- European Social Survey: Albania (2012), të dhenat mund të lexohen në këtë lidhje: https://www.osfa.al/sites/default/files/preliminary_findings_-_european_social_survey_in_albania_-_26_march_2013.pdf
- ILGA-Europe Harta e Ylberit, http://www.ilga-europe.org/sites/default/files/Attachments/side_b-rainboë_europe_index_may_2016_small.pdf
- Një kopje e Rezolutës së Kuvendit mund të lexohet në këtë lidhje: https://www.parlament.al/ep-content/uploads/sites/4/2016/01/rezoluta_per_komunitetin_LGBTI_dt__7_5_2015-3.pdf

KOMITETI SHKENCOR



Dr. Zef PREÇI - ka një eksperiencë prej mbi 30 vite pune si studiues në fushën e kërkimeve social-ekonomike, ideimin dhe drejtimin e kryerjes së studimeve, prezantimeve publike, hartimit të vrojtimeve kombëtare, interpretimeve dhe analizave, etj. Ai ka kryer një sërë detyrash publike si: Ministër i Ekonomisë dhe Privatizimit (1999); Këshilltar Ekonomik i Presidentit të Republikës (2002-2004); Kryetar i parë i Autoritetit të Konkurrencës (2004-2005); gjithashtu ka kryer detyra të përfaqësimit në nivele të ndryshme brenda komunitetit të biznesit dhe të shoqërisë civile. Dr. Preçi ka dhënë një kontribut të konsiderueshëm për institucione të ndryshme financiare, sistemin e Kombeve të Bashkuara dhe komunitetin e biznesit, duke ofruar ekspertizë në ndërtimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e shërbimeve të ndryshme, me njohuri të gjerë në rajon dhe veçanërisht në Kosovë. Ai ka një serë kualifikimesh brenda dhe jashtë vendit. Ai është autor shumë artikujsh dhe studimesh dhe pjesëmarrës në shumë konferenca shkencore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Aktualisht, Dr. Preçi është kryeredaktor i Revistës Shqiptare Social-Ekonomike, përfaqësues i shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për barazinë gjinore si dhe Drejtor Ekzekutiv i QShKE (www.acer.org.al). E-mail: zef.preçi@gmail.com



Prof. Dr. Ana Paula FERREIRA FERNANDES LOPES - Ph.D. në matematikë. Eshtë profesoreshë në Institutin e Kontabilitetit dhe Administratës së Politikave të Porto (ISCAP/P.PORTO) që nga viti 2000. Eshtë autor dhe bashkëautor i shumë botimeve. Ka qenë koordinatore e projekteve që lidhen me përdorimin e teknologjisë dhe inovacionin pedagogjik në arsimin në distancë. Në vitin 2015, mori Çmimin për Inovacion Pedagogjik në Arsimin në Distancë. Ka qenë anëtare e Komitetit Shkencor të disa Konferencave Ndërkombëtare dhe është anëtare e Bordit Shkencor të Hyperion Economic Journal (HEJ). Ajo është recensues dhe anëtare e komitetit të programit për disa Konferenca Ndërkombëtare. Kërkuese në Qendrën e Kërkimit për Komunikim dhe Edukim (CEOS.PP) dhe studiues në Qendrën Kërkimore për Studimin e Popullsisë, Ekonomisë dhe Shoqërisë (CEPESE). Fokusi kryesor i saj në fushën e kërkimit është LMS përkrah platformat, teknologjitë informative në arsim, mësimin elektronik, paradigmen e mësimdhënies, Analizën e të mësuarit, vendimarrjen me shumë kriterë. E-mail: aplopes@iscap.ipp.pt



Prof. Dr. Antonio DA SILVA ROBALO ka më shumë se 35 vjet përvojë në institucionet e arsimit të lartë. Ai ka marrë PhD nga universiteti i Trier (Gjermani) në vitin 1992. Në vitin 2005 ai merr titullin profesor në ISCTE-IUL Institutin Universitar të Lisbonës. Ai ka qenë dekan për Marrëdhënie Ndërkombëtare në shkollën e Biznesit në ISCTE, ku ka dhënë mësim në fushën e metodave sasiore dhe menaxhimit. Aktualisht fusha e tij kryesore e hulumtimit është menaxhimi ndërkulturor dhe krahasues. Ai është autor dhe bashkautor i shumë artikujve kërkimore, kumtesave në konferenca dhe studimeve. Prof. Robalo ka një eksperiencë të konsiderueshme ndërkombëtare, duke dhënë mësim në shumë vende të ndryshme, duke përfshirë Mozambik dhe Cape Verde (në portugalisht), Austria (në gjermanisht), Francë, Kinë, Makau, Japonia, Koreja, Poloni, Rep. Çeke, Rusia, Gjeorgjia (në anglisht). E-mail: Antonio.robalo@iscte.pt



Prof. Dr. Dorota WITKOWSKA - Departamenti Finances dhe Menaxhimit Strategjik Universiteti i Lodzit, Poloni. Ka marrë titullin Doktor në vitin 1985 në Universitetin e Lodzit. Prof. Ëitkoëska ka kryer kërkimet e saj shkencore në Universitetin e Shkencave të Natyrës në Varshavë, Politeknikën e Lodzit, gjithashtu në Princeton University, Pennsylvania University dhe Georg August University në Göttingen (Gjermani). Kryen kërkimet mbi Tregun Financiar, Ekonometri Financiar, Studime Krahasuese, Analiza Multidimensionale Statistike, Studimet Gender të cilat financohen nga qeveria polake dhe nga grantet e BE-se. Prof. Ëitkoëska është autore dhe bashkautore e mbi 200 artikujve shkencorë të publikuara në polonisht, anglisht dhe rusisht si dhe e 6 monografive dhe 9 teksteve universitare. Prof. Ëitkoëska është pjestare e disa organizatave shkencore ndërkombëtare në Poloni dhe në Botë. Prof. Ëitkoëska ka pasur funksionin e Zv/dekanit për çeshtjet shkencore në Fakultetin e Informatikës së Aplikuar e Matematikës në Universitetin e Shkencave të Natyrës në Varshavë dhe pjestare e bordit ekzekutiv të International Atlantic Economic Society. E-mail: dorota.witkowska@uni.lodz.pl



Prof. Dr. Ing. Elena HORSKÁ - Aktualisht është profesoreshë e Marketingut dhe Menaxhimit në Departamentin e Marketingut dhe dekanë e Fakultetit të Ekonomisë dhe Menaxhimit, Universiteti Sllovak i Bujqësisë në Nitra. Në vitet 2003-2010 ka qenë zëvendës dekan për marrëdhënie ndërkombëtare dhe 2010-2014 zëvendës-rektore për marrëdhëniet ndërkombëtare. Në vitin 2011 ajo u nderua me titullin "Profesor Honoris Causa" nga ana e Shkollës së Studimeve Profesionale dhe Kërkimeve të Delhit, Në Delhi, Indi. Orientimi i saj kryesor i kërkimit përfshin internacionalizimin brenda dhe jashtë kufijve të BE-së, identifikimin e mundësive për të bërë biznes në tregjet fqinje (Visegrad), Evropë, vendet më pak të zhvilluara dhe ato në zhvillim (fokus agrobiznesi dhe tregu agro-ushqimor), studime të konsumatorëve, neuromarketing. Ajo

ka qenë profesor vizitore në Shkollën e Studimeve Profesionale dhe Kërkimeve Delhi në Nju Delhi, Indi, në Universitetin Kombëtar Kazakistik të Kazakistanit në Almaty, në Finlandë, Itali, Portugali, Spanjë dhe Irlandës dhe në programin CEEPUS në Kroaci, Hungari, Austri dhe Poloni. Ajo ka qenë një koordinatorë e 6 projekteve kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe 22 projekte ndërkombëtare. Ajo është autore e më shumë se 200 botimeve, përfshirë 6 tekste kombëtare / ndërkombëtare, 10 monografi kombëtare / ndërkombëtare të botuara në Sllovaki, Çeki, Poloni, Austri, Spanjë, Rumani dhe Kroaci dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare në Tajlandë, Kinë, Maltë, Ganë, Hungari, Greqi, Poloni, Çeki, Austri, Brazil, Indonezi, SHBA dhe Singapor. Ajo është koordinatorë e programit të diplomës së dyfishtë "Marketing dhe Tregti Agrare" të organizuar së bashku me Universitetin Agrare të Rusisë - Akademia Timiryazev e Moskës dhe anëtare e Agjencisë Evropiane të Akreditimit për Bordin e Shkencave të Jetës (me Sekretariatin EALS në Francë). Elena.Horska @ gmail.com



Prof. Dr. Fatmir MEMAJ- ka një eksperiencë më shumë se 30 vite në institucionet e arsimit të lartë si Lektor i Statistikës dhe Demografisë. Mori gradën PhD në vitin 1996. Në Maj të vitit 2011, Profesor i Asociuar dhe në Mars të vitit 2007 Profesor. Prof. Memaj ka një eksperiencë të gjerë në arsimim dhe ekonomi, duke theksuar: Zëvendës Ministër i Mbrojtjes për çështjet ekonomike (1992-1993); Lektor, Fakulteti i Biznesit dhe i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës (1994-1997); Drejtues i Departamentit të Statistikës në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës (1997-1998), Zëvendës Dekan, Fakulteti i Ekonomisë, UT (2003-2016), etj. Aktualisht, ai është profesor në Fakultetin e Ekonomisë, UT dhe Drejtor Ekzekutiv i Forumit Shqiptar Social-Ekonomik (ASET) eëë.aset-al.com. Autor dhe bashkë-autor i shumë librave dhe monografive dhe mbi 50 artikujve në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, i më shumë se 80 punimeve të konferencave dhe i një sërë studimesh dhe punimesh kërkimore në fushën e tij. E-mail: fmema@yahoo.com ose fatmirmemaj@feut.edu.al



Prof. Dr. Dr.h.c. Heinz-Dieter WENZEL- ka një eksperiencë të gjerë në çështjet ekonomike. Ai ka studiuar matematikë në Universitetin e Munster-nit dhe mori gradën PhD në vitin 1975 në Universitetin e Heidelberg-ut. Ai ka qenë Profesor i Financave Publike në Universitetin e Heidelberg-ut (1983-1985) dhe Profesor i Teorisë së Ekonomisë në Universitetin Ludëig-Maximilian, Munihi (1985-1989). Nga viti 1989, ai ka qenë Profesor i Ekonomisë Publike në Universitetin e Bamberg-ut, ku ai doli në pension në vitin 2011. Nga viti 1989 deri në vitin 2011, ai ishte Drejtues i Grupit të Kërkimeve Ekonomike të Bamberg-ut për Qeverisjen dhe Rritjen (BERG). Gjithashtu, në vitin 2000 ai mori përsipër menaxhimin e një projekti bashkëpunues midis Univ të Bamberg-ut, Budapest, Sarajevë, Tiranë, Tetovë, që formoi bashkëpunim ekonomik në kërkim dhe mësimdhënie. Ai është autor i shumë librave dhe artikujve shkencorë. E-mail: heinz-dieter.enzenel@uni-bamberg.de



Prof. Dr. Iraj HASHI- ka përfunduar studimet e tij të Masterit në Shtetet e Bashkuara (Universiteti i Maryland) dhe studimet e doktoraturës në Britaninë e Madhe (Universiteti i Keele). Ai e filloi karrierën e mësimdhënies në Universitetin e Staffordshire në vitin 1978 si Lektor për lëndën e Ekonomisë. Aktualisht është Profesor i Ekonomisë dhe Drejtor i Qendrës për Kërkime mbi Ekonomitë në Zhvillim, në Universitetin e Staffordshire-it. Ai është i specializuar në Mikroekonomi, Ekonomi Industriale dhe që nga viti 1990, Ekonomia në Tranzicion. Ai ka koordinuar Projektin Erasmus, Socrates dhe programet e Tempus-it dhe aktivitetet e tij në Evropën Qendrore dhe Lindore. Dr. Hashi ka qenë i përfshirë në mënyrë aktive në kërkime, mësimdhënie dhe konsulencë në ekonomitë në tranzicion të Evropës Qendrore dhe Lindore që nga viti 1992, dhe ka punuar me universitetet dhe institucionet kërkimore dhe konsulencës në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Kroaci, Republikën Çeke, Kosovë, Maqedoni, Poloni dhe Rusi në një gamë të gjerë projektesh që kishin në qendër të tyre sfidat e tranzicionit në këto vende. Interesat e tij kërkimore përfshijnë: privatizimin dhe ristrukturimin, qeverisjen e korporatave, konkurrencën industriale, falimentimin dhe riorganizimin, risinë dhe ndryshimet teknike. Ka botuar shumë artikuj në revista shkencore dhe libra. E-mail: i.hashi@staffs.ac.uk



Prof. Dr. Janez PRAŠNIKAR- Profesor i Ekonomisë, është Drejtor Ekzekutiv i Institutit për Evropën Juglindore dhe themelues dhe drejtor i Programit Master i Biznesit dhe Organizimit në Fakultetin e Ekonomisë, në Universitetin e Lubjanës, program me diplomë të njohur në nivel ndërkombëtar. Ai ka qenë anëtar i Bordit Strategjik të Kryeministrit të Sllovenisë dhe të komitetit të programit të Presidentit të Sllovenisë. Si një hulumtues ai është i lidhur me Institutin Ëilliam Davidson në Shkollën e Biznesit, Universiteti i Michigan, SHBA, dhe Qendrën për Hulumtime të Politikave Ekonomike (CEPR) në Londër, Mbretëria e Bashkuar. Fushat e ekspertizës të Dr Prašnikar përfshijnë ekonomitë në tranzicion, sjelljen e ndërmarrjeve, sipërmarrjen, ekonominë menaxheriale dhe marrëdhëniet e punës. Dr. Janez Prašnikar mbaruar Ph.D. në Universitetin e

Lubjanës (1982). Ka qenë profesor vizitor në Universitetin e Berkeley (vjeshtë 1984), Universitetin Cornell (pranverë 1985) dhe Universiteti Pitsburg (vjeshtë 1987). Nga pranverë 1997-2005 ai ishte profesor i afiluar në në Shkollën e Biznesit në Universitetin e Michiganit. Profesor Prašnikar ka kryer hulumtime dhe këshillime të politikave për kompanitë dhe qeveritë për ish-Jugosllavinë, Kinën dhe Slloveninë. Ai ka shërbyer si president apo anëtar i Bordeve mbikëqyrës në firmat e shumta. Email: janez.prasnikar@ef.uni-lj.si



Prof. Dr. Justina SHIROKA PULA- ka më shumë se 35 vjet përvojë në institucionet e arsimit të lartë. Ajo filloi si asistente dhe mori gradën PhD në vitin 2004. Ajo ka qenë lektore në Universitetin e Tetovës (1994-1999) dhe Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë (2004-2004), si dhe universiteteve private në Prishtinë: Iliria (2006-2007), Fama (2006-2007) dhe Globus (2011). Prof Shiroka - Pula ka drejtuar Departamentin e Matematikë dhe Statistikës të Fakultetit të Ekonomisë nga 1999 deri në 2001, si dhe ka qenë Drejtuese e Bordit të Studimeve Master të Programit të Manaxhimit të Shëndetësisë (2002-2003). Përveç angazhimit të saj akademik, Prof Shiroka - Pula ka qenë Ministre e Energjisë dhe Minierave (2007-2011).

Aktualisht ajo është deputete në parlamentin e Kosovës nga viti që nga viti 2011. Ajo gjithashtu ka shumë tekste në fushën vendim-marrjes manaxheriale, programimit operacional dhe sipërmarrjes. Dr. Pula është certifikuar nga programet e shumta mbi Bizneset e vogla dhe të mesme, Sipërmarrjes, dhe Gruaja në ekonomi, në Francë (Qeveria Franceze), në SHBA (Departamenti i Shtetit) dhe UNIFEM. Aktualisht Prof Shiroka - Pula është profesore e Menaxhimit të SME-ve, Vendimarrjes Manaxheriale dhe Mjedisit të Biznesit në ciklin e studimeve Bachelor; Sipërmarrja e SME-ve dhe Metodave të Kërkimit në Manaxhim në ciklin e studimeve Master. E-mail:justinapula@hotmail.com



Prof. Dr. Luigi D'AMBRA- Profesor Statistike, Departamenti i Ekonomiksit, Institucionet e Manaxhimit (Universiteti i Napolit-Itali). Ai ka realizua një aktivitet të thelluar didaktik dhe shkencor në Universitetin e Napolit. Aktiviteti i tij është i përqendruar në analizën me shumë ndryshore, matricat, shkallët shumëdimensionale, analizat jo simetrike dhe analizat kumulative korresponduese. Subjekt tjetër e kërkimit të tij kanë qenë modelet log-bilinear dhe log-trilinear. Ka realizuar kurse mbi analizën e të dhënave dhe regresion me variabla diskrete të varura. Ka organizuar disa konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, në të cilën janë diskutuar vlerësimet e sistemeve universitare. Ai gjithashtu ka redaktuar hartimin e disa librave në kuadër të cilësisë së shërbimeve. Në korrik 2015 kam marrë emërimin nga ana e Shefit të Sektorit të Vlerësimit

në Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë në Shqipëri si pedagog i jashtëm për të vlerësuar programin e studimit të ciklit të tretë, "Ph.D në Statistikë "ofruar nga Universita Nostra Signora del Buon Consiglio të Tiranës. Nga viti 2011 ai është anëtar i Bordit Këshillimor JAQM (Revista e Metodave Sasiore e aplikuar) dhe Editor i Revistës Elektronike për Analizat Statistike e Aplikuar (EJASA) E-mail: dambra@unina.it



Prof. Dr. Nasir SELIMI është profesor në Fakultetin e Biznesit dhe Ekonomisë në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë që nga viti 2002. Në vitin 2004 - 2008 kreu funksionin e Dekanit në FBE. Lëmit në të cilat më së shumti është i përkushtuar, prof. Selimi janë ato të ekonomiksit dhe ekonomisë ndërkombëtare. Ka botuar një numër të punimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare. Prof. N. Selimi poashtu ka të botuar disa libra dhe teksteve universitare në sferën e ekonomiksit dhe ekonomisë ndërkombëtare. E-mail: n.selimi@seeu.edu.mk



Prof. Dr. Statty STATTEV- Rektori i Universitetit National and World Economy (UNWE). Zëvendëskryetari i Konferencës së Rektorëve në Bullgari. Nga 2003-2011 ai ka qenë zëvendës Rektori i parë i UNWE, dhe 1999-2003 -Dekan i Fakultetit të Ekonomisë së Përgjithshme të të njëjtit universitet. Në 1984-1985 është specializuar në Departamentin e Ekonomisë Politike në Universitetin shtetror "M. Lomonosov ", Moskë, Rusi. Në 1989-1990 ai ka kryer një specializim Fulbright si hulumtues në Departamentin Ekonomik të Universitetit Boston, Massachusetts, USA. Si një profesor vizitor në Universitetin e Bostonit ai jep kurse të rregullta dhe verore lidhur me ekonomitë e vendeve të Evropës Lindore. Ai ka punuar si konsulent i Bankës Botërore. Ka udhëhequr dhe ka marrë pjesë në një numër të madh projektesh kombëtare dhe ndërkombëtare.

Prof. Stattev është përfaqësues i Republikës së Bullgarisë dhe Anëtar i Bordit Ekzekutiv të Nismës së Evropës Qendrore për Rrjetin e Universiteteve. Ai ka më shumë se 170 publikime në bullgarisht, rusisht, anglisht, polonisht, greqisht, serbisht, dhe shqip. Ai është anëtar i Këshillit Drejtues të Bankës Kombëtare Bullgare dhe Kryetar i Bordit të Drejtorëve të kompanisë Mint. E-mail: sstattev@unwe.bg



Prof. Dr. Shyqyri LLACI - është pedagog në FEUT, në fushën e Menaxhimit të Biznesit, Lidershipit dhe qeverisjes së korporatave. Ai ka titullin Doktor në fushën e menaxhimit të produktivitetit dhe është pedagog në FEUT që nga viti 2001. Prof. Dr. Shyqyri Llaci është autor dhe bashkëautor i disa teksteve universitare, një monografi dhe ka qenë i përfshirë në projekte të ndryshme dhe aktivitete lidhur me kërkimet shkencore. Gjithashtu, ka botuar shumë artikuj në Shqipëri dhe jashtë vendit, në revista dhe konferenca të njohura shkencore. Gjatë viteve 1993-1994 dhe 2008-2012 ka qenë Zv/ Dekan dhe në vitet 1994-1995 Dekan i Fakultetit të Ekonomisë. Që nga viti 2012 mban postin e Shefit të Departamentit të Menaxhimit. Anëtar i komisionit të Lartë të Akreditimit të Arsimit të Lartë për 8 vjet deri në vitin 2012. Ka botuar artikuj dhe studime shkencore mbi menaxhimin dhe biznesin, aspekte të organizmit të firmave dhe të efektivitetit organizativ, dimensione të lidershipit në mjedisin shqiptar. Menaxhimi dhe motivimi i punonjësve në shekullin e ri, qeverisja e shoqërive aksionere dhe atyre tregtare në tërësi, qeverisja e shoqërive aksionere në sektorin publik dhe në vendet e EJL, menaxhimi i produktivitetit. Fushë e interesit shkencor është edhe menaxhimi krahasues, si edhe reformimi, financimi dhe akreditimi i arsimit të lartë në Shqipëri. E-mail: shyqyri.llaci@feut.edu.al



Prof. Dr. Tomasz MROCKOWSKI - ka një eksperiencë të gjerë në mësimdhënie. Ai ka qenë lektor në universitete në Japoni dhe Evropë, duke përfshirë edhe Akademinë Kombëtare të Mbrojtjes në Japoni, Shkollën e Biznesit të Kopenhagen-it, Universiteti i Cambridge, Universiteti i Paris-Sorbonne, dhe ESCP-EAP në Paris. Ai ka realizuar shumë seminare ekzekutive të zhvillimit për kompani lider në Amerikë dhe Evropë, siç janë GM, AT&T, Union Carbide, GE dhe Polaroid. Ai ka qenë anëtar i Bordeve Redaktuesish, i shumë revistave shkencore duke përfshirë Revistën e Zhvillimit të Biznesit Global në Azinë Jugore, Revista e East-Eest Business, dhe Eördlvieë-një publikim shkencor amerikan. Ai ka fituar një numër të madh grandesh nga kompanitë private dhe fondacione publike, duke përfshirë Fondacioni i Andreë A. Mellon, Agjencia Amerikane për zhvillim ndërkombëtar, dhe German Marshall Fund i Shteteve të Bashkuara. Aktualisht, ai është profesor dhe drejtues i Departamentit të Biznesit Ndërkombëtar, Shkolla Kodog e Biznesit, Universiteti Amerikan, Ëashington DC. Ai jep mësim mbi Biznesin Ndërkombëtar dhe Menaxhimin e Tregjeve që janë në Zhvillim, në ciklin e studimeve Master. Ai është autor i shumë artikujve shkencorë, raporteve kërkimore dhe librave. E-mail: mrocz@american.edu



Prof. Dr. Yannis TSEKOURAS - Profesor Emeritus i Universitetit të Maqedonisë, Selanik, Greqi. Ka studiuar në Fakultetin e Shkencave Ekonomike e Politike të Universitetit të Bazelit (1962-1968), dhe Ph.D. 1968-1971 në Universitetin e Bazelit. Prof. Tsekouras u bë menaxher i projektit në Programin e Zhvillimit Ekonomik të Kantonit të Baselit, Zvicër 1971-1974. Në 1977 ai u zgjodh Profesor extraordinarior i Universitetit të Maqedonisë (ish-Shkollës së Lartë të Industrisë) Selanik, Greqi. Në 1980 ai u zgjodh profesor i Universitetit të Maqedonisë, në vitin 2004 ai u zgjodh anëtar i Parlamentit grek dhe Sekretar i Komisionit Parlamentar të Punëve të Jashtme dhe të Mbrojtjes dhe gjatë 2007-2015 ai ishte këshilltar i Presidentit të të Greqisë. Prof. Tsekouras ishte kryetar i Departamentit të Shkencave Ekonomike në Universitetin e Maqedonisë (1987-1991, rektor i Universitetit të Maqedonisë (1991-1997). Ai është zgjedhur Kryetar i Departamentit të Edukimit dhe Politikës Sociale, Kryetari i Departamentit të Ballkanistikës, Sllavistikës dhe Studimeve Orientale, Drejtor i Institutit të Kërkimeve të Universitetit të Maqedonisë. Gjatë periudhës 1998-2015, Prof. Trsekouras është themelues i Shoqatës së Universiteteve Ekonomike të Europës Jugore dhe Lindore dhe Rajonit të Detit të Zi (ASECU). Ai është autor dhe bashkautor i 36 teksteve universitare, monografive dhe artikujve, si dhe 22 kumtesa të paraqitura në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare E-mail: tsekourj@uom.gr



Prof. Dr. Zhaklina PETO - Ka përfunduar studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës në vitin 1995, me rezultate shumë të mira. Në vitin 1996, është emëruar pedagoge efektive pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në Departamentin e të Drejtës Civile, detyrë të cilën vazhdon ta kryej aktualisht. Gjatë kësaj periudhe, ka realizuar hap pas hapi të gjitha shkallët e kualifikimit shkencor dhe profesional dhe tashmë mban titullin Profesor Doktor. Përvoja shumëvjeçare në procesin e mësimdhënies si lektore e disa moduleve në nivelet Bachelor, Master dhe Doktoraturë e ka ndihmuar për të qenë një njohëse e mirë e doktrinës dhe jurisprudencës vendase dhe asaj të huaj. Formimi i saj akademik dhe profesional, si autore e disa teksteve universitare dhe publikimeve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare me një shtrirje kohore, dëshmon për një veprimtari shkencore të pandërprerë në fushën e së drejtës. Ndër vite ka ushtruar disa pozicione drejtuese në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës si: Anëtare e zgjedhur në Këshillin Shkencor të Fakultetit të Drejtësisë, anëtare e Senatit të Universitetit të Tiranës, anëtare e Këshillit të Profesorëve, Përgjegjëse e Departamentit të së Drejtës Civile e zgjedhur në dy mandate, pozicion të cilin e ushtron aktualisht. E-mail: zhaklinpeto@gmail.com



Prof. As Dr. Dorina HOXHA dorina.hoxha@fdut.edu.al ka përfunduar studimet e larta në Drejtësi në Universitetin e Padovës (Itali) në 2004. Në 2008 ka përfunduar studimet master të nivelit të dytë LL.M në Itali. Temën e masterit si kërkuese shkencore e ka përfunduar pranë PAMECA-s në 2007. Në 2008 ka punuar si eksperte ligjore në programin “Shteti ligjor” një projekt i USAID-it, me detyra kryesore si koordinimi i ndihmës teknike në gjykata pilot duke përfshirë edhe zbatimin e reformës ligjore. Në 2013 ka marrë gradën shkencore “Doktor” me një temë në të drejtën penale, duke analizuar lidhjen e kohës dhe veprës penale. Ajo ka fituar gradën shkencore “Profesor i asociuar” në 2016 dhe është bashkëautore në publikime të ndryshme si “E drejta penale, Pjesa e përgjithshme”, një libër i detyrueshëm në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Mbi 15 vjet ajo jep leksione në lëndën “E drejta penale, Pjesa e përgjithshme”. Ajo është avokate në çështjet civile dhe penale me një eksperience mbi 15 vjet dhe në vitin 2019 ajo ka fituar çmimin “Toga e artë” nga Shoqata e Avokatëve Penalistë. Ajo është autore e disa artikujve shkencorë brenda dhe jashtë vendit.



Prof. Asoc. Dr. Etleva LESKAJ, është përgjegjëse e Departamentit të Manaxhimit, në Fakultetin e Ekonomisë. Ajo mban titullin akademike Professore e Asociuar. Gjatë periudhës 2018-2020, ka qenë zv. dekane për kërkimin shkencor dhe marrëdhëniet me jashtë, në Fakultetin e Ekonomisë. Ajo ka mbaruar studimet Master në Administrim Biznesi pranë Fakultetit të Ekonomisë, UT në 2005. Doktoruar në fushën e kulturës organizative në 2009, në fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Ajo është lektore e Manaxhimit Strategjik, Planifikimit Strategjik dhe Marrjes së Vendimeve Menaxheriale. Ka marrë pjesë në programe të ndryshme shkëmbimi, për trajnim apo si lektore e ftuar, në Francë, Spanjë, Gjermani, Danimarkë, Angli, Slloveni etj. Prej vitit 2012 është eksperte vlerësimi e jashtme pranë Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë. Fushat e saj të ekspertizës janë, vendimmarrja menaxheriale, manaxhimi strategjik dhe kultura organizative. E-mail: etlevaleskaj@feut.edu.al



Prof. Asoc. Dr. Florian NUTA- Diplomuar në Financë (2003). Në vitin 2005, ai mori Diplomën e Masterit në Administrim Biznes në Universitetin e Dunarea-s, Galati. Në vitin 2009, ai mori gradën e PhD në Ekonomiks. Prof. Nuta ka realizuar studimet e tij post-doktorale në Universitetin e Messinë-s (IT) dhe CNAM Paris (FR) në fushën e Përgjegjësisë Sociale dhe Mjedisore e SME-ve. Ai është Redaktor Ekzekutiv i Revistës së Kontabilitetit dhe Menaxhimit dhe anëtar i disa bordeve këshilluese të revistave shkencore. Prof. Nuta është koordinator i Laboratorit të Kontabilitetit dhe Kërkimeve Fiskale, dhe ka një përfshirje aktive në nisimat kombëtare dhe ndërkombëtare kërkimore. Ai është autor dhe bashkautor i shumë librave, më shumë se 30 artikuj të botuar në revista shkencore të njohura ndërkombëtare dhe më shumë se 40 punime nëpër konferenca. Aktualisht ai është Lektor në Universitetin e Danubius Galati, Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Rumania, i përfshirë në aktivitetet e menaxhimit kërkimor dhe mësimdhënies në fushën e financave dhe kontabilitetit. E-mail: floriann@univ-danubius.ro



Prof. Asoc. Dr. Laura TAFARO - është Professore e Asociuar në Universitetin e Barit (Departamenti Jonico i Sistemeve të Ekonomisë dhe Ekonomisë së Msdheut). Ajo ka më shumë se 20 vjet përvojë didaktike në Kurset Universitare të të Drejtës civile dhe private, fillimisht si lektore, pastaj si Asistent Professore dhe më në fund si Professore e asociuar. Ka mbrojtur doktoraturën në të Drejtën Civile në 2003. Në vitin 1997 u pranua në Shkollën e Specializimit në të Drejtën Civile në Universitetin e Camerino; në vitin 2001 fitoi pozicionin e asistent profesore në të drejtën private, në vitin 2004 fitoi titullin profesore e asociuar. Nga viti 2006 deri në vitin 2012 ka qenë anëtare e Bordit të Mësimdhënies të programit PhD të të Drejtës Civile; nga viti 2007 e në vazhdim ajo është anëtare e Komiteteve të ndryshme të Fakultetit dhe ka disa detyra Institucionale (Zëvendëseshfe e Departamentit, Zëvendës dekane, Kryetare e Këshillit të Kualifikimeve). Aktualisht, ajo është Dekane e Shkollës në Shkencë dhe Menaxhim Teknik Nautical. Ajo ka një përvojë të gjerë në arsimin universitar dhe pasuniversitar, si drejtuese, propozuese dhe koordinatore shkencore të disa kurseve të avancuara dhe kurseve trajnimi (2007-2013). Prej vitit 2000 e në vazhdim, ajo ka bashkëpunuar në ka qenë Koordinatore Shkencore për projekte të ndryshme kërkimore. Prej vitit 2005 e në vazhdim ka realizuar punime shkencore dhe leksione të ndryshme, të paraqitura në takime të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare në fushat e saj kërkimore. Është autore dhe bashkëautore e monografive dhe eseve të botuara në takime Kombëtare dhe Ndërkombëtare dhe është anëtare e redaksisë dhe e Komitetit Shkencor në disa Komitete Shkencore Kombëtare dhe Ndërkombëtare Email: laura.tafaro@uniba.it



Dr. Elmira KUSHTA Lindur, më 02 Shkurt 1982 në Vlorë, Diplomuar ne 2008 DNP ne Matematike-Fizik, 2009 MNP ne Matematik (Master i nivelit te pare), 2012 DND ne Matematike (Diplome e nivelit te dyte) ne Fakultetin e Shkencave Teknike, Universiteti “Ismail Qemali”, Vlore.

Ne 2018 mbrojtí graden shkencore “Doktor” në Matematike ne Universitetin e “Ismail Qemali”. Drejtimi: Statistikë dhe Matematikë e Aplikuar. Pedagoge e lendeve: Kalkulus I, II, Algjebër Lineare, Probabilitet dhe Statistikë, Matematika I, Matematikë e Zbatuar, Matematikë e pergjithshme, Statistikë në Universitetin “Ismail Qemali” të Vlorës që nga viti 2009. Autore dhe bashkëautore në shumë punime shkencore, konferenca, workshops, kongrese si dhe cikel leksionesh etj. Ka qenë pjese e projektit Teavet. E-mail: elmira.kushta@univlora.edu.al dhe kushtamira@gmail.com



Dr. Zamira SINAJ Lindur, më 30 janar 1982 në Vlore, Shqipëri, U diplomua (2006) si Menaxher Turizmii, ne Fakultetin Ekonomik, Universiteti “Ismail Qemali”, Vlore. Studime Doktorature në Institutin e Studimeve Evropiane, UT, me teme: “Ndikimi i zhvillimit te biznesit midis Shqiperise dhe Italise ne zhvillimin ekonomik dhe integrimin Evropian te Shqiperise (Fokus rajoni i Vlorës” - në Universitetin eTiranës. Ne 2016 mbrojtí graden shkencore “Doktor” në Universitetin e Tiranës. Pedagoge e lendeve: Menaxhimi i performances, Administrim Publik Evropian, Zhvillimi i Planeve te Biznesit në Universitetin “Ismail Qemali” të Vlorës që nga viti 2014. Autore dhe bashkëautore në shumë punime shkencore, konferenca, workshops që lidhen me manaxhimin, biznesin, administraten publike, planet e bizneseit, etj. E-mail: zamira.sinaj@univlora.edu.al dhe zamira.sinaj20@gmail.com

Recenzentë në këtë numër: (në rend alfabetik)

Arben ODA
Dorina HOXHA
Eglantina ZYKA

Elena MYFTARAJ
Etleva LESKAJ
Fatmir MEMAJ

Sali ZHAKU
Zamira SINAJ
Zef PREÇI

KRITERET PËR BOTIMIN E ARTIKUJVE

Të nderuar bashkëpuntorë,

Redaksia e Revistës Shqiptare Social - Ekonomike, nisur nga dëshira e mirë për të patur një nivel sa më të lartë shkencor të artikujve të botuar në këtë revistë, ju paraqet kriteret bazë për pranimin e një artikulli për tu shqyrtuar për botim.

1. Artikulli duhet të dërgohet në dy gjuhë (shqip edhe anglisht). Versioni anglisht do të botohet elektronikisht në faqen eeb të Revistes Shqiptare Social Ekonomike <http://ëëë.aser.revieë-al.org>
2. Artikujt do të pranohen për tu shqyrtuar për botim në numrin e radhës së revistës në se dërgohen jo më vonë se 1 muaj përpara mbylljes së tremujorit respektiv.
3. Artikulli nuk duhet të jetë më i shkurtër se 2.500 fjalë dhe zakonisht jo më i gjatë se 4.000 fjalë.
4. Artikulli duhet të jetë i shkruar në MSËord.
5. Artikulli duhet të ketë një strukturë relativisht standarte. Ai duhet të përmbajë një pjesë të shkurtër dhe koncize në formën e hyrjes dhe të jetë i ndarë në çështje dhe nënçështje. Në fund të artikullit duhet të ketë konkluzione dhe rekomandime.
6. Në artikull është shumë e rëndësishme referimi i burimeve bibliografike në formën e literatures se konsultuar. Ajo duhet të jetë e renditur sipas mbiemrit të autorëve; titullit të botimit, vitit, etj (P.sh. Kodra, A., “Probleme të ekonomive në tranzicion”, Revista Shqiptare Social Ekonomik Nr. 1 (5), 2011, Tiranë, 2011)
7. Tabelat statistikore duhet të kenë titullin dhe numrat e tyre në një rend vijues. (P.sh. Tabela 4. Numri i popullsisë në Shqipëri)
8. Grafikët duhet të kenë titullin dhe numrat e tyre, ku numërimi të bëhet me numra arab, pavarësisht nga numri i tabelave, dhe në rend vijues. (P.sh. Grafiku 4. Struktura e popullsisë sipas gjinisë)
9. Bëni përpjekje të eliminoni tabelat në formate të mëdha. Është e këshillueshme që tabela të tilla të përfshihen në material vetëm kur gjykohen tepër të domosdoshme dhe në një aneks të artikullit duke e referuar në tekst.
10. Artikulli duhet të përmbajë trajtimin e problemeve praktike të ekonomisë shqiptare në tranzicion minimalisht në masën 40%.
11. Artikulli duhet që të ketë të dhëna relevante që i përkasin një periudhe jo më tepër se një vit nga periudha aktuale.
12. Artikulli duhet të mos ketë gabime gjuhësore dhe të punohet patjetër duke përdorur shkronjat ë dhe ç.
13. Në rastet kur përdoren footnotes ato duhet të vendosen me numërim të automatizuar “auto Number”.
14. Artikulli duhet të shoqërohet patjetër me një përmbledhje në gjuhën angleze, e cila duhet të jetë midis 150-250 fjalë.

Artikulli do të pranohet si i mundshëm për tu gjykuar për botim vetëm pas përmbushjes strikte të kushteve të mësipërme. Për çdo artikull do të ketë recensa, vërejtjet themelore të së cilave janë të detyrueshme për tu reflektuar përpara botimit.

Në bazë të politikës së ndjekur nga bordi i revistës dhe të raporteve në trajtimin e temave të ndryshme, stafi i revistës ruan të drejtën për spostimin në kohë të botimit të artikujve të ndryshëm.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe duke pritur bashkëpunimin tuaj të frutshëm!

Redaksia

REPUBLIKA E SHQIPERISE
 MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES
 Drejtoria e Kerkimit Shkences
 Tel/Fax: + 355 42 40468
 E-mail: magim@rotary.org.al

1379

Nr. Prot.

Tirane, 23.04.1999

Lenda. Miratim periodiku shkencor

Qendres shqiptare për kërkime ekonomike

Ne pergjigje te shkrese suaj date 9.04.1999, Komisioni i Rikonsiderimit te Periodikeve Shkencore prane Drejtorise sone, ju tjofton, se ne mbledhjen e tij te dates 23.04.1999, mori vendimin, qe periodiku Ekonomia dhe Tranzicioni, i botuar prej jush, te konsiderohet periodik shkencor, per tu marre ne konsiderate nga Komisioni i Kualifikimit Shkencor

DREJTORI

Agha M. KROZI



Per dijeni,

- Universiteteve/ Fakulteteve Ekonomike
- Organizatave Jo-qeveritare Ekonomike
- Akademi se Shkencave / Inst. Shkencore
- Ministrite dhe Institucionet Qendrore
- Parlamentit / Komisionit Ekonomi-Finance-Privatizim, Komisionit te Punes dhe Ceshjteve Sociale